



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

**T R A N S K R I P T**

**I MBLEDHJES SË JASHTËZAKONSHME TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS  
SË KOSOVËS, E MBAJTUR MË 14 MAJ 2019**

**SA VANREDNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,  
ODRŽANE 14. MAJA 2019. GODINE**

**MAJ - MAJ  
2019**

## **Rendi i ditës**

1. Gjendja në Telekomin e Kosovës dhe masat që i ka ndërmarrë Qeveria e Kosovës në zbatimin e Rezolutës nr. 06-R-013, datë 12. 7. 2018 lidhur me gjendjen financiare në Telekom dhe Postën e Kosovës

## **Dnevni red**

1. Stanje u Telekomu Kosova i mere koje je preduzela Vlada Kosova za sprovođenje Rezolucije br. 06-R-013 od 12. 07. 2018. godine u vezi finansijskog stanja u Telekomu i Pošti Kosova.

## **Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.**

KRYETARI: Të nderuar deputetë,  
Sido që të jetë, po fillojmë seancën, 42 deputetë janë në sallë.

I nderuar kryeministër,  
I nderuar zëvendëskryeministër,  
Dhe ministra të kabinetit qeveritar,  
I hap punimet e seancës së jashtëzakonshme, me kërkesë të 40 deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Procedojmë me pikën e vetmen të rendit të ditës:

### **1. Debat parlamentar lidhur me gjendjen në Telekomin e Kosovës dhe masat që i ka ndërmarrë Qeveria e Kosovës në zbatimin e Rezolutës numër 06/L-013, datë 12. 7. 2018 lidhur me gjendjen financiare në Telekom dhe Postën e Kosovës**

Të nderuar deputetë,  
40 deputetë të Kuvendit kanë parashtruar kërkesë për debat parlamentar për gjendjen në Telekomin e Kosovës.

Ftoj zotin Milaim Zeka që në emër të propozuesit të paraqesë, po lajmëroni, ju lutem, për besë, nuk po di. Veç Milaimi ishte i lajmëruar.

Zoti Glauk Konjufca e paraqet në emër të propozuesit çështjen për të cilën është kërkuar debati parlamentar. Nuk pata asnjë emër, ta keni parasysh, veç Milaimi ishte.

GLAUK KONJUFCA: Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,  
Të dashur qytetarë të Republikës së Kosovës,  
Telekomi është në buzë të falimentimit. Ky nuk është një bankrotim spontan, as sipas ligjeve të tregut, është një shkatërrim i qëllimshëm dhe një skenar me paramendim.

Autorët e këtij krimi të organizuar me përfitime qindra-milionëshe janë aktorët e pushtetit në bashkëpunim me pronarët e Dardafonit.

Protagonisti kryesor në pushtet ishte kryeministri i vitit 2009, Hashim Thaçi, aktorët kryesorë të Telekomit ishin Shyqeri Haxha dhe Rexhë Gjonbalaj, biznesmenët janë grupi Devolli, kurse partia orkestruese e krejt kësaj pune në Telekom pa dyshim është PDK-ja e zotit Kadri Veseli.

Fillimisht ndaj Telekomit të Kosovës prej partive në pushtet është aplikuar një politikë e pamëshirshme e punësimeve pa kriter. Një prej aseteve më të rëndësishme të Republikës sonë, është abuzuar në mënyrën më të ligë.

Telekomi vazhdimisht ka shërbyer si parajsë e tenderë të majmë dhe keqpërdorimeve të pallogaritshme financiare. Pushtetarët kanë vendosur deri edhe në cilat oborre të vendosen antenat e Telekomit për vjeljen e qirasë.

Mbingarkesat e papërballueshme me punësime nepotike, zhvatjet përmes tenderëve, si dhe keqpërdorimet e parave e kanë shtrirë Telekomin e Kosovës për tokë.

Një kompani e suksesshme që para 10 vjetëve i sillte Kosovës të hyra 100 milionë euro në vit, sot është mbytur në borxhe.

Të nderuar kolegë,

Kjo nuk ka lidhje me ekonominë e tregut, kjo është skemë e mashtrimit mafioz multimilionësh. Por ajo që spikatë dhe përbën kulmin e të keqes është pa dyshim kontrata mes Telekomit dhe Dardafonit, e lidhur në vitin 2009, pikërisht në vitin kur të ardhurat e PTK-së ishin në kulmin e vet, pra rreth 100 milionë euro në vit.

Në emër të operatorit virtual, Dardafonit i ishte ofruar një kontratë nga Telekomi, Telekomi ia jep Dardafonit infrastrukturën, kurse Dardafoni pas asnjë cent investime ka përfitime, pra profit 73%.

Kjo i bie që pa asnjë bazë ligjore dhe pa asnjë racionalitet ekonomik një operatori privat i falen qindra miliona euro të qytetarëve të Kosovës.

Prokuroria tashmë pretendon që Telekomi është dëmtuar 200 milionë euro, deri tash, nga një kontratë e tillë. Kjo kontratë në çdo aspekt përbën vepër të rëndë penale dhe në çdo vend demokratik të botës, një kontratë e tillë dënohet me burgim për këdo që është i përfshirë. Kjo kontratë hyn në kategorinë e dëmtimit të pashembullt të interesit publik. Vetë koncepti i operatorit virtual, në këtë rast, përbën mashtrim, sepse çdo kund në botë ky lloj i operatorëve rëndon krijohet për ta lehtësuar strategjikisht efektivitetin e kompanisë në një segment të caktuar të shërbimeve.

Kur ndodh kjo, kompania bazë dhe operatori virtual janë gjithmonë komplementar me njëri-tjetrit, i ndihmojnë njëri-tjetrit. Për këtë arsye kontratat e tilla i përmbajnë katër elemente së paku: kufizimin e abonentëve, mbrojtjen nga antidampingu, moskonkurrencën e ndërsjellë për marrjen e klientëve të njëri-tjetrit si dhe kufizimin gjeografik të operacioneve të shitjes.

Kurse në Kosovë Z. Mobile, për të cilin ka punuar me zell edhe ministri Lluka, e ka ngrënë dhe është duke e ngrënë Telekomin e Kosovës, ajo është krijuar për ta gllabëruar Telekomin e Kosovës dhe për ta bankrotuar Valën.

Ia ka marrë klientët duke përdorur metoda jokonvencionale, edhe kundër tregut të lirë, si dhe tash së fundit, edhe me oferta pa limit e pako jashtë logjikës së tregut.

Telekomi, pra, nën direktivat e pushtetit ia ka ofruar një kompanie private privatizimin e profitit dhe krijimin e operatorit që ia merr konsumatorët Valës dhe e çon atë drejt humbjeve dhe drejt falimentimit.

Kjo është një shkelje e pafalshme, e cila duhet të ndëshkohet. Deri këtu është episodi i parë i krimit të organizuar.

Tash vjen episodi i dytë i krimit të organizuar.

Sikur të mos mjaftonte kjo, Z-Mobile e paditi Telekomin në arbitrazh. Padia ka të bëjë me moszbatimin e plotë të marrëveshjes. Arbitrazhi vendosi në favor të Z-Mobile dhe unë mendoj që kjo lëndë është humbur qëllimisht.

Telekomi nuk është mbrojtur fare në arbitrazh, 600 mijë euro kanë shkuar, askush nuk e di ku dhe për kë, për një mbrojtje që nuk ka ndodhur kurrë.

Pra, jo vetëm që Dardafoni përfitoj qindra miliona nga një kontratë skandaloze dhe në dëm të interesit publik, por tash dëshiron t'ia marrë Qeverisë së Kosovës, në këtë rast buxhetit të Republikës së Kosovës, edhe 30 milionë euro shtesë.

Vetëm një pyetje e kanë qytetarët e Kosovës sot: Këto 30 milionë euro që mafia do t'ia vjedhë Kosovës, kush me këndë i ndan, kush prej politikës, e kush prej biznesit?

Zonja dhe zotërinj,

Për ta shpëtuar Telekomin e Kosovës nga bankrotimi duhet të ndodhin tre hapa të domosdoshëm.

Hapi i parë është që Qeveria e Kosovës ta zbatojë një rezolutë, e cila është në fuqi në Kuvendin e Kosovës, ajo rezolutë është miratuar prej shumicës sonë që ndodhemi këtu, me shumicë të votës së deputetëve, në korrik të vitit të kaluar.

Hapi i dytë është mosnjohja e kurrfarë borxhit të Kosovës nga ana e Qeverisë ndaj Z-Mobile. Kosova nuk i ka kurrfarë borxhi Dardafonit, po Dardafoni i ka shumë borxh Kosovës, në mënyrën qysh i ka fituar milionat e gatshëm.

Dhe, hapi i tretë, duhet të jetë mosvazhdimi i kontratës me Z-Mobile. Qeveria është aksionari i plotë i Telekomit, licenca e Telekomit skadon pas dy muajsh, pra në korrik, pastaj përtërihet. Kështu që tash për tash Qeveria konsideroj që i ka në dorë krejtësisht të drejtat ligjore për të mos vazhdojë kontratën me Z-Mobile.

Zoti kryeministër,

Tash po ju drejtohem juve, nëse ministri juaj Lluka është i kapur nga Z-Mobile, ju e keni rastin që të tregoni se nuk jeni i shitur te ta. Merreni situatën në kontroll e mos e vazhdoni kontratën e dëmshme që ia humb Kosovës qindra miliona euro me Z-Mobile.

Të nderuar deputetë,

Pas diskutimeve dhe në bashkëpunim me grupet parlamentare si dhe pas harmonizimit të disa pikave që do t'i bisedojmë këtu, ne do t'ia paraqesim Kuvendit një rezolutë, në të cilën përfshihen domosdoshmërisht ato tri pika jetike, të cilat unë i shpjegova. Faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit!

Glauk, më ke përmendur. Po e marr edhe unë fjalën, po e shfrytëzoj, ja, edhe Kadri Veseli, a po e sheh, po harron edhe çka ke folur, po kërkoj leje prej teje dhe po e marr fjalën. Jo, më ka përmendur.

Unë e pranoj rregullën tuaj, veç pastaj mos m'u hidhëroni kur jua bëj të shkojnë me Rregullore. Atëherë u krye, u krye, veç Rregulloren ta respektojmë, mos u nervozoni kur ta respektoj.

Kryeministrit i japim fjalën, se po e kërkon me insistim, se paska të lëvizë, e keni thirrur, kryeministër, fjala për ju.

**KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ:** Me të vërtetë është një temë me rëndësi dhe i kam pastruar një pjesë të agjendës, është një delegacion prej Uashingtonit, 12:00 deri në 14:00 jam i detyruar të jem me ta, se është keq t'ua ndërroj agjendën, takimet e tjera i kam fshirë sot për këtë seancë.

Unë e kam përgatit një shpjegim lidhur me atë që ka ndodhur, pra prej rezolutës deri sot. Pastaj gjatë diskutimeve do të mund të kyçem prapë, në ato të gjetura ose si mendojmë ne më tutje.

Është mirë ta themi kështu se Ministria e Zhvillimit Ekonomik pra e ka filluar një proces të ristrukturimit në partneritet me EBRD-në, ka qenë kërkesë të ndërtohet një trupë e përkohshme, pra është kërkuar që shtabin e krizës ta krijojmë, pra në këtë frymë ka filluar një mekanizëm Kosovë-EBRD, EBRD është e jashtme, nuk ndikohet prej palëve të brendshme, po ashtu nuk është vetëm në kosto të Kosovës ky partneritet, po e merr EBRD koston e caktuar. Shkaku pse

nuk është përmbyllur kjo, EBRD është pak më e ngadalshme se sa nevojat që i kemi ne, pra ata në proces janë më të ngadalshëm.

Në këtë partneritet, pra të BERZH-it me ristrukturim është përfshirë Ministria e Zhvillimit Ekonomik, po termat e referencës janë zhvilluar për dy palë, pra nuk është vetëm një koncept i ministrisë, po është një veprim i përbashkët me EBRD-në edhe ekspertët janë të jashtëm, pra nuk janë njerëz që ndikohen nga palët e brendshme, në këtë rast, nga partitë apo nga grupet e interesit. Nga Bordi aktual i PTK-së ka filluar procedurë shkarkimi, po ata janë dorëhequr pastaj gjatë procesit, pra dy anëtarë të bordit. Për njërin ju e dini si ka qenë rasti i punësimeve të pjesëtarëve të familjes, pra ju keni kërkuar auditim me rezolutës, pas rezolutës Qeveria ka kërkuar menjëherë që auditori të fillojë auditimin, pra auditimi është në proces, është në përfundim. Pra, kemi kërkuar në bazë të drejtës dhe autorizimit që na keni dhënë.

Qeveria e Kosovës, pra kjo Qeveri nuk ka tërhequr dividendë nga Telekom, në të kaluarën qeveritë kanë marrë dividendë, pra i kanë marrë paratë e fitimit, e kjo qeveri s'ka pasur si të marrë, se edhe ashtu s'ka para, nuk kemi marrë. Ka filluar shqyrtimi i marrëveshjes së drejtuar, të drejtorit të kaluar, pra Agron Mustafa, me Z-Mobile, dhe kjo marrëveshje është anuluar, një marrëveshje për shtyrje me borxhe të disa kostove, sepse vetë Z-mobile është tërhequr, ju e dini pra këtë fakt. ARKEP ka angazhuar një kompani konsulente për procesin e tarifave të reja për licencim që ka përfunduar punën gjashtëmuajore në mars të vitit 2019. ARKEP ka pranuar komentet e operatorëve dhe është në përfundim të përpilimit të njoftimit për brezin frekuentor që duhet të paguajnë Vala dhe Ipko. Licencat, sikurse e dini përfundojnë, më 31 korrik 2019, sikur e konstatuat edhe ju dhe e dini këtë fakt. Kodi i Serbisë +381 është ndaluar në Kosovë, pra nga qershori i 2018, Kodi +377 është ndërprerë, Kodi +386 ndërpritet më 1 qershor. Pra, ARKEP ka publikuar informatat lidhur me Kodin +383, që do të thotë pastrohet gjendja prej këtyre fare prefikseve e kodeve të tjera që e kanë pasur koston negative për Kosovën. Negative në kuptimin nuk janë inkasuar të hyrat.

Sa i përket përmbledhje për kontratën me Z-Mobile, pra kontrata tjetër, jo ajo që është anuluar. Për t'iu shmangur një arbitrazhi të dytë, ju lutem, dëgjoni me vëmendje, me Z-Mobile, i cili do të shkaktonte humbje, është krijuar një mekanizëm i shqyrtimit të kontratës, kontrata është e lidhur me licencë, pra e ka fatin e vet të lidhur me jetëgjatësinë e licencës, e që e ka afatin deri në korrik 2019. Tash, siç parashihet në kontratë, gjashtë muaj më herët jemi në proces të negociatave me Z-Mobile, edhe me një kompani konsulente për të bërë analizën e kontratës. Këtu janë angazhuar edhe ekspertë juridikë për të parë arsyeshmërinë e kontratës. Pas këtyre dy proceseve ne mund të marrim vendim lidhur me tërheqje nga kjo kontratë, po të mos ishte bërë ky proces, ne do të ishim në disavantazh për arbitrazh potencial. Pra, ta shpjegojmë, unë jam kryetari i Qeverisë, e njoh Blerim Devollin, e respektoj shumë, ju siguroj këtë, djali i Ibrahim Devollit, sipërmarrës i zoti, edhe punëson njerëz të Kosovës dhe paguan tatime. Mirëpo, interesin e kompanisë publike nuk ia kam borxh kurrkujt ta dëmtoj për hatër të një interesi të një sipërmarrësi. Pra, me

respektin më të madh për secilin, nëse bordi aktual ose drejtori aktual nënshkruan kontratë të dëmshme me operatorin privat, me këtë rast, ai merr përgjegjësitë ligjore, pra ai duhet të bëhet objekt i shqyrtimit ligjor atëherë, pse ka ndodhur ashtu. Çdokush që mban përgjegjësi sot në Telekom, qoftë drejtori, qoftë anëtarët e bordit, prej kësaj foltore po e dëgjojnë, nëse e dëmtojnë interesin e kompanisë duke vazhduar një kontratë që i sjell dëme kompanisë edhe që i zbret pra parametrat e profitit, e të punës, e të suksesit të kompanisë, atëherë ata mbajnë përgjegjësinë ligjore, këta njerëz.

Pra, kjo është ajo që dua t'ju them juve, pse? Ne nuk e pasurojmë Kosovën duke e dëmtuar një kompani publike në interes të një operatori privat. Nëse ka terma të biznesit që e lejojnë pra një partneritet me kompaninë private, pa qenë në dëm të kompanisë publike, besoj edhe ju i kishit thënë po, por nëse kjo bëhet në dëm të kompanisë publike dhe duhet të bankrotojë PTK-ja, atëherë unë i kam një numër të masave që jemi duke i ndërmarrë realisht për rikthimin e gjendjes së të bërit biznes në kompani, nuk jua lexova krejt këto, se janë duke i ndërmarrë tash, ata që janë në përgjegjësi, edhe drejtori aktual, edhe bordi, por për ato me siguri do t'ju them gjatë ditës. Po këto ishin më shumë informata nga rezoluta paraprake, si është gjendja sot dhe si mundet sikur të kishim ndërmarrë ndonjë veprim arbitrar të shpëputjes së kontratës me Z-Mobile, qysh është propozuar në rezolutë, do të kishim problem serioz pastaj, se shiko, gjykatat ndërkombëtare megjithatë po e bëjnë punën e vet. Edhe një problem, shkarkimi i bordeve, ju e dini si zgjidhen bordet, si shkarkohen. Pra, janë disa procedura që duhet të gjithë t'i dinë paraprakisht, por edhe një herë them, u bëj thirrje të gjithëve që kanë përgjegjësi në kompaninë Telekom të mos ndërmarrin veprime në dëm të kompanisë publike, kushdo që bën një vepër të tillë, përgjigjet vetë para ligjit, kushdo qoftë. Faleminderit!

*(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetarja e Kuvendit, znj. Myfera Shinik.)*

**KRYESUESJA:** Faleminderit, kryeministër! Fjalën e ka shefi i Grupit të LDK-së, zoti Avdullah Hoti, urdhëroni!

**AVDULLAH HOTI:** Faleminderit, kryesuese e seancës!

Të nderuar deputetë,

Kuvendi sot për të dytën herë në seancë të jashtëzakonshme po debaton për gjendjen në Telekomën e Kosovës.

Më 12 korrik 2018 ky Kuvend ka miratuar një rezolutë, ku i kërkon Qeverisë të ndërmarrë masat e nevojshme për të nxjerrë Telekomën nga gjendja e rëndë financiare. Në atë rezolutë, në mes tjerash, i kërkohet Qeverisë të zbatojë Ligjin për ndërmarrjet publike, asgjë më shumë dhe të anulojë çdo vendim që bie ndesh me këtë ligj. Të nisë ristrukturimin e Telekomit, përfshirë ngrirjen e punësimit dhe të pozitave udhëheqëse, të bëjë auditimin e plotë të kompanisë, të kërkojë nga Telekomën të tërhiqet nga marrëveshja me kompaninë Z-Mobile, për këto masa,



Kryeministri është dashur të raportojë jo më larg se 30 ditë nga miratimi i rezolutës, dhe gjithashtu brenda kësaj periudhe Komisioni për Zhvillim Ekonomik është dashur ta informojë Kuvendin e Kosovës për veprimet e ndërmarra. Asnjë nga këto masa nuk është ndërmarrë, përveç komisioneve dhe trupave të ndryshme që qenkan themeluar në Qeveri, por që nuk kanë dhënë asnjë rezultat. Përkundrazi, është thelluar kriza më tutje. Është rritur punësimi mbi baza të pastra nepotiste dhe politike. Auditim nuk është bërë dhe Kryeministri nuk ka raportuar fare në Kuvend.

Si ka operuar Telekomit gjatë 10 vjetëve të fundit? Në vitin 2007 ka pasur 182 milionë fitim. Ndërkaq, në vitin 2017 ka deklaruar 13.8 milionë humbje. Gjatë viteve 2007-2017, ndërkohë që të hyrat ishin në rënie, shpenzimet për paga dhe marketing ishin në rritje, që është kundër çfarëdo logjike ekonomike. Por, pse po falimenton sot Telekomit?

E para, Telekomit nuk po falimenton për shkak se nuk ka treg. Telekomit po falimenton për shkak të kontratave të dëmshme me kompani private, që po e shfrytëzojnë Telekomit pa asnjë kriter ekonomik dhe të përfitimit të ndërsjellë. Këto kontrata janë bërë për të shkatërruar Telekomit dhe për të përfituar grupe të caktuara. Kontrata me Z-Mobile, me zero investime nga Z-Mobile, i ka sjellë kompanisë Z-Mobile mbi 100 milionë euro të ardhura. Një ish-drejtor i Telekomit ka deklaruar publikisht se ish-kryeministri Thaçi i ka bërë presion për ta nënshkruar këtë kontratë. Mbrojtja e Telekomit në arbitrazh është neglizhuar nga ish-menaxhmenti, që i ka mundësuar Z-Mobile ta fitojë rastin. Tani, për shkak të borxhit, Z-Mobile po e mban nën presion Telekomit për t'i mundësuar vazhdimin e kontratës. Menaxhmenti i Telekomit ka krijuar një komision për të dhënë opinion lidhur me mundësitë e vazhdimin të kësaj kontrate. Ka paqartësi se si të vazhdohet tutje, si nga ana e menaxhmentit dhe aksionarit që në këtë rast është Ministria e Zhvillimit Ekonomik, ka gjasa që kjo të bëhet qëllimisht për të skaduar afati i reagimit, në mënyrë që kontrata vazhdohet në heshtje.

E dyta, Telekomit po falimenton për shkak të qindra punësimeve dhe gradimeve pa asnjë kriter. Në muajt e fundit, kur duhet të vendosej moratorium në punësime dhe avancime, që të mos rriteshin shpenzimet, ka vazhduar punësimi i militantëve dhe anëtarëve të ngushtë të familjeve të zyrtarëve të PAN-it. Në një emision televiziv, një deputet pati deklaruar se po të kishte mundësi, vetëm anëtarët e AAK-së do t'i punësonte. Në shumë raste ka gradime të militantëve politikë, fillimisht të punësuar pa konkurs dhe kriter.

Të nderuar deputetë,

Telekomit po falimenton për shkak të qindra lëndëve në gjykata, për të cilat nuk ka vëmendje nga Telekomit. Inkasimet janë duke ndodhur nga përmbauesit privatë, që rrezikojnë bllokimin e llogarive. Telekomit nuk ka ide për riskun e ekspozimit ndaj këtyre rasteve. Anëtarët e Bordit aktual dhe ata më herët kanë privilegje që nuk i lejon Ligji për ndërmarrje publike. Ata ndërhyjnë në operacionet ditore të Telekomit, që është e ndaluar me ligj. Ka shumë licenca që

kanë skaduar dhe Telekomit nuk ka mundësi financiare për t'i vazhduar dhe kjo rrezikon operimet e Telekomit dhe sigurinë kombëtare. Shumë sisteme në Telekomit tani nuk kanë fare mirëmbajtje dhe kjo gjithashtu rrezikon sigurinë kombëtare. Janë bërë shumë kontraktime të shërbimeve që mund të kryhen nga punëtorët e Telekomit, sidomos shërbime të shitjes, ndërkaq Telekomit vazhdon punësimin e agjentëve të shitjes. Plani i biznesit në këtë kompani nuk është realizuar në 5 vjetët e fundit dhe askush nuk ka dhënë përgjegjësi. Mendoj, që këtu ka dështuar edhe Ministria e Zhvillimit Ekonomik në vazhdimësi si aksionar i autorizuar i qeverisë. Telekomit ka shpenzime të pakontrolluara dhe pa kriter të marketingut dhe sponsorimeve. Sipas të dhënave, Departamenti i Marketingut ka mbi 100 punëtorë, por shumica e punëve të marketingut kryhen nga kompani private.

Në disa departamente, përveç drejtorit, ka 3 e më tepër zëvendës drejtorë të emëruar pa asnjë kriter, me lidhje politike dhe pa eksperiencën e nevojshme për të kryer punën e tyre. Shumica e kryeshefave ekzekutivë janë hetuar apo janë në proces të hetimit, që është dëshmia më e qartë për shkeljet e vazhdueshme ligjore që bëhen në këtë kompani. Punonjësit me përvojë dhe kontribuues në rritjen e mëhershme të Telekomit që janë aseti kryesor i kësaj kompanie, janë degraduar dhe janë lënë anash, në vend të tyre punësohen militantë partiakë apo shërbimet kontraktohen jashtë kompanisë.

Të nderuar deputetë,

Telekomi i Kosovës ka nevojë për një auditim ndërkombëtar, por që është kredibil, për të ditur se cilat janë kontratat e dëmshme, të cilat duhet të ndërpriten urgjentisht. Vetëm pasi të zbardhet e vërteta dhe të vihet drejtësia në vend, Telekomit duhet t'i lejohen që të bëjë investimet për t'u kthyer në kompani rentabile, për t'ia rritur vlerën e tregut. Telekomit ka rëndësi ekonomike dhe shtetërore e të sigurisë. Prandaj, duhet të trajtohet me seriozitetin e duhur nga të gjitha institucionet kompetente që janë të thirrura me ligj për të mbikëqyrur punën e kësaj kompanie. Por, një gjë është e qartë se Telekomit nuk mund ta nxjerrin nga kriza ata që kanë dërguar buzë falimentimit. Faleminderit!

**KRYESUESJA:** Faleminderit, zoti Hoti! Fjalën e ka prej Grupit Parlamentar të PDK-së, deputeti Memli Krasniqi.

**MEMLI KRASNIQI:** Faleminderit, e nderuar kryesuese!

Të nderuar deputetë,

Jemi prapë edhe në një seancë të jashtëzakonshme, e 14-a me radhë, besoj, në katër muaj e gjysmë dhe pa dyshim si dhe shumë tema të tjera, fatkeqësisht, apo si shumë thirrje të tjera është një farsë, të cilën normalisht ligji ia mundëson opozitës që ta bëjë edhe në këtë Kuvend, edhe para opinionit publik në Kosovë. Është pra një vazhdimësi e mashtrimit, e farsës dhe e gënjeshtërsisë që i bëhet opinionit publik, duke tentuar të paraqitet një situatë krize dhe një gjendje të jashtëzakonshme në Republikën e Kosovës, gjë që s'është.

Kjo tregon, në fakt, krizën e opozitës, sepse këta kanë mbetur pa tema, këta s'kanë tema, krejt temat të cilat i kanë pasur në të kaluarën, i kanë humbur, s'kanë më terren dhe normalisht që duhet të merren me diçka që të jenë aktual në publik. Jo se është shpikur tema e problemit të Telekomit, sepse është temë me të cilën është marrë edhe kjo legjislaturë apo edhe kjo Qeveri, njëjtë qysh është marrë edhe ajo legjislatura e kaluar dhe qeveria e kaluar, por që tash ky Kuvend, përveç edhe një seance tjetër të jashtëzakonshme që është mbajtur për këtë çështje, e ka edhe një Komision Hetimor Parlamentar, të cilin e kemi votuar të gjithë bashkërisht dhe ky Komision Hetimor Parlamentar që përbëhet prej përfaqësuesve të të gjitha grupeve parlamentare, tashmë e ka filluar punën, është ndoshta në mesin e punës së vet, në mënyrë aktive, nga njoftimet që i kemi, është duke punuar, pikërisht për t'i hetuar dhe për të dalë me konkluzione dhe me një raport, i cili do t'u jepte një përgjigje, shpresojmë, krejt këtyre hamendësimeve, krejt këtyre akuzimeve, etiketimeve, të cilat në mënyrë kaq të lirshme i mundëson imuniteti i deputetit të thuhet në foltoren e Kuvendit.

Ta zëmë, kryeministri ishte para pak minutash në foltore, i dha shpjegimet e veta, e dha mendimet e veta, por opozita nuk e ka thirrur këtë seancë për të marrë mendimet e kryeministrit, as për t'u besuar. Ky është problemi. Seanca edhe një herë është këtu për të bërë zhurmë dhe për të krijuar mjegull, jo për të gjetur zgjidhje, sepse është shumë e thjeshtë, nëse do dikush ta analizojë. Seanca është thirrur prej Vetëvendosjes dhe LDK-së. Vetëvendosja s'ka qenë në pushtet, unë s'besoj që do të jenë ndonjëherë në pushtet dhe kanë njëfarë arsytimi moral edhe të flasin për këtë punë, por LDK-ja që ka qenë në pushtet deri para një viti e gjysmë, e ka udhëhequr Qeverinë e Republikës së Kosovës, ka qenë në pushtet edhe në vitet 2008-2011, ka qenë në pushtet në krejt vitet e pasluftës, ka pasur ndikimin drejtpërdrejt me zyrtarët e lartë të vet në menaxhimin e udhëheqjen e krejt ndërmarrjeve publike në kohën para shpalljes së pavarësisë, me borde, me punësime, me menaxhime, me të tëra, edhe sot të dalë e të na kallëzojë qysh duhet bërë punët, të cilat s'i kanë bërë vetë, e pse s'i kemi bërë bashkë.

Kjo është arsyeja që, e thashë në fillim është veç një farsë, ndoshta si pasojë e mungesës së temave, sepse temat për fat të mirë ua ka marrë koalicioni. Tash, rezoluta të cilën e kemi miratuar në Kuvend, ju e dini qysh është miratuar rezoluta, e tha kryeministri që disa prej atyre pikave veç janë trajtuar a janë në trajtim e sipër. Rezoluta mbi të gjitha ka qenë, së paku në pikën e dytë, e paligjshme. Kur e kemi diskutuar për harmonizim, unë kam thënë, rezoluta në të cilën po thirren Vetëvendosja e LDK-ja, kërkon masa të dhunshme. Prej '89-ës, '90-ës në këtë vend masa të dhunshme kur ka futur Serbia në krejt institucionet e Kosovës, kurrkush s'e di që ka kërkuar përveç kësaj rezolute masa të dhunshme. Pika e dytë në mënyrë krejt të kundërligjshme, për shembull, kjo ka qenë arsyeja pse ne s'kemi pasur mundësi të dakordohemi rreth tekstit të rezolutës, sepse nuk janë tërhequr. Kanë thënë të angazhohet një institucion kompetent për menaxhim emergjent të ndërmarrjes deri në konsolidimin e plotë të saj.

Pra, të çohet në shtëpi krejt menaxhmenti, të instalohet një menaxhment i ri, një institucion kompetent. Kush është institucioni kompetent? Pse në tekstin e mëhershëm ka dalë njëfarë organizate ndërkombëtare, me siguri kanë menduar private, korporatë, çka di unë, se kjo edhe e menduar tamam nuk ka qenë, se po të ishte e menduar mirë, nuk do të kishte dalë në këtë formë, po, thjesht, është kërkesë për masa të dhunshme. Tash sërish po duam të bëjmë ndarjen. Hajde, Vetëvendosja të lypë diçka të tillë, po qysh të lypë LDK-ja masa të dhunshme! Po, s'keni pasur nevojë për masa të dhunshme, se keni pasur pushtetin, e keni udhëhequr Qeverinë. Pse s'e keni bërë ju, ose pse s'e kemi bërë bashkë, se tash thoni "kemi qenë bashkë". E vërtetë, kemi qenë bashkë.

Pra, edhe rezoluta si e tillë, përveç disa pikave, që absolutisht ne i kemi mbështetur edhe në atë kohë, por s'kemi mundur t'i votojmë si të tillë për shkak të disa pikave të tjera, njërin prej tyre e përmenda, me të vërtetë kërkon disa hapa që janë të nevojshëm për ta qartësuar situatën aty. Sepse kjo që thashë, në asnjë mënyrë nuk nënkupton që s'ka probleme në Telekom. Probleme në Telekom ka shumë, janë probleme të verifikuara, të dokumentuara edhe në opinionin publik. Nepotizmi është tashmë i verifikuar, i dokumentuar, por a mund të më tregoni diçka, cili është dallimi i atyre familjarëve, deputetëve të Vetëvendosjes dhe deputetëve të LDK-së dhe deputetëve të PDK-së dhe deputetëve të AAK-së dhe deputetëve të tjerë, pasi që veç po flasim për deputetë. A deputetët e Vetëvendosjes i kanë pasur familjarët e punësuar me meritë, e këta deputetët e partive të tjera i kanë pasur me nepotizëm? Qysh është ky dallim? Apo ka qenë ndonjë ligj që nuk e lejon atë në mënyrë tjetër?

Unë jam për të bërë verifikim për krejt, edhe mandej të këqyrim ku po del. Kjo është puna e këtij Komisionit Hetimor. Tash, pak dikush mund të thotë që edhe kjo seanca ndoshta është për të influencuar në mënyrë të padrejtë punën e Komisionit Hetimor, po hajt s'po themi ashtu. Komisioni Hetimor duhet të merret edhe me atë punë, besa mund të merret edhe me statistika. Ta zëmë, sa njerëz janë punësuar gjatë kohës kur kryeministër i Kosovës ka qenë Isa Mustafa? Sa janë punësuar kur ka qenë kryeministër Ramush Haradinaj? Eh, ta këqyrim pak! A qenkan krejt të zezat e Telekomit që një vit e gjysmë. Jo more, po problemet e Telekomit kanë filluar prej para 15 vjetësh. Problemet e mëdha në Telekom dhe e mbrapshta iu ka dhënë në fillimet e veta, e besa edhe për kontratën e Z-Mobilit është mirë të kallëzohet drejt ata që dinë. E kur po them të kallëzohet drejt, ama bash drejt, edhe qysh qenka bërë, edhe kush e ka miratuar, kush ka lobuar, kush e ka shtyrë, a ka pasur ndonjë kundër, se po e shoh që disa kanë dalë tash kundër. Ngadalë, se partitë e njëjta keni qenë edhe atëherë, as emrat e partive s'i keni ndërruar, ndoshta e keni ndërruar ndonjë kryetar aty-këtu, po emrat e partive i keni të njëjtë, njerëzit e njëjtë gati i keni në lidhshmëri. Ndoshta atëherë keni qenë shumë pro, e tash qenkeni bërë kundër. Unë nuk po dua të hyj në paragjykimet të raporteve personale biznesore që mund t'i keni me njerëz të caktuar, e ndoshta ndonjëherë i keni pasur më mirë, e ndonjëherë i keni më keq, ose i keni pasur më keq i keni më mirë, por, unë ju them personalisht, jam bash 100% në favor të zbulimit të krejt prapaskenave, që i tha dikush, po edhe të atyre prapaskenave, nëse është e nevojshme.

Edhe atëherë, le ta marrë secili përgjegjësinë e vet. Pse? Sepse, fundi i fundit, ne duhet të pajtohemi, besoj, për një send, që një prej aseteve më të rëndësishme ekonomike është Telekom, ka qenë kompani shumë profitabile. Unë e mbaj mend kur Qeverisë i ka dhënë edhe 15 milionë euro dividend në vit. Po e mbaj mend edhe kur i ka lypur Qeveria dividendë, ka qenë në gjendje të japë dhe tash e shohim krejt që është në gjendje që duhet të lypë mjete prej Qeverisë për të mos falimentuar. Është e dhembshme në çfarë dite ka ardhur Telekom. Po, a është përgjegjësia krejt e njëanshme? A është përgjegjësia krejt e thjeshtëzuar, kështu qysh po mundohet të paraqitet edhe në disa deklarime sot dhe në këtë seancë, besoj edhe në deklarimet që do të pasojnë? Nuk është. Absolutisht, nuk është.

Për këtë arsye i kemi dhënë mbështetje Komisionit Hetimor dhe për këtë arsye e rikonfirmojmë mbështetjen e këtij komisioni, sepse mendojmë që është shumë me rëndësi që ky komision të nxjerrë konkluzione dhe një raport të qartë, i cili ndan edhe detyra, obligon të gjitha institucionet, prej Prokurorisë dhe gjykatave, po edhe Qeverinë, edhe Kuvendin, pse jo, dhe këdo tjetër, për të arritur ndoshta një objektiv të vetëm, atë që lirisht tash mund të themi, shpëtimin e Telekomit, sepse Telekom është në gjendje të rëndë. Po, duke e shpëtuar Telekom, besa e shpëtojmë edhe Postën e Kosovës, që s'po e përmend askush, sepse pas ndarjes së Postës dhe Telekomit, ju e dini që varësia e Postës nga performansa pozitive e Telekomit është 100%.

Kështu që, po e përmbyll, duke thënë që absolutisht unë kam dyshime të plota, kam bindje të plotë që edhe kjo seancë nuk është bërë për të gjetur ndonjë zgjidhje, ose prej ndonjë derti apo kujdesi të madh që keni për Telekom. Është bërë për të bërë zhurmë dhe për të bërë tema nëpër portale sot gjatë ditës, sepse tema të tjera të rëndësishme s'keni. Po megjithatë, nëse përnjëmend dëshironi të bëni diçka, atëherë kalojmë në Komisionin Hetimor, ku janë të gjithë bashkë dhe që e udhëheq opozita, ta kryejë punën e vet, e pastaj marrim hapa të tjerë. Faleminderit!

**KRYESUESJA:** Faleminderit, zoti Krasniqi! Shkojmë me rend. Prej Grupit Parlamentar Lëvizja Vetëvendosje, zonja Albulenë Haxhiu. Urdhëroni!

**ALBULENA HAXHIU:** Faleminderit!

Të nderuar deputetë të Kuvendit,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Sindikata e Telekomit,

Punëtorë të Telekomit që po e përcillni këtë seancë të jashtëzakonshme,

Për të sqaruar, sepse duket se Memli ose s'po do, ose qëllimisht e mban atë fjalë dekurajuese dhe dëshpëruese. Kjo seancë e jashtëzakonshme është thirrur për shkak të kërcënimeve të fundit që Z-Mobile i ka bërë Telekomit të Kosovës.

Dhe, natyrisht, përballë këtyre kërcënimeve ne duhet të kemi veprime. Në qoftë se Qeveria hesht, në qoftë se kryeministri hesht, në qoftë se ministri hesht, atëherë natyrisht se duhet të flasë

Kuvendi i Republikës së Kosovës. Prandaj, pikërisht duke u nisur nga kërcënimet që Z-Mobile ia ka bërë Telekomit të Kosovës, ne kemi marrë veprime të menjëhershme dhe e kemi thirrur këtë seancë të jashtëzakonshme, ndonëse juve ju pengojnë seancat e jashtëzakonshme. Çka kemi ne faj si opozitë që ju s'mund ta bëni kuorumin dhe t'i votoni projektligjet që i sjell Qeveria. Ne e shtyjmë përpara agjendën tonë. Mos bëni ju skandale, ne s' thërrasim seanca të jashtëzakonshme. Sa herë ju të prodhoni skandale, do të ketë një seancë të jashtëzakonshme, derisa t'ju heqim përgjithmonë.

Dje në mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit kemi kërkuar që në këtë seancë të jetë i pranishëm edhe kryetari i Sindikatës së Telekomit, zoti Lahmi Balaj. Domethënë, ka qenë e rëndësishme që këtu para deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës, kryetari i Sindikatës të mbajë një fjalë për deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës. Mendoj se ka qenë gabim që Kryesia e Kuvendit, konkretisht kryetari i Kuvendit, Kadri Veseli, nuk e ka lejuar që ta kemi një rast si deputetë të Kuvendit të dëgjojmë nga kryetari i Sindikatës se çfarë ka të thotë ai sa i përket kësaj kontrate të dëmshme, që konsiderohet që buxheti i shtetit është dëmtuar për 200 milionë euro nga lidhja e kësaj kontrate të dëmshme. Dhe thuhet që s'është praktikë, po hajde ta bëjmë për herë të parë. Dhe kur deputetët e Kuvendit e shohin të rëndësishme që ta kemi dhe ta dëgjojmë një kryetar të Sindikatës, ose një drejtues të një institucioni, pse të mos e thërrasim. Pse të mos e thërrasim që të kuptojmë, ose po frikësoheni se çfarë ka për të thënë Sindikata.

Ne në Komision Hetimor i kemi pasur kryetarin dhe dy bashkëpunëtorë të Sindikatës, neve na kanë dhënë informacione të cilat i kemi dëgjuar për herë të parë, e ndoshta kjo do të mund të na ndihmonte që edhe ne si deputetë të kemi më shumë informacione dhe pastaj, mbi bazën e atyre informacioneve t'i kemi edhe qëndrimet në këtë seancë.

Më tutje, i nderuar zoti Krasniqi, shef i Grupi Parlamentar të PDK-së, kjo seancë nuk do të thirrej në qoftë se ne do ta kishim një Qeveri të përgjegjshme dhe që do të respektonte rezolutën e Kuvendit të datës 12 korrik 2018. Përveç tjerash, janë dy pika të asaj rezolute që qëllimshëm janë shpërfillur nga Qeveria, po edhe nga Prokuroria, sepse pika e 7-të dhe pika e 12-të e asaj rezolute janë jashtëzakonisht të rëndësishme, janë të gjitha, por sidomos këto. Neni 92, paragrafi 3 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës obligon Qeverinë që të zbatojë akte që nxirren nga Kuvendi, por siç e kemi thënë edhe më parë, Qeveria e Republikës së Kosovës po i konsideron rezolutat e Kuvendit si "tavolinë suedeze", ku merr çfarë do dhe lë ato që s'i do.

E përmendi kryeministri një pikë të rezolutës që ka të bëjë me auditimin. Po as auditimi s'po bëhet siç duhet, po bëhet vetëm formalisht, sepse po të bëhej siç duhet, do të shihni se çfarë informacionesh do të merrni nga ai auditim. Kur ishte puna këtu për rezolutën që legjitimonte tendencën e Hashim Thaçit për shkëmbimin territorial, projektin e tij të rrezikshëm, menjëherë filluat me veprime përcjellëse për ta vënë në zbatim atë rezolutë. Ndërsa, kur është fjala për zbatimin e një rezolute, e cila ka për qëllim rimëkëmbjen e Telekomit, shpëtimin e një

ndërmarrjeje, një gjiganti ekonomik, ju heshtni, nuk ndërmerrni asnjë veprim, edhe përkundër faktit që Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe, e keni obligim, sepse jeni aksionarë. Pra, nuk respektoni as vendimet e Kuvendit, vullnetin e qytetarëve të Republikës së Kosovës, sepse tek e fundit, ne jemi këtu përfaqësues të popullit.

Kryeministri tha që ne kemi ndërmarrë veprime andej e këndeje, por sipas informacioneve që kemi nga menaxhmenti dhe Bordi i Telekomit, ata i kanë kërkuar Qeverisë 6.9 milionë euro, për disa arsye: për mirëmbajtje. Vala është operatori i vetëm në botë që nuk ka përkrahje nga prodhuesi i sistemeve me të cilat operon. Kodin, Vala vazhdon të jetë operator monakez, SIM-kartelat nuk janë ndërruar. Monako vazhdon të na i marrë 6 milionë euro në vit.

Përgjimi ligjor, kjo instancë e rëndësishme vazhdon të mos funksionojë në Vala. Pra për këto menaxhmenti dhe Bordi i ka kërkuar kryeministrin, ministrin Lluka, që t'ua japë 6.9 milionë. Pastaj do t'ua kthejë, sepse 500 milionë euro Telekomit ia ka dhënë shtetit prej se ekziston. Pse tash kur Telekomit është në nevojë, Qeveria s'ia jep? Ministri na thotë në komision që ata s'e kanë arsyetuar mirë kërkesën?

Po mirë, bre ministër, a mund të shkosh deri në Telekom, t'i pyesësh çfarë keni menduar me këtë kërkesë? A e ke të mundur? Ose, kryeministri, thjesht ministrin e Financave nuk e paska bindur kërkesa e Telekomit! Siç e kemi thënë edhe në vazhdimësi, kontrata me Z-Mobile është produkt i krimin të organizuar. Sikur të kishte institucione të drejtësisë të pavarura, ne pa dyshim që nuk do të ishim në këtë situatë, as Komisioni Hetimor nuk do të ishte, sepse s'kishte pasur nevojë të hetonte kontrata, 13 sosh. 90% e kontratave, merreni me mend, tash e kemi marrë dokumentacionin. 90 për qind e kontratave që ka nënshkruar menaxhmenti, bordi e të tjerë, janë të dëmshme. Nuk i kanë sjellë asnjë të mirë Telekomit të Kosovës. përkundrazi. E kanë zhytur në borxhe. Dhe, pikërisht nëse do të vepronte Prokuroria, këtu do të ishte edhe çelësi i zgjidhjes së problemit. Sepse për të shpëtuar buxhetin e shtetit nga oligarkët, pra për të shpëtuar djersën e punëtorëve të Telekomit, Prokuroria duhet të nisë hetimet mbi lidhjen e asaj kontrate të dëmshme.

Siç e dini, siç e keni votuar vetë, Kodi Penal i Republikës së Kosovës e parasheh si vepër penale lidhjen e kontratës së dëmshme. Tash, ne nuk jemi profesionistë, nuk jemi prokurorë hetues, por edhe pse s'jemi, ne po i shohim dëmet që këto kontrata ia kanë bërë Telekomit të Kosovës. E pse s'mund ta bëjë këtë Prokuroria? Vetëm në qoftë se ka një bashkëpunim institucional ndërmjet Qeverisë, menaxhmentit, Bordit të Telekomit dhe Prokurorisë dhe gjyqësisë. Sepse kur jemi te gjyqësia, a ka më turp kur sheh që një gjyqtar i Departamentit Ekonomik ta legjitimojë një borxh të pretenduar që Z-Mobile konsideron që Telekomit ia ka. Gjyqtari Murat Paçarada. Si ka mundësi? A bën një herë e përgjithmonë të nisë prej 2007-ës, prej marrëveshjes për afruese me këtë kontratë? Kush ka qenë përgjegjësi, pse është lidhur, a ka pasur ndonjë analizë, apo interesa

private të njerëzve, qoftë nga politika, qoftë nga Telekomit? E tash Prokuroria dhe gjykatat legjitimojnë vendime të dëmshme, të cilat Z-Mobile i ka atakuar në arbitrazh.

Dhe kur përmendet arbitrazhi, qëllimshëm është humbur rasti. Janë përjashtuar nga tenderimi kompani profesionale, tash s'po përmend emra, se nuk do të ishte korrekte dhe është marrë Studio Ligji me 1000 euro kapital. 600 mijë euro i janë dhënë Studio Ligjit për ta mbrojtur Telekomin në arbitrazh. Dhe në arbitrazh fiton ai që dërgon dokumente më shumë dhe qëllimisht është humbur rasti. Kontrata me Z-Mobile tri kompani profesionale i ka dërguar, tri kompani! Nuk kanë qenë vendore. Dhe natyrisht që e fiton rastin, sepse qëllimshëm është humbur rasti. Dhe, këtu kanë përgjegjësi dhe herë do kur përgjegjësit do të dalin para drejtësisë.

Siç duket me këtë Qeveri, Devolli konsiderohet vetë shteti, ndërsa krerët e shtetit janë të punësuar me honorar të saj. Ata punojnë për të, vjedhin me dokumente për të, duke i favorizuar në çdo tender me rëndësi nacionale. Ata e udhëheqin shtetin apo shteti udhëhiqet prej tyre. Po kjo duhet të ndërpritet. Z-Mobile duhet të ndalohet me ligj dhe ne shumë shpejt do ta procedojmë këtë projektligj në Kuvendin e Kosovës.

Në fund, ne inkurajojmë punëtorët e Telekomit që të qëndrojnë. Që të qëndrojnë edhe përkundër vështirësive, sfidave që i kanë ata në vazhdimësi. Prandaj, në fund, bashkë me oligarkët do të shkojë edhe kjo Qeveri. Ata janë të ngjashëm sikurse krimi i organizuar dhe korrupsioni, andaj sa më shpejt të ikni, aq më mirë për vendin dhe qytetarët.

**KRYESUESJA:** Faleminderit, deputete! Fjalën e ka kryeministri, z. Ramush Haradinaj.

**KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ:** Të nderuar deputetë!

I nderuar ministër,

E nderuar kryesuese Myfera,

Ju dëgjoj në diskutime dhe mundohem ta kuptoj çka po do deputeti kur flet, po mundohem ta ndaj pjesën e votave, se normal jemi të gjithë politikanë, edhe kemi interes votat, edhe të sindikatës, edhe të sindikatave të tjera, pastaj listën e gjatë të temave. Po ajo që dua të flas këtu është kryesisht kur shtrembërohen faktet. Një deputet me kredibilitet është mirë të ruhet, të mos i shtrembërojë faktet. Nëse e merrni ardhjen e kësaj Qeverie edhe raportet Qeveri-Telekom, e Telekom - Z-Mobile, mund ta konstatojmë shumë lehtë a është kjo Qeveri përkrahëse e një marrëdhënie që ka ekzistuar apo ka një qasje të re. Qasja e re është një obligim, Z-Mobile është tërhequr prej tij dhe ju tregova si janë proceset edhe mundësia nëse do dëshirojmë të ndahemi nga marrëdhënia me Z-Mobile pa i shkaktuar dëme të tjera vetes.

Znj. Albulena Haxhiu këto etiketimet e përgjithshme që i bëre kjo qeveri, ajo qeveri, nuk ju bëjnë nder. Ngjitja emrin saktë çka po e quani kriminale, kush me kë është i zënë. Nëse jam i zënë, thuaj Ramush Haradinaj je i zënë prej Blerim Devollit. Unë tregova, shumë e respektoj,



është djalë i Ibrahim Devollit, ia kam njohur babën. Më vjen mirë që i ka punësuar mijëra njerëz, është në prodhim, ka birra, ka ujë, ka qumësht. Bravo i qoftë! Le të punojë, se kemi nevojë për sipërmarrës. Por, nuk ia kam borxh atij a një tjetri që ta shkatërrojë një kompani publike që është e dy milionë njerëzve, në këtë rast Telekomit. Edhe nuk kam krijuar kësi marrëdhënie varësie me asnjë prej këtyre të ekonomisë, cilido qoftë në këtë dhe. Po as me ju të partive politike, që të varem nga vlerësimi i njerit prej juve. Do të gjykoj drejt, në interes të drejtë të vendim tim.

Pse po i them këto? Pra, ju lutem, shikoni. LDK keni udhëhequr me Qeverinë më përpara, keni marrë dividendë, keni ngrënë e keni pirë me Agron Mustafën, qysh e dini krejt nivelet tuaja. Mos u ngutni! Jo, me leje, edhe ju. E keni, tash ua qesin në publik, ruajuni! Nëse duam të flasim gjendjen reale, po flasim.

Urdhëro? Po, s'ka gjë të keqe. Edhe unë kam ngrënë e kam pirë me Blerim Devollin. Edhe prapë ha e pi me të. Po jam kryetar i Qeverisë, jam i mandatuar prej Kushtetutës, mbroj kontratën që kam me Kushtetutën dhe me të drejtën e popullit tim dhe të qytetarëve të mi. Nëse ka të drejtë ai në bazë të gjykimit, do të gjykoj. Po mos i bëni përgjithësimet, se nuk ju bëjnë mirë as juve as dikujt tjetër.

Ju tregova pikë për pikë zbatimin e rezolutës suaj, jo tavolinë suedeze, a norvegjeze, nuk po e di cilën, se kam respekt për ata popuj, po në pikën e parë ju tregova çka ka ndodhur. Në pikën e dytë ju tregova. Pika e parë thotë 15 ditë nga miratimi kështu, kështu, kështu, shtabi i krizës. Ju tregova cili proces ka filluar. Ju tregova për përbërjen e Shtabit të krizës dhe termat qysh janë vendosur. Janë terma të huaj, nuk janë terma që t'i bëjë Qeveria shpejt e shpejt. Kur po e bëjmë ne, po thoni e keni ju në kontroll, veç shkel e shko. Kur po e bëjmë me palë të caktuar, EBRD-ja nuk është palë jokredibile në botë. Të gjithë e respektojnë, e çmojnë.

Për anëtarë të Bordit, ju e dini si shkojnë procedurat, dy kanë shkuar, po ju e dini qysh shkojnë procedurat për anëtarë të Bordit, kush ka të drejtë dhe qysh ka të drejtë të merret me të.

Auditori i përgjithshëm. Shiko! Auditori i Përgjithshëm, atë që e keni lypur, ai është duke e bërë auditimin, vëlla. Nuk po di tash. Pse s'keni lypur dikë tjetër, se jua kishim plotësuar dëshirën.

Kuvendi dhe ristrukturimi. Po, është proces i ristrukturimit, po lidhet me pikën dy, lidhet me pikën një. Nuk mund të bëj ristrukturim sa herë të dua unë në një kompani, se s'e kemi as atë mandat. Qysh dalin të gjeturat.

Të tërhiqet Qeveria nga marrëveshja abuzive. Jua dhashë përgjigjen qysh, kur mund të tërhiqesh, nëse jemi të zotët të tërhiqemi. ARKEP-in, po. Krejt çka keni kërkuar, d.m.th. për kodin +383. Ju tregova një herë përpara qysh është marrëdhënia me krejt prefiksat e tjerë, dhe kur është data finale në bazë të ligjit që fillon kjo epoka kur +383 është i vetëm.

Dëshiroj t'ju them edhe diçka. Partitë politike shpeshherë thirren në sindikatat, edhe të vijë ai i sindikatës këtu. Unë e kam vizituar Postën menjëherë pas marrjes së detyrës. Edhe a e dini çka kam bërë? Nuk e kam takuar sindikatën veç, po i kam takuar menaxhmentin edhe sindikatën bashkë. Për ta kuptuar përnjëmend çka është e vërteta. Edhe i kam kaluar disa orë me ta. Nuk besoj këtu në këtë seancë që ka deputet që sot mund t'i ikin faktet se çka është duke ndodhur në Telekom, por dalja nga gjendja e sotme është një dalje që duhet të jetë e saktë, pa bërë gabime, me të cilat ne mund t'i krijojmë pengesa asaj kompanie, këtyre punëtorëve.

Nuk është qëllimi i Qeverisë, pra mbajeni mend se sa kush është i nxënë, besoj e keni marrë vesh sa unë. Nuk është qëllimi i kësaj Qeverie as te populizmi, as te marrja me të mirë e sindikatës. Po është jo vetëm ta mbijetojmë kompaninë. Nuk mund t'i japim para të popullit një kompanie, e cila në planin e vet të biznesit nuk i ka sqaruar disa gjëra. A i jepen para një kompanie që është nën hetim, që ju po lypni hetim? T'i japim para të buxhetit tash ne, kalojnë gjashtë muaj, edhe më në gropë. Jo, me leje, kur ka pasur, ia kemi marrë. P.sh. ministri Avdullah Hoti ia ka marrë, se ka pasur atëherë. Ka qenë ministër i Financave, ia ka marrë dividendën. Ne nuk po flasim më të marrim, tash jemi duke folur për t'i dhënë. Nuk guxoj të jap para në një kompani që s'e ka siguruar njëfarë procesi të mirëfilltë, stabil, s'i ka pastruar do marrëdhënie që ju po i lypni. E marrim në qafë, vetëm sa i dembelojmë më shumë kompaninë. Duhet kërkuar llogaridhënie.

Edhe atë që fola më herët, edhe një herë ju bëj thirrje dhe mendoj që prej foltores së Parlamentit është vendi më i mirë, të mos nënshkruajë më kush as vazhdim kontrate, as kontratë që nuk është në terma të biznesit e shpjgueshme, e cila e mbron interesin e kompanisë publike. Pra, ata njerëz i paguani ju. Edhe Bordin, edhe drejtorin e Postës dhe kushdo që është në Postë. Pra, ata njerëz të mos nënshkruajnë kontratë të dëmshme për kompaninë publike! Kjo është thirrja ime. Kushdo që e nënshkruan, do të përballet para ligjit. Kaq.

**KRYESUESJA:** Faleminderit, kryeministër!

Vazhdojmë me grupet parlamentare. Fjalën e ka GP i AAK-së, znj. Donika Kadaj Bujupi.

**DONIKA KADAJ-BUJUPI:** Problem teknik kam.

**KRYESUESJA:** Të lutem, Donika! Për replikë fjalën e ka Memli Krasniqi, shefi i grupit.

**MEMLI KRASNIQI:** Qysh s'ka replikë, kur të përmendet emri!

**KRYESUESJA:** Memli, ashtu jemi marrë vesh. Urdhëro Donika Kadaj Bujupi e ka fjalën.

**MEMLI KRASNIQI:** Shiko, se ndoshta harroj kryesuesja, e Avdullah, kur të përmendin me emër, replikën e merr si me të parën si me të dhjetën. Nuk mund të presësh derisa të kryhen krejt, kur të përmendë me emër.

Zonja Haxhiu, që ta përmend edhe unë me emër, më përmendi me emër. E nisi fjalimin, diku tri herë ma përmendi emrin, iu rritë ndera, faleminderit. Unë shkurt veç desha të them, në fakt ai fjalimi yt aty, ai gjysmëvajt看 patetik është vërtetim i asaj që e thashë në fillim që kjo seancë është farsë, edhe që tema bash nuk ju intereson hiç. Po e keni gjetur një temë për t'u munduar t'i mashtroni punëtorët e shkretë, para së gjithash. Për atë arsye, dje të kam thënë në mbledhje të Kryesisë, nuk e ke përnjëmend as ta thërrasësh kryetarin e Sindikatës, sepse e di që kjo punë nuk bëhet, po e ke për të dalë të thuash në seancë, dje të kam thënë, ke procesverbal, të dalësh të thuash në seancë edhe në media ne deshëm ta thërrasim sindikatën, po qe këta nuk na lanë. Atë e bërë sot. D.m.th. edhe dje e kam ditur se çka keni për të bërë. E ke thënë edhe në media, e the edhe sot.

Pse s'i keni thirrur sindikatën e arsimit kur u fol për Ligj të arsimit, pse s'e keni thirrur BSPK-në kur është folur për Ligj të punës? A t'i thërrasim të gjitha sindikatat? Ky është bre sovrani në këtë vend. Kush del atje, e merr besimin, vjen e flet këtu. Përndryshe, ndera ju rritë neve na e kanë dorëzuar sindikatat krejt materialet, të cilat janë te deputetët dhe që mund t'i marrin parasysh. Qysh na i kanë dorëzuar, ta zëmë, në rastet e tjera edhe sindikatat e tjera, kur ka pasur seanca të tjera. Por, besoj që edhe ata kuptojnë që ju e keni për t'i keqpërdorur kishe ju po mendoni për sindikatat. Ju që jeni si parti socialiste apo socialdemokrate, s'di si po e thërrisni veten. Tash edhe me dy parti të tjera socialdemokrate, demek ju jeni përnjëmend që mendoni për sindikatat. S'është hera e parë, me krejt sindikatat e keni njëfarë gare me PSD-në. Ata me sindikata, ju me sindikata. Po mos i mashtroni, se në fund të fundit, mund të mashtroni ndokënd, po s'mund t'i mashtroni krejt.

Edhe ndoshta s'ia vlen të flas më tepër.

**KRYESUESJA:** Faleminderit! Për kundër-replikë z. Avdullah Hoti. Replikë e keni. Urdhëroni! Dy minuta i keni.

**AVDULLAH HOTI:** Tash disa deputetë e disa grupeve parlamentare mund t'u duken debate krejt të parëndësishme, po ju jeni duke e parë, ky Kuvend është duke funksionuar vetëm me seanca të jashtëzakonshme. Ne po mblidhemi këtu në Kuvend pas një muaji, sepse kryetari i Kuvendit nuk e kryen detyrimin e tij kushtetues, të mblidhet Kuvendi sipas Rregullores së Kuvendit, çdo të dytën të enjte të muajit. Prandaj, e vetmja mënyrë për të diskutuar kanë mbetur seancat e jashtëzakonshme.

Tash për çështjen e Telekomit, për një muaj, dy muaj maksimumi, kjo ndërmarrje ose shpëtohet ose shkon në falimentim. Nuk e di që ka çështje më urgjente sesa të diskutojmë për këtë çështje dhe t'i hapet rrugë Qeverisë, siç i kemi hapur rrugë me rezolutën e korrikut 2018, për të ndërmarrë masa brenda ligjit për të shpëtuar këtë ndërmarrje. Tash kryeministri del në foltore dhe gjuan fjalë në të majtë e në të djathtë pa asnjë përgjegjësi, duke u arsyetuar demek që

s'mund t'i lëvizë bordet, sepse ka procedura, po është ky kryeministër që në shtator të vitit 2017, apo tetor e ka shkarkuar pa asnjë procedurë Bordin e Agjencisë së Akreditimit dhe jemi bërë telashe në këtë Kuvend me përjashtimin e Agjencisë së Akreditimit nga Regjistri Evropian i Cilësisë.

Pastaj ka marrë edhe vendime të tjera, duke shkarkuar borde që emëron edhe Kuvendi, ndërkaq kur vjen puna te Bordi i Telekomit, arsyetohet në procedura që në fakt reflekton vetëm pafuqinë e tij për të ndërmarrë masa në këtë drejtim. Faleminderit!

**KRYESUESJA:** Faleminderit! Replikë apo kundër-replikë. E ke një minutë Albulena Haxhiu. Urdhëroni!

**ALBULENA HAXHIU:** Faleminderit, nënkryetare e Kuvendit! Por, megjithatë, edhe sa ishte kryeministri Haradinaj do të duhej të ma jepnit mundësinë e kundër-replikës, sepse më ishte referuar disa herë në fjalim.

Së pari, ajo çfarë do duhej të bëhej nga prokuroria, do të duhej të hetohet kjo kontratë, siç e thashë, për shkak të dëmeve që kjo kontratë ia ka sjellë Telekomit, konsiderohet 200 milionë euro. Pikërisht se kjo kontratë është produkt i krimit të organizuar, pikërisht kjo është baza për të nisur hetimet. 6.9 milionë nuk i ka kërkuar Telekomit kesh, por si garanci bankare.

Po, është tepër e rëndësishme që edhe sot në këtë Kuvend ta dëgjojmë Sindikatën. Ju pikërisht për shkak se e dini se çfarë dëmi ka sjellë ajo kontratë, nuk doni as t'i dëgjoni, sepse e dini që përgjegjësit kryesorë jeni ju, PDK-ja.

Në kohën e Hashim Thaçit është nënshkruar kjo kontratë, prandaj nuk doni që të dëgjoni asnjë kritikë nga...

*(Ndërprerje nga regjia)*

*(Drejtimitin e mbledhjes e merr kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.)*

**KRYETARI:** Zonja Donika Kadaj-Bujupi e ka fjalën.

**DONIKA KADAJ-BUJUPI:** Faleminderit!

Së pari, është mirë që fjalimet jo çdoherë t'i shkruani në shtëpi, por nganjëherë kur kemi debat, përnjëmend të ketë debat dhe të ballafaqohen argumentet ndërmjet vete.

E dyta, ky Kuvend i ka nxjerrë diku rreth 150 rezoluta, ndoshta edhe më shumë. Në të kaluarën sa herë kemi kërkuar përgjegjësi nga cilado qeveri për një rezolutë, na është thënë se rezolutat nuk janë obliguese, janë veç rekomandime për qeverinë.

Tash, shumë mirë që janë kthyer dhe janë obliguese. Besoj që kanë qenë obliguese edhe në të kaluarën, ato 150, po asnjëherë, bash asnjëherë, asnjë kryeministër nuk ka ardhur këtu në seancë që t'u përgjigjet kërkesave, rekomandimeve të dala nga një rezolutë.

Kjo është hera e parë që e kemi një kryeministër, i cili vjen edhe pikë për pikë e sqaron rezolutën dhe veprimet të cilat janë marrë, përkatësisht me kërkesat e dala nga rezoluta.

Janë tetë pika, të cilat ne i kemi votuar. Pra, kanë qenë tetë rekomandime. Dhe, edhe një herë për të gjitha ata që nuk i kanë dëgjuar argumentet dhe përgjigjet, po e përsëris. Pika e parë ka qenë Qeveria 15 ditë nga miratimi i rezolutës të ngrëjë shtabin e krizës për ristrukturimin e thellë të veprimtarisë biznesore.

Përgjigjja apo veprimi konform kërkesës ka qenë si në vijim: Ministria e Zhvillimit Ekonomik është në proces të ristrukturimit në partneritet me BERZH-in, për shkak të procedurave të zgjatura që i ka BERZH-i, procesi merr kohë më shumë. Domethënë ka filluar përgjigjja në pyetjen e parë. Në rekomandimin e parë.

Rekomandimi i dytë: Përbërja e shtabit të krizës të ketë terma të referencës dhe profilin e anëtarëve në bashkëpunim me Komisionin Parlamentar për Zhvillim Ekonomik.

Në këtë partneritet me BERZH-in, pra për ristrukturim, përfshihet Ministria e Zhvillimit Ekonomik dhe termat e referencës janë zhvilluar për të dyja palët. Për ekspertët, të cilët do të jenë të jashtëm, po e theksoj, dhe të cilët, meqë janë të jashtëm, do të jenë edhe objektivë, po besojmë.

Pika e tretë: Të tërhiqen anëtarët aktualë të Bordit. Përgjigjja; nga Bordi aktual ka filluar shkarkimi i dy anëtarëve, të cilët kanë dhënë dorëheqje gjatë procesit. Shkarkimi dhe emërimi i bordit rregullohet me ligj dhe veprimet arbitrare do të ishin shkelje. Po besoj që po pajtohemi të gjithë.

Te pika e katërt; është kërkuar nga ky Kuvend që Auditori i Përgjithshëm menjëherë të fillojë auditimin. Qeveria pas rezolutës ka kërkuar menjëherë që auditori të fillojë auditimin dhe auditori ka filluar, pra ka filluar auditimi i brendshëm.

Të gjitha pikat, s'po vazhdoj, 4,5,6,7,8 janë adresuar. U sqaruan edhe më herët nga kryeministri, madje dy herë. Po ndalem te pikat 7 dhe 8, të cilat edhe një herë u kërkuan nga një kolege deputete që të marrim përgjigjen.

Pika e shtatë (7), kërkesa jonë si Kuvend ka qenë që ARKEP ta zbatojë ligjin duke njoftuar sa më parë tarifave të reja të licencimit. ARKEP ka angazhuar kompani konsulente për procesin e tarifave të reja për licencim që e ka përfunduar punën gjashtëmujore në mars të vitit 2019. Pra, është në proces e sipër.

Dhe, e teta (8), që po e besoj se është një ndër pikat më të rëndësishme; të publikohen të gjitha dokumente me titullin e pronësisë së kodit +383. Kodi i Serbisë +381 është i ndaluar në Kosovë nga qershori 2018. Kodi +377 është ndërprerë. Kodi +386 ndërpritet më 1 qershor. Të gjitha këto informata janë publikuar veçse.

Të gjitha informatat në lidhje me kodin +383 po ashtu janë bërë publike.

Nëse u kthehem kërkesave të cilat vijnë nga LDK-ja. Më duhet të theksoj që gjendja jostabile e Telekomit të Kosovës, e cila po vazhdon të jetë e tillë, ka filluar në vitin 2015, kur kryeministër ka qenë Isa Mustafa.

Sipas ekspertëve, shkaktarë për gjendjen aktuale janë marrëveshjet paraprake, të cilat edhe sot vazhdojnë dhe u adresuan sot këtu nga kryeministri, po të cilat për shkak të ligjit dhe veprimeve të mëhershme nuk mund të ndërpritën me pullë. Pra, duhet ta zbatojmë ligjin përsëri dhe të ndërmarrim veprimet konkrete.

U tha këtu që nga kryeministri Haradinaj asnjëherë nuk është kërkuar devidentë. Mirëpo, në vitin 2015 kur Telekomit ka operuar me humbje, vendimi i ish-ministrit Hoti ka qenë që të merret devidenta, dhe është marrë.

Vendime të tjera. Është folur vazhdimisht dhe është personalizuar tej çdo mase çështja e punësimeve. Po bre, katër-pesë anëtarë të familjeve tona janë punësuar. Janë punësuar. Le të fillojë prokuroria hetimet, nëse kemi pasur ndonjë ndikim dikush prej nesh, ose nëse pozitat e tyre janë konflikt interesi ose janë pozita drejtuese.

Mirëpo, të dhënat flasin që punësimet më të mëdha, pra mbi 1000 punësime kanë qenë pikërisht në vitin 2008, kur LDK ishte në pushtet. S'kisha dashur ta personalizoj, po për Zotin, edhe ne jemi lodhur duke i dëgjuar akuzat që jemi kriminelë e që anëtarët tonë të familjes nuk kanë të drejtë të punësohen. Prandaj, po dua t'i përmend disa emra. Nëse Telekomit shpëton, nëse dy-tre anëtarë largohen, ne i largojmë menjëherë, por duam t'ia nisim me të gjithë.

Duam t'ia nisim prej familjes së Fatmir Sejdiut. Komplet familjes. E duam t'ia nisim prej vëllezërve e motrave, e burrave e kunetërit e krejt me rend. Dauti po thotë mos i përmend emrat, se po na vjen keq. Ndoshta edhe na vjen keq, po edhe ne kemi emra e mbiemra dhe nuk është mirë të personifikohet dhe të personalizohet debati.

Meqë keni filluar, e kemi listën e emrave, mbiemrave, anëtarëve të familjes për të gjithë. Për të gjitha grupet parlamentare. Për të gjithë deputetët. Për të gjithë ata që sot po drejtojnë akuzua. Po e ngrehin gishtin dhe po na cilësojnë me emra të ndryshëm.

Kur të fillojmë nga fillimi, dhe të gjithë ne vendosim ta luftojmë nepotizmin, atëherë do të bashkohemi të gjithë dhe do të fillojmë, po do të fillojmë përnjëmend. Prej vitit 2008. Prej vitit 2007 e më tutje, më herë e më vonë. Mirëpo, do të dalim publikisht dhe do të flasim edhe me emra e me mbiemra. Edhe me lidhje familjare. Edhe me kërkesa që na bëhen. Të shohim se cilët jemi ne dhe cilët janë ata, të cilët vazhdimisht dhe vazhdimisht nëpërmjet konferencave për shtyp po ngritin akuza. Po cilësojnë. Po personalizojnë debate, ndërkaq të dhënat zyrtare flasin të kundërtën.

Ne jemi jashtëzakonisht në përkrahje të Komisionit Hetimor, i cili është ngritur në këtë Parlament, edhe i thërrasim që raporti final t'i përfshijë të gjitha shkeljet eventuale, në mënyrë që ky Kuvend pas marrjes së atij raporti ta procedojë në prokurori dhe të kërkojmë që kjo temë të trajtohet sipas ligjit. Faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit! Visar Ymeri, në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Socialdemokrate.

**VISAR YMERI:** Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Kabinet qeveritar,

Dy ministra, qenkeni prezentë,

Natyrisht që për çështjen për të cilën po flasim ka qenë një prej temave, mbase më të rëndësishme në publik, veçanërisht kohëve të fundit, dhe atë për shkak të një rreziku të jashtëzakonshëm në të cilin gjendet kompania më e rëndësishme ekonomike dhe strategjike, publike në Republikën e Kosovës, e që është Telekomi.

Kompani e cila nganjëherë po vlerësohet sikurse është buzë falimentimit, e nganjëherë po vlerësohet si të jetë në një gjendje jashtëzakonisht të rëndë. Pra, me njëlljog diagnoze të pasigurisë nëse do ta mbijetojë një gjendje të tillë, gjë që është e vërtetë.

Pra, edhe në punën në Komisionin Hetimor që e kemi pasur deri tash, edhe në raportimet që i kemi pasur nga aktorë të ndryshëm, fillimisht me përfaqësues të sindikatave, pastaj me

menaxhmentin e Bordin aktual, me ministrin e linjës të Zhvillimit Ekonomik, me përfaqësuesit e Rregullatorit e kështu me radhë, shihet që gjendja në Telekom është jashtëzakonisht e rëndë.

Në këtë drejtim, unë mendoj që këtu si Kuvend, në këtë debat që po e bëjmë sot, do të kisha pasur dëshirë, të paktën, që ky debat të jetë ndihmesë për punën e Komisionit Hetimor dhe nga ky debat, pra të gjejmë edhe çështje të tjera, përveç atyre të identifikuar deri tash, që do të ishin objekt i hetimit nga Komisioni Hetimor. E gjithë kjo, në mënyrë që t'i përgjigjemi asaj pyetje fillestare që ishte shtruar nga përfaqësuesi ose kërkuesi i Komisionit Hetimor, e që po shtohet edhe sot. Pra, në këtë seancë të Kuvendit e që është; çka e ka shkaktuar këtë gjendje në Telekomin e Kosovës. Pra, pse një kompani e cila ka afaruar me një pozitivitet të jashtëzakonshëm, pra miliona euro fitim neto gjatë viteve, të sillet në këtë gjendje, ku jo që nuk ka fitim, po shpeshherë afaron me humbje, e shpeshherë të hyrat që i realizon nuk janë të mjaftueshme për t'i paguar shpenzimet që i ka dhe borxhet e detyrimet që i ka.

Në këtë drejtim, konsideroj që, edhe në këtë seancë të Kuvendit, edhe në përgjithësi për çështjen, do të ishte mirë nganjëherë që ta marrim një modalitet të menduarit, i cili është më shumë që shtron pyetja sesa që jep përgjigje të gatshme.

Përgjigjet e gatshme, e aq më tepër kur janë të ngutshme, e aq më tepër kur kanë qëllime të tjera, përveçse ta sanojmë gjendjen këtu, mund të jenë keqorientuese e nganjëherë edhe fatale për kompaninë për të cilën po flasim në këtë rast, ose për ekonominë në përgjithësi.

Pra, po nganjëherë deputetë të nderuar të Kuvendit të Republikës së Kosovës, është më e rëndësishme se çfarë pyetjesh po shtrojmë sesa cilat përgjigje po i japim. Kemi dëgjuar përgjigje të shumta, jo vetëm për gjendjen në Telekom, veçanërisht sesi duhet dalë nga kjo gjendje dhe këto përgjigje shpeshherë janë në shpërputhje me çfarë po ndodh aktualisht dhe me çfarë do të duhej të ndodhte në mënyrë që një kompani e tillë të kthehet në, ta zëmë, nëse është e mundur, në një afarim që e ka pasur më herët.

Për shembull, përgjigjja e zakonshme e Qeverisë, edhe e kësaj, po edhe e qeverive të kaluara, ka qenë privatizimi. Sa herë që është folur për Telekomin, është thënë privatizimi, sepse zgjidhje tjetër nuk ka.

Dhe kjo është përgjigjja që e kemi dëgjuar prej Qeverisë, pa e dëgjuar pyetjen që ia ka shtruar vetes Qeveria. Pra, privatizimi, përgjigje në cilën pyetje është? Për konsolidim të ndërmarrjes. Për fuqizim të tregut të telekomunikacionit apo është ndonjë pyetje tjetër ne këtu nuk e kemi parasysh, e që ata janë përgjigjur, e mbase janë përgjigjur saktë në pyetjen e gabuar.

Në këtë drejtim, unë po dua sot ta shfrytëzoj këtë kohë që e kam që t'i shtroj disa pyetje. Këtu përpara e kam një tabelë që i përmbledh dallimin mes të hyrave për vit dhe fitimit neto që e ka



realizuar Telekomit prej vitit 2007 deri në vitin 2017. Pra, kjo është një përmbledhje e të hyrave që janë realizuar, ta zëmë në vitin 2007, e që janë 182,5 milionë euro, pra jo fitimi, siç u përmend më herët. Nuk ka qenë fitimi në vitin 2007 182 milionë, po kanë qenë të hyrat, qarkullimi. Fitimi ka qenë diku 97.7 milionë. Tutje, kemi ardhur në vitin 2014, kur të hyrat ka qenë 99.5 milionë, e fitimi 18 milionë, e kështu me radhë deri në vitin 2017, ku të hyrat janë vetëm 70 milionë euro. Këtu qartazi kemi rënie të të hyrave në Telekom.

Nuk po dua të ndalem në këtë. Për mua pyetja më e rëndësishme është këtu; si ka ndryshuar raportin në mes të të hyrave të përgjithshme dhe fitimit neto të realizuar nga kompania Telekomit?

Pra, ky raport gjatë viti 2007-2011 ose, më falni, në vitin 2007 ka qenë 53.5%. Pra, 53.5% nga të hyrat e përgjithshme, kanë qenë fitim neto të realizuara nga Telekomit i Kosovës.

Ndërkohë që në vitin 2011, ky raport ka ndryshuar dhe ka rënë në 31,7%. Pra, në vitin 2011 nga të gjitha të hyrat e realizuara nga Telekomit profiti ka qenë ose fitimi neto ka qenë vetëm 31,7%, e këtë duhet ta trajtojmë.

Natyrisht që edhe lëvizshmëria e të hyrave përgjatë vitit, pra qarkullimit të përgjithshëm është e rëndësishme, po për mua është goxha e rëndësishme dhe indikative se si eficientia e kompanisë përgjatë viteve ka shkuar duke rënë. Pse ndodh kjo? Sepse janë rritur shpenzimet dhe kanë rënë të hyrat. Pra, kemi një trend në shpërputhje në mes të rritjes së shpenzimeve në Telekom dhe të hyrave që i ka realizuar Telekomit përgjatë viteve.

Gjatë kësaj kohe sa kanë rënë të hyrat e përgjithshme në Telekom, janë rritur shpenzimet e punësimit, po edhe gjatë kësaj periudhe janë rritur edhe nënshkrimet dhe obligimet financiare, në të cilat Telekomit ka hyrë me palë të treta dhe kjo është, edhe në Komision e kemi identifikuar, si një prej problemeve më madhore që e ka Telekomit sot, e që e ka pasur edhe dje.

Kontratat me palë të treta, të cilat i ka nënshkruar Telekomit dhe të cilat e kanë dëmtuar Telekomin e nuk e kanë ndihmuar atë.

U fol këtu shumë dhe është fol më së shumti për kontratën me Z-Mobile, që është e vërtetë dhe për këtë pyetje ime kryesore është, së pari. Kush ka qenë ai person ose ajo instancë pushteti që ka vlerësuar që Telekomit në vitin 2009 ose në vitin 2008 kur kanë filluar përgatitjet për një kontratë të tillë i nevojitet një operator virtual? Pra, cila ka qenë nevoja për një operator virtual në Telekom? A ka qenë ky vlerësim i Rregullatorit të tregut dhe nëse po, me çfarë arsytim, apo ka qenë vlerësim dhe mendim i menaxhmentit të Telekomit dhe nëse po, me çfarë arsytimi? Prapë po them, a ka qenë e nevojshme që Telekomit i Kosovës ta ketë një operator virtual? Për mua, këtu fillon problemi. Natyrisht që pastaj edhe çështjet e tjera janë të rëndësishme.

Po kushdo që e ka vlerësuar duhet edhe ta ketë mundësinë për ta arsyetua një vlerësim të tillë, të dobishmërisë së projektuar të Telekomit nga një operator virtual. Në fund, e vërteta ka dalë ndryshe, operatori virtual nuk është se e ka ndihmuar shumë Telekomit, mirëpo në disa instanca goxha shumë e ka penguar.

Por, po ashtu që të jemi korrektë dhe objektivë, duhet të themi që nuk është arsyeja e vetme sepse Telekomit e ka këtë gjendje sot.

Kontratat me kompani të tjera, me palë të tjera qysh më pak po përmenden Kompani Cactus, InterAdria, PejKos, Sollario, e tjera, e tjera, e tjera, të cilat janë kryesisht kontrata, në të cilat Telekomit nënshkruan për të marrë shërbime nga këto kompani, qofshin ato të shitjes së produkteve, qofshin të mirëmbajtjes së rrjetit dhe intervenimeve nëpër antena, e kështu me radhë, qofshin këto kontrata për qira e të tjera.

Dhe, në të njëjtën kohë, duke nënshkruar kontrata për atë që në anglisht quhet Altsorsi, pra që ia jep një kompanie tjetër që ta kryejë një shërbim të caktuar, Telekomit e bën edhe një gjë: punëson njerëz shtesë për të afuar shërbimin e njëjtë. Për shembull, ka kontratë për shitjen e produkteve me dy kompani dhe punëson një numër jashtëzakonisht të madh të njerëzve si agjentë shitjeje, të cilët do t'i shesin produktet e Telekomit, këtu s'ka kurrfarë logjike ekonomike.

Pra, nëse një shërbim të caktuar e kontraktton jashtë, atëherë nuk e rrit punësimin për të njëjtin shërbim brenda, kjo nuk ka logjikë. Pra, këto kontrata e kanë dëmtuar Telekomit dhe si e kanë dëmtuar? Sepse në këto kontrata, për shembull, në shitjen e produkteve ose në ofrimin e shërbimeve, aty Telekomit është dakorduar me kompaninë që t'ia japë një përqindje të caktuar të qarkullimit për shërbimin e shitur, jo fitimit neto, po të hyrave. Ta zëmë, për ta shpjeguar. Nëse një kartelë shitet tri euro, një Sim-kartelë dhe shitjen e kësaj Sim-kartele e bën një kompani tretë, dhe ta zëmë që Telekomit, këto nuk janë shifra reale, vetëm po i marr si shembull kështu si ka ndodhur kjo. Ta zëmë që Telekomit është marrë veç me kompaninë që 30% të të hyrave nga shitja e produkteve të tilla do t'i shkojnë kompanisë në fjalë dhe ta zëmë që fitimi në Telekomit nga sim-kartela e ka një euro, sepse edhe sim-kartela prodhimi i saj ka kosto. Atëherë marrëveshja me kompaninë e tretë, 30% të hyrave do të nënkuptonte që 90 centë duhet t'i japin kompanisë me të cilën është nënshkruar marrëveshja.

Ndërkohë që po të kishte qenë marrëveshje, në të cilën fitimi neto i ndahet për 30%, atëherë do t'i jepej 30 centë, sepse fitimi neto është një euro.

Pra, nëse e para marrëveshje për 30% e qarkullimit, atëherë i bie që praktikisht fitimi nga Sim-kartela t'i jepet kompanisë së tretë.

Dhe këto janë çështjet, shkaktarët gati se kryesorë që e kanë sjellë Telekomini në këtë gjendje. Faleminderit!

*(Drejtimitin e mbledhjes e merr nënkryetarja e Kuvendit, znj. Myfera Shinik.)*

KRYESUESJA: Faleminderit! Fjalën e ka shefi i Grupit Parlamentar Nisma Social Demokrate zoti Bilall Sherifi. Urdhëroni!

BILALL SHERIFI: E nderuar kryesuese e seancës,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Të flasësh për Telekomini nuk është vështirë, sepse pak a shumë të gjithë e kemi ditur se mënyra se si i është qasur shoqëria, shteti, kësaj kompanie, ata që e kanë pasur pushtetin ndër vite, nuk besoj që dikush ka pritur ndonjë fund tjetër.

Unë do të përpiqem me një analogji të shpjegoj se çka ka ndodhur me Telekomini.

Është një dënim i vjetër kinez me vdekje, që quhet ‘vdekja me një mijë prerje’, është ‘Ling shi’, nga kjo fjalë vjen ajo shprehja “linçim”, pra i dënuari ekspozohet në publik dhe për çdo ditë i bëhet nga një prerje dhe ai me një prerje nuk vdes, mirëpo i duhen një mijë prerje derisa i dënuari me vdekje të japë shpirt, siç themi ne, të vdesë.

Pra, tash këtu ne shtyhem se cila prerje ka qenë më e rrezikshme. A është prerja e quajtur Devolli, a është prerja e quajtur Cactus, a është ajo prerja e quajtur mbipunësim, a është ajo prerja e quajtur dividendë, e ku ta di unë.

Prandaj, unë vendosa fjalën time ta orientoj në këtë drejtim dhe jo në qasjen apo mënyrën siç u fol nga kolegët, jo pse ajo që u tha nuk ka vend, nuk është e bazuar.

Tash, nëse ndalemi te historia se si erdhi Telekomini deri në këtë shkallë, ne do të mbesim duke vajtuar dhe duke i numëruar ato prerjet dhe duke u përplasur me njëri-tjetrin se cila ishte më vdekjeprurëse. Asnjëra nuk është në vetvete vdekjeprurëse, të gjitha bashkë e bëjnë të dënuarin të vdesë.

Ne këtu në këtë Kuvend dhe Qeveria bashkë duhet të ketë të qartë se çka do të bëjë me Telekomini si një i dënuar me vdekje, a duam ta shpëtojmë a ta revokojmë atë dënim dhe të fillojmë së pari të mos bëjmë më prerje, kërkesa e parë, vendimi i parë do të duhej të ishte asnjë prerje shtesë, dhe të fillojmë t’ia shërojmë ato plagë që janë shkaktuar nga ato prerje. Dhe, aty pastaj besoj nuk është vështirë të gjendet zgjidhja e daljes apo e nxjerrjes së Telekomit nga gjendja në të cilën ka ardhur.

E pra, duhet të konstatojmë a duam ndonjë ndërmarrje publike dhe nëse mendojmë që duam, duhet edhe t'i ndërmarrin hapat e nevojshëm, hapat e duhur, për të cilat shpëtohet Telekomit dhe vazhdon si ndërmarrje publike. A ka treg? Të gjithë njëzëri do të thoshim, po si nuk ka treg, nëse ka treg për kompanitë private, atëherë duhet të ketë treg edhe për kompanitë publike. A duam ta mbajmë si kompani publike apo nuk duam ta mbajmë, i takon sërish Kuvendit, sepse në fund të fundit Qeveria, Kuvendi mund të marrë një vendim për të ardhmen e saj. Kuvendi përmes disa iniciativave, të gjithë e dimë se ka provuar ta privatizojë, nuk ka arritur për arsye të ndryshme që nuk besoj që sot duhet të jenë temë diskutimi në këtë seancë.

Duam ta mbajmë publike apo duam ta privatizojmë? Nëse duam ta mbajmë publike, duhet të ndalemi që ta trajtojmë në këtë mënyrë si një të dënuar me vdekje, por të provojmë ta nxjerrim nga gjendja në të cilën është. Unë sinqerisht nuk kam një patentë se si mund të dilet nga kjo situatë, po besoj që të gjithë së bashku dhe menaxhmenti i Telekomit dhe Bordi, Qeveria, ministria duhet të kenë një projekt si kjo shoqëri, ky shtet mund ta mbajë një ndërmarrje publike, siç është Telekomit, sepse të gjithë po e dimë se ka nevojë dhe ka treg. Nëse ka treg, ajo mund të mbijetojë, por le të ndalemi së trajtuari në këtë mënyrë.

Kjo do të ishte, nëse mund të them të bëjmë ne tani një prerje, por jo Telekomit, por t'i bëjmë një prerje të të gjitha prerjeve, ta ndalim atë. A jemi të gatshëm ta bëjmë këtë, nuk e di. Ndërsa të gjitha veprimet që janë bërë deri më tash, që nga 2007-a që u radhitën këtu me radhë, të gjitha ato kontrata të jashtme, ose duhet të mbahen kontratat dhe të reduktohet shërbimi i brendshëm, ose duhet të ndërpriten kontratat dhe të mbahen shërbimet që i mban Telekomit. Po kjo hyn në kuadër të asaj që tash se nëse marrim vendim për ta mbajtur si ndërmarrje publike, duhet edhe të veprojmë në atë mënyrë. Duhet të veprojmë në mënyrë për ta bërë atë konkurrenca në treg. Të gjithë e dimë, jemi duke e parë që Telekomit është një ndërmarrje që është shumë e varur nga zhvillimet e teknologjisë dhe nuk mund të presësh mbijetesë në treg nëse ia ke ndaluar para disa vjetësh, siç e dini, janë ndaluar investimet që e rrisin konkurrencën në treg të Telekomit. Pra, duhet të hiqen të gjitha pengesat, duhet të reduktohen kontratat e jashtme dhe të fillojmë ta ngjallim, në mënyrë që ajo sërish të jetë konkurrenca. Por, nëse nuk arrin të japë dividendë, siç ka dhënë përpara, kur ka qenë monopol, kur e ka pasur monopol, apo kur kompanitë e tjera private kanë qenë në fillet e saj, tanimë ajo do të mjaftonte sikur të arrijë ta mbajë veten dhe punëtorët. Sepse nuk besoj, së paku unë nuk kam iluzion se mund të nxjerrë profite aq shumë sa që edhe t'i japë fitime Qeverisë, siç i ka dhënë nga 50 milionë, deri në 50 milionë apo edhe më shumë në vit buxhetit të shtetit.

Do të kisha pasur dëshirë që të përqendrohemi te, tash e tutje si politikë, ndërsa tash e prapa le të përqendrohet sistemi i drejtësisë, le të përqendrohen organet e akuzës në gjykata, hetuesia që të nxjerrin në sipërfaqe, në pah, të nxjerrin edhe para bankës së akuzës të gjithë ata që i kanë shkaktuar ato prerje. Nëse nuk arrijmë të merremi vesh për të ardhmen, s'besoj që do të mund të arrijmë të merremi vesh për të kaluarën. Unë mendoj që t'i ndajmë, e kaluara duhet të jetë

çështje e drejtësisë, ndërsa e tashmja çështje e politikës dhe në veçanti e ardhmja e Telekomit. Faleminderit!

**KRYESUESJA:** Faleminderit! Fjalën e ka kryetari i Parlamentit. Urdhëroni, kryetar!

**KRYETARI KADRI VESELI:** Faleminderit!

Nuk do të flas për këtë pjesën e parë shumë, veç për besë, kolegëve të grupeve parlamentare, unë po ua jap gjithmonë fjalën, e ata mua hiç. Kjo le të evidentohet për protokoll.

Kjo qe për shaka. Do të flas për temën të cilën jemi duke folur. Pak a shumë diskutimet të cilat janë do të ishin shumë mirë në qoftë se janë shqetësim që kanë të bëjnë me ndërmarrjen. Kjo do të ishte më e mira për mesazhin edhe për ato 2500 familje, të cilat punojnë në Telekomin e Kosovës. Po nuk do të them vetëm për 2500, po janë diku, sipas të gjitha gjasave rreth pesë mijë familje, të cilat preken drejtpërdrejt nga Telekomit i Kosovës, duke e pasur parasysh se kanë ndërlidhshmëri edhe institucionale, edhe financiare pikërisht me Telekomin e Kosovës.

Ajo çfarë është kryesore, të gjithë punonjësit e Telekomit të Kosovës sot i kanë sytë në Kuvend. Edhe ata me fatin e tyre mendojnë se do t'u bëjmë ndonjë zgjidhje ne. Kjo është diçka çka është reale, e në fakt, kjo çka po shihet deri tani, çka u fol e çka do të flitet edhe më shumë më tutje, nuk ka të bëjë fare, të nderuara familje të punëtorëve të Telekomit, fare me fatin tuaj. Për arsye se shqetësimi këtu nuk është për fatin e juaj. Shqetësimi është, në fakt, veç të komplikohet pak më shumë situata. Mund të jenë edhe premtime, edhe fajësime, po edhe në forma të tjera, po çështja e Telekomit të Kosovës zgjidhet jashtë politizimit, jashtë politikës, përmes përvojave menaxheriale, të cilat janë më të jashtëzakonshme, përmes ndihmës, e cila duhet të jetë po ashtu financiare në projekte, përmes kufizimeve të cilat mund të jenë në shpenzime, po nuk do të futem as nga kjo pjesë, të cilën ju së bashku me menaxhmentin, unë besoj edhe së bashku me institucionet e Republikës së Kosovës mund t'ia arrini. Edhe unë kam shumë besim që Telekomit i Kosovës ia del.

Të gjitha çështjet çka kanë të bëjnë me keqpërdorime, në punësim, në tenderë, në të gjitha çështjet të cilat janë aty si probleme, duhet shkuar deri në fund. Por, prapë nuk do të jetë shpagim foltorja e Kuvendit. Jetojmë në shtet ligjor, janë prokurorët, janë gjyqtarët. Përndryshe, në qoftë se do të ishte një shqetësim më i madh, ne kemi krijuar edhe një Komision Hetimor. Kolegët të cilët e kanë iniciuar këtë pjesën sot të debatit, e kishit pritur Komisionin Hetimor, për arsye se kishim pasur fakte edhe më shumë. Kishim pasur fakte të flasim me emër e mbiemër, të mos ngutemi si Glauku, se gabon. Ndodh që i dalin më shumë familjarë këtij se mua, a po ta kishte pushtetin tim Vetëvendosje, edhe të Partisë Demokratike të Kosovës, kushedi çka kishte bërë. Kini parasysh, do të dalin me emra e mbiemra, të gjitha, një për një, për arsye se janë njerëzit janë aty, janë faktet aty, s'ka nevojë të manipulohet, edhe ka shtet në këtë vend, ka ligj në këtë vend, ka prokurorë në këtë vend. Përndryshe, kjo është imoralitet. Më çudit më tepër Lidhja

Demokratike e Kosovës, kolegët e mi, të cilët janë spektri i djathtë me këto politika populiste që janë tërësisht majtiste, të cilat e kanë çuar në fund të pusit, siç thotë populli, Evropën Lindore. I është dashur tri dekada të rikthehet të rimarrin veten, pas tri dekadash. Për faktin se çdo gjë që nuk shkon, hajde ta fajësojmë pushtetin, po nuk shkohet kjo. Pse nuk është folur kur janë dhënë me qindra miliona pikërisht nga Telekomit i Kosovës për Qeverinë e Kosovës. Ka pasur një gjenerim, ka pasur një situatë pozitive. Gjithmonë po flas keqpërdorimet lihen anash, se janë objekt edhe të Prokurorisë, por kanë edhe emër e mbiemër. Nuk shkon ajo, fisi im, fisi yt. Jetojmë në shekullin XXI, ka emër, mbiemër. Ai i cili ka kryer veprën kriminale, shkon dhe e merr përgjegjësinë. Po ashtu ka emër edhe mbiemër edhe familjari i atij i cili është punësuar, kudo që është punësuar.

Është mirë, edhe një herë, t'i ndihmohet Telekomit, të gjendet përkrahje për Telekomin, jo në shpenzime. Tash, të mos më keqkuptojë askush, jo në shpenzime, por në projekte, qoftë nevoja edhe deri në dhjetëra miliona euro, për arsye se Telekomit u ka dhënë institucioneve të Republikës së Kosovës, u ka dhënë qytetarëve të Republikës së Kosovës. Projekte të cilat e nxjerrin Telekomin e Kosovës nga falimentimi edhe nga falja, se s'duhet falur askujt edhe askush Telekomin e Kosovës. Ka mundësi këto trende të cilat janë. Teknologjia ka arritur një shpërthim shumë të madh, i ka dëmtuar të gjitha kompanitë, të cilat janë të Telekomit. Po ka mundësi të gjendet zgjidhje. Edhe unë besoj në këtë pjesë. Shpresoj se menaxhmenti, të cilin do ta përkrahja, po ashtu edhe bordin, të cilin do ta përkrahja, edhe institucione relevante, ministër, bisedoni seriozisht, i ikim politizimit. Politizimi le të kalojë në Komisionin Hetimor Parlamentar, edhe aty le të flitet një për një. Një për një, pastaj është edhe prokurori. Le të shkohet te prokurori, po foltorja e Kuvendit, ju kisha lutur edhe një herë, nuk është mirë të bëhet arenë e abuzimit. Ne në bazë të traditës që e kemi, nuk kanë ekzistuar këto gjëra, ato ne të fyhemi, në Kuvend jemi, Kuvend quhet, të fyhet, të flitet vetëm në mënyrë paushallë pastaj dhe të mos mbahet përgjegjësi hiç, sido që të jetë, secili e mban përgjegjësinë për vete, por këtë çfarë desha ta them, sot më me rëndësi është nga kjo foltore të flitet për Telekomin, për të ardhmen e Telekomit të Kosovës, për ato 5 mijë familje minimalisht, të cilët janë të varur nga të ardhurat e Telekomit të Kosovës. Faleminderit!

**KRYESUESJA: Faleminderit, kryetar! Replikë, Glauk Konjufca! Urdhëro!**

**GLAUK KONJUFCA:** Unë nuk e kam në Telekomin e Kosovës asnjë familjar, por zoti Veseli ka shumë miq dhe miqtë e tij, së bashku me Partinë e tij, unë insisto që e kanë orkestruar prapë Telekomin e Kosovës dhe meqë po dëshirojmë, atëherë unë i kam listuar këtu gjashtë fakte të pakontestueshme që PDK-ja qëndron mbrapa kësaj pune, ky është kryetari i kësaj partie.

E para, Shyqri Haxha kur i ka dëshmuar Johakim Stollbergut që Hashim Thaçi e ka thirrur në telefon, këta e kanë syrgjynos prej Kosovës Shyqri Haxhën dhe e kanë arratisur në Londër.

E dyta, pasi e kanë hequr Shyqri Haxhën në bisedimet “pronto”, në përgjimet “pronto”, Adem Grabovci, së bashku me Besim Beqajn, të dy të PDK-së, e vendosin Nuredin Krasniqin, edhe ky i PDK-së, si ushtrues detyre, pasi e heqin Haxhën.

Tjetra, Agron Mustafën kur e kanë vendosur drejtor të Telekomit, ai është i afërt, është mik i këtyre, është zyrtar i PDK-së, drejtori i Bordit, ky Rexhë Gjonbalaj, është zyrtar i PDK-së në Pejë. Ky e ka marrë vendimin për Telekom, për atë kontratën e dëmshme me Dardafonin, për të cilin po flasim këtu. Pastaj, kryeshefin ekzekutiv, njërin prej krye shefave ekzekutiv, nip i Azem Sylës. Këtu janë krejt fakte, e tash të mos dalim te antenat. Edhe antenat ku janë të vendosura, 550 antena, prej të cilave merret qiraja 3,6 milionë euro, janë shumë të vendosura te zyrtarët e PDK-së.

**KRYESUESJA:** Faleminderit! Kundër-replikë, kryetari i Parlamentit, zoti Kadri Veseli, urdhëroni!

**KRYETARI KADRI VESELI:** Faleminderit! Do të jem i shkurtër, është e vërtetë për miq, Glauk, është e vërtetë për miq, ka shumë dhe po të mundja çdo ditë kisha krijuar, por familjarë edhe interesa personale kurrë në jetë s’kam pasur. E dyta, shiko Glauk, edhe ti ndoshta ke qenë në PDK, s’po di, në të kaluarën, e treta, edhe kur fole tash qëndroju fjalëve, për arsye se fole edhe pak do të pavërteta, të cilat s’po dua t’i them, por vërtet ke folur të pavërteta. Prej të pavërtetave, katra minimumi i the të pavërteta. E para unë pres reagimin, kur të dalin reagimet, pastaj dalim. Glauk, më i miri je, djalë i mençur, por mos e ekstremizo debatin. Faleminderit! Komisioni Hetimor i përcakton edhe këto pyetjet që i bëri Glauku. Faleminderit!

**KRYESUESJA:** Faleminderit, kryetar! Përfaqësuesi i Qeverisë, ministri Valdrin Lluka, urdhëroni.

**MINISTRI VALDRIN LLUKA:** Faleminderit, e nderuar kryesuese!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar kolegë ministra,

Shkurtimisht, vetëm lidhur me disa gjëra që u thanë këtu dhe realitetin se si qëndron në terren.

Sa i përket raportit në mes të Telekomit dhe, më fal, deputete, se ka të bëjë ndoshta edhe me ju, Dardafonit, janë dy gjëra kryesore që e përcaktojnë të ardhmen. E para, duhet të bëhet një ekspertizë që është në kontraktim e sipër nga një nga katër kompanitë financiare kryesore në botë që do të bëhet një matricë financiare për ta vlerësuar dëmin apo mosdëmin financiar që kontrata shkaktonte te Telekom. E dyta, një mendim ligjor nga ekspertë të jashtëm që s’kanë të bëjnë as me Telekom dhe as me Qeveri, të cilët do ta japin përfundimisht një opinion ligjor lidhur me marrëveshjen mes Telekomit dhe Z-Mobile. Dhe këto dy letra, dy dokumente kryesore do të vendosin të ardhmen në mes të Telekomit dhe Z-Mobile. Çdo gjë tjetër, çdo ndërhyrje politike e

drejtpërdrejtë, e rrezikon një arbitrazh të dytë të mundshëm, ku ne jemi të pambrojtur, prandaj është me rëndësi që t'i bëjmë detyrat tona në shtëpi, t'i kemi dokumentet nga institucionet kredibile ndërkombëtare financiare që thonë bën apo nuk bën dhe tek pastaj, edhe nëse përfundon edhe një arbitrazh, të paktën i kemi qëndrimet tona të argumentuara dhe të dokumentuara.

Ky është qëndrimi zyrtar që duhet të presim deri në përfundim kur është afati i kohës së caktuar, më 31 korrik, për rregullimin e situatës sa i përket marrëdhënies në mes të Telekomit dhe Z-Mobile. Sa i përket qëndrimit tim si Qeveri, si ministër, ne e kemi shumë të qartë hapat e ardhshëm janë: ristrukturimi, rritja e vlerës së Telekomit dhe privatizimi. Për mua, asgjë tjetër nuk ka vlerë, sepse unë mendoj që privatizimi është forma e duhur, si çdo shtet tjetër i zhvilluar në botë, shumica e shteteve të themi ndoshta jo të gjitha, që e kanë ndjekur për ta mbajtur një ndërmarrje si Telekomit në një gjendje të mirë. Privatizimi do të thotë që ne do të mbesim aksionarë në një shumë të konsiderueshme të aksioneve, pra nga 25 deri në 49%, ku pjesa e vendimmarrjes, pra 51% duhet të privatizohet. Dhe, kjo jemi shumë me fat që Banka Evropiane, pra një ndër institucionet më kredibile në botë është e përfshirë në proces. Pse kemi kërkuar që një vit tash nga qershori i vitit të kaluar kemi kërkuar inkuadrimin e Bankës Evropiane për Ndërtim dhe Zhvillim ka qenë kryesisht për shkak të rritjes së transparencës në proces, rritjes së kredibilitetit dhe besueshmërisë edhe tek qytetarët, por edhe tek ata të interesuar për t'u futur në privatizim, si dhe rritjes së konkurrueshmërisë, pra kemi brende ndërkombëtare në këtë garë, në mënyrë që ta sjellim një herë e përgjithmonë një brend ndërkombëtar brenda Kosovës, pra në Telekom.

Pra, ky është procesi që ne e duam dhe normalisht në pjesën e ristrukturimit dhe rritjes së vlerës ne pajtohemi me Sindikatën, mirëpo sa i përket privatizimit, kam thënë disa herë që Sindikata do të jetë pjesë përbërëse e procesit të privatizimit, ku do t'i përfaqësojë më së miri interesat e punëtorëve dhe për këtë me Sindikatën unë e fuqizoj jashtëzakonisht shumë dialogun social në baza të rregullta, të mos them javore takohemi edhe me Sindikatën, në mënyrë që të shtjellojmë të gjitha problemet që kanë me Telekom, prandaj kjo për mua është me rëndësi rritja e transparencës, rritja e kredibilitetit të procesit dhe ndihmesa ndaj Telekomit. U përmend gjithashtu edhe pika e fundit është kredia sa i përket Qeverisë ndaj Telekomit. Një gjë ne duhet ta kemi gjithmonë në vëmendje. Qeveria e Kosovës nuk guxon të japë mjete buxhetore, pra direkt para te Telekomit, për arsye të ndihmës shtetërore. Ne çfarë jemi duke diskutuar është garanci shtetërore, në mënyrë që Telekomit të marrë kredi në banka komerciale dhe kjo do të ndodhë, jemi në finalizim e sipër dhe shumë shpejt do të ndodhë kur një vlerë prej 7.9 milionë eurove për implementimin e Kodit 383, për rregullimin apo investimin në mirëmbajtjen e teknologjisë dhe për një pjesë të investimit për sa u përket pajisjeve të përgjimeve, këto janë urgjente dhe do të bëhen shumë shpejt dhe kemi një afat kohor, ndoshta vetëm për nja një muaj që do t'i bëjmë.



Prandaj, çdo gjë tjetër që bisedohet për Telekomin, unë normalisht pajtohem edhe me atë që tha edhe kryeparlamentari që është një aset që kërkon vëmendje profesionale dhe jo vetëm debate publike, në mënyrë që t'i shterim ato interesa tona, pra populiste. Pra, ideja është që Telekom i Kosovës do të ristrukturohet nga ekspertë të jashtëm ndërkombëtarë që do të financohen nga Berzhi, do t'i rritet vlera, do t'i jepet mundësia për investime shtesë, nëse ka nevojë dhe në fund me një vlerë të shtuar do të privatizohet. Për privatizim prapë do të vendoset, do të bëhet një vlerësim i Telekomit nga kompani të jashtme, pra jo që kanë të bëjnë me Telekomin dhe do t'i japin vlerën e Telekomit edhe para dhe pas ristrukturimit dhe, nëse gjatë privatizimit ofertat janë nën vlerën që e ka Telekom, mund të mos vazhdojmë tutje, por nëse janë në vlerën apo mbi vlerën që përcaktohet nga kjo kompani e jashtme, atëherë ne vetëm mund të vazhdojmë tutje dhe kjo është e ardhmja e Telekomit. Faleminderit!

**KRYESUESJA:** Faleminderit, ministër! Replikë, Albulena Haxhiu! Urdhëro!

**ALBULENA HAXHIU:** Faleminderit!

Edhe një herë për neve është goxha shqetësuese se si ministri Lluka ende, domethënë ende nuk e ka një mendim sa i përket kontratës me Z-Mobile. Të gjithë po flasin, flet opozita se ajo kontratë është e dëmshme, flasin punëtorët, ndërsa ministri Lluka nuk guxon të theksojë, të deklarojë që ajo kontratë i ka shkaktuar miliona euro dëme Telekomit, rrjedhimisht buxhetit të shtetit.

Kjo është e papranueshme, një ministër i tillë, më vjen keq, por nuk mund të jetë ministër i Republikës së Kosovës, duhet të shkarkohet, sepse nuk ndërmerr veprime karshi kërcënimeve që një kompani i bën Telekomit të Kosovës, Qeveria është 100% aksionare, si është e mundur se ju pritni disa komisione atje, të cilat i ka krijuar Telekom me njerëz komplet joprofesionistë për të dhënë një mendim se a është kontrata me Z-Mobile apo jo e dëmshme. Dhe, tash garancia shtetërore që menaxhmenti dhe Bordi i Telekomit i ka kërkuar Qeverisë, në fakt është për ta shmangur rrezikun për dështimin e Valës, për shkak se kjo pastaj do ta lëkundte edhe rendin publik. Prandaj, Qeveria është dashur t'i hapë sytë, por edhe veshët dhe t'i dëgjojë, sepse Telekom është në një gjendje të papërballueshme financiare, me humbje operon. Prandaj, si është e mundur që Bechtel&Enkës lehtësisht ia jepni 53 milionë euro dhe kur është fjala për ta mbrojtur dhe rimëkëmbur një Telekom, një ndërmarrje publike, një gjigand ekonomik, ju nuk veproni.

Privatizimi, edhe një herë kam thënë, ministër, mos thuaj që të gjitha shtetet e kanë të privatizuar Telekomin, e ke Slloveninë, bre, nuk është shumë larg Kosovës. Ipko është e Sllovenisë, atje është publike, e ke Swiss Comin, e ke Telekomin e Gjermanisë.

**KRYESUESJA:** Faleminderit! Për kundër-replikë, ministri Valdrin Lluka, urdhëroni!

MINISTRI VALDRIN LLUKA: Faleminderit, kryesuese!

Deputete, e thashë, po ishe duke biseduar, e thashë më herët, ne sa i përket qëndrimit rreth Telekomit dhe Z-Mobile si ministër dhe si profesionist në këtë fushë, nuk ia liroj unë që juve t'u japë atë vetëkënaqësinë të merret vendim tash, ne duhet të bazohemi në trupa profesionale për të krijuar një opinion profesional që nesër, pasnesër, nëse përfundon ndonjë arbitrazh të mundshëm të ketë mbrojtje profesionale sa i përket qasjes me Z-Mobile.

Prandaj, kemi kërkuar angazhimin, pra mos harro, kemi marrë vendim në Komisionin Ndërmintor për Ndërmarrje Publike, që e udhëheq, kemi marrë vendim të krijohet një grup i jashtëm i ekspertëve ligjorë, që s'ka të bëjë as me Telekom, as me Qeveri, që do ta japin një mendim ligjor, por gjithashtu një ekspertizë financiare, pra ku futet kontrata në një matricë financiare nga top kompanitë që janë, edhe në Kosovë që kanë degët e tyre, por që janë ndërkombëtare, pra e dimë cilat janë katër kompanitë kryesore financiare...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYESUESJA: Regjia, të lutem, fjalën ministrit!

MINISTRI VALDRIN LLUKA: Prandaj, është me rëndësi që nuk guxojmë të ngutemi në këtë aspekt, pra kur të vijë koha, e kemi afatin përfundimtar 31 korrik. Deri më 31 korrik do të mbizotërojë, do të menaxhohet Telekomit, mirëpo nuk do të ketë ndonjë vështirësi. E dyta, sa i përket Telekomit është mirë të mos spekulohet, e përmende ti Ipkon, mirëpo Ipko ka filluar procesin e privatizimit, ka dështuar në muajin nëntor të vitit të kaluar, T-Mobile është aksionarë vetëm me 30%, është privatizua shumica, prandaj ka mbetur veç Telekomit zviceran dhe ai belg, të cilët nuk janë privatizuar tërësisht. Kanë domethënë shumicën e aksioneve, mirëpo një pjesë e tyre e kanë privatizuar.

Dhe, kjo është e ardhmja, të cilin ia siguron qëndrim të suksesshëm Telekomit. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit, ministër! Fjalën e ka deputetja Besa Gaxherri, urdhëroni!

BESA GAXHERRI: Faleminderit, zonja kryesuese!

Kolegë deputetë,

Unë vërtet sot s'e kam pasur ndërmend të diskutoj, por pas diskutimeve të liderëve, duke përfshirë edhe kryeministrin dhe kryetarin e Kuvendit, te koalicioni qeverisës, më provokuan që vërtet t'i them disa fjalë shumë shkurt, ani pse unë vërtet mund të flas me shumë kompetencë, kam punuar shumë vite në PTK dhe kur je brenda kësaj ndërmarrje, aty e sheh shumë qartë ose është një model aq i qartë i krimit të organizuar, i abuzimit me ligjin, i nepotizmit dhe të gjitha gjërave, të cilat vërtet e shpërfytyrojnë një shtet, e në këtë rast PTK-ja është maket e qeverive të Republikës së Kosovës.

Unë s' dua t'i ndaj qeveritë e PDK-së, e LDK-së, të AAK-së, qysh po thuhet sot, sepse çdo qeveri është përgjegjës për mandatin e vet. Unë po kërkoj ose po dua t'i shtroj do pyetje shumë konkrete sot, sepse zoti Veseli tha, ju lutem, me atë ironinë që vërtet është shumë ironike kur i dëgjon prej tipave të tillë “mos politizoni”, kush po politizon? Kush e ka politizuar PTK-në? Kush e ka shkatërruar PTK-në? Kush është pas kontratave të dëmshme? E nuk është një, e cila po flitet shumë Z-Mobile, në PTK janë lidhur kontrata të shumta të dëmshme për ndërmarrjen, siç është sot Telekomit dhe Posta, e ndarë nga Telekomit dhe ku e kemi ne Prokurorinë, e cila ende asnjë lëndë nuk e ka marrë dhe nuk e ka argumentuar para drejtësisë, e që drejtësia të vendosë në të mirë të PTK-së ose të Telekomit, ose të Postës, sepse është krimi i organizuar. Kush është pas atyre, të cilët themeluan ndërmarrje të tjera nga PTK-ja, cilët politikanë, ku është Prokuroria që asnjëherë nuk mundi t'i zbulojë këta, ndërsa ne deputetët e mediat, e plot qytetarë i thonë njerëzit me emra, ose e kemi aferën “pronto”, kush domethënë? Këto janë gjëra, të cilat ne këtu veç pretendojmë kush kujt t'ia gjuajë fajin, por ne e kemi kompaninë bazë të bankrotimit, falimentimit dhe nuk mund të falimentojë një kompani që dikur ka pasur 1 miliard euro vlerë pa një të keqe. Të gjuhet faji prej atij-këtij, jo, jo, faji ka adresë, sepse i keni ligjet, po s' do kurrkush të merret me këtë, sepse ende janë të fortit atje lart, qofshin në koalicionet qeverisës dhe këtë çdokush e di.

Kush janë pas kontratave dhe antenave të vendosura nëpër tërë territorin e Republikës së Kosovës? Kush janë ata? Kush janë të punësuarit aty e kush i ka punësuar? Dhe, sa është numri që vërtet mund të funksionojnë aty dy kompani sot të ndara me punëtorë dhe sa janë punëtorë tepër, pse janë bërë ato gjëra? Me këto gjëra nuk merret askush, as Qeveria jonë, as Kuvendi, e sidomos Prokuroria. Domethënë, kush janë pas kontratave të marketingut, se po vijnë duke më rënë në mend. Sa kontrata të marketingut gjoja bëhen aty, me miliona euro, të nderuar kolegë, dikush i nënshkruan, por pas tyre dihet kush është. Ca gjërave nuk mund t'u ikim, edhe këtu të bëjmë hipokrizi. Nuk po flasim fare për gjendjen, sepse Telekomit po shihet tash, për gjendjen e Postës. A e dini në çfarë gjendje e keni Postën, ky është një proces domino. Në atë moment që falimenton ose del në privatizim Telekomit, Posta me 1 mijë e 500 punëtorë do të jetë në rrugë, nuk ka mundësi të funksionojë as një javë pa mbështetje, për shembull, të qirave të Telekomit. Kush po merret me këtë? A e keni analizuar këtë situatë që vërtet edhe aty ka punëtorë, kompania është e stërngarkuar me punëtorë të pakualifikuar, jokompetentë për vendin e punës, sepse janë familjarë të politikanëve të caktuar që duhet të marrin rrogë aty.

Dhe, ne këto gjëra nuk duam t'i shohim, po te fundi i fundit, ne si deputetë jemi të thirrur këtu t'i diskutojmë këto gjëra, por ku e kemi Prokurorinë, zotin ministër, ku është prokuroria? Ata duhet të merren seriozisht, edhe një herë po e përsëris, nuk mundemi ne një pasuri kombëtare që ka pasur vlerë deri në 1 miliard, sot t'i mbyllim sytë e të themi: “Valla u shkatërrua dhe s' kemi çka”. Duhet gjetur përgjegjësit, kush janë ata që e shkatërruan, s'po më intereson cilës parti politike janë, por janë të politikës, edhe s'po dua tash të bëj avokatin e LDK-së, sepse jam shumë krenarë që jam LDK, por unë kam punuar në PTK, këtu po zotohem që nuk ka asnjë shkelje jo

vetëm nga qeveritarët e LDK-së, por edhe ndonjë punëtor rastësisht që ka qëlluar ndër ta edhe unë brenda PTK-së, asnjë. Por, në qoftë se ka, edhe ne duhet të shkojmë para përgjegjësisë, por vetëm kështu mund të zgjidhen problemet, por adresën ne e dimë të gjithë. Prandaj, duhet filluar të merremi seriozisht me problemet dhe nuk mund t'i ikë drejtësisë asnjë zyrtar, qytetar, drejtor, kryeshef që ka qenë në këto kompani. Prokuroria duhet të fillojë që nga fillimi i pasluftës me këtë kompani. Kush janë ata që e pengonin themelimin e Postë-Bankës që ishte një ndërmarrje në Kosovë, që asnjë bankë ende s'kishte arritur në Kosovë me buxhetin të cilin e kishte Posta në atë kohë. Kush janë ata që pengonin themelimin e Postë-Bankës që do të ishte një zhvillim i fuqishëm për vendin, sepse politikanët tanë sillnin banka komerciale në vend dhe ishin aksionarë të atyre bankave, e bënë biznesin dhe merrnin edhe nga Posta fonde për të dërguar aty. Të gjitha këto gjëra secili deputet mund t'i dijë, e unë i di edhe shumë të tjera, që ndoshta s'kam kohë t'i them, ndërsa Prokuroritë tona nuk po i dinë! Qe 20 vjet s'po dinë asnjë lëndë ta zgjidhin në të mirën e kësaj ndërmarrjeje publike!

Prandaj, unë po e mbyll fjalën time dhe po kërkoj, keni parasysh, zoti ministër, përveç kompanisë që gjoja është përgatitur që sa vjet, prej ndarjes prej Postës për t'u privatizuar, se m'u kujtua prapë zoti Veseli që na e kujtoi që ne kemi qenë parti e djathtë, po jemi parti e djathtë, por nuk jemi parti që lejojmë të abuzohet me pronën e këtij populli, edhe nuk duhet të lejojmë. S'po na intereson hiç privatizimi. S'mund të privatizohet ajo kompani pa u zgjidhur se kush e shkatërroi, pa ardhur para drejtësisë kush e shkatërroi kompaninë, sepse ajo është pronë e popullit, nuk është pronë e asnjë partie politike.

Unë ju sugjeroj, përveç problemeve me Telekomin, merreni bëni analizën në Postë, sepse është proces domino dhe pastaj kur ju dalin qytetarët, ose punëtorët në rrugë, atëherë do të jetë vonë. Faleminderit!

**KRYESUESJA:** Faleminderit, deputete! Fjalën e ka deputeti Bekim Haxhiu. Urdhëroni!

**BEKIM HAXHIU:** Faleminderit, e nderuar kryesuese!

I nderuar ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar përfaqësues të medieve,

Intenca, ashtu siç e kam kuptuar unë, e këtij debati parlamentar ka qenë për ta ndihmua Telekomin për gjendjen në të cilën është. Për arsytet që kanë sjellë në këtë vështirësi Telekomin Parlamenti i Kosovës me iniciativën e deputetit Milaim Zeka ka themeluar Komisionin Parlamentar Hetimor. Jam pjesë e atij komisioni, jemi përfaqësues të të gjitha partive politike, jemi duke e bërë punën tonë, prandaj të gjithë këta deputetë që po deklarohen "e dimë, e dimë kush, e dimë" e ata që s'e dinë, a pat që s'e dinë, edhe këta që e dinë, ju kisha lutur krejt këto fakte të na i sillni në Komision Parlamentar.

Nëse vazhdojmë me këtë seancë kështu, ta drejtojmë gishtin nga njëri-tjetri ose sa për të bërë pak politikë, Telekomini nuk e ndihmojmë. Telekomini sot e ndihmojmë duke angazhuar Qeverinë seriozisht ta zgjidhë problemin, të cilin e ka aktual, e që është para falimentimit. Ne mund ta ndihmojmë Telekomini nëse nxjerrim rekomandimet e duhura, nëse nuk merremi me këto akuza të ndërsjella. Kam thënë në fillim në Komisionin Parlamentar Hetimor se jam për hetim të plotë dhe për transparencë të plotë, ama të gjithë ju që po e rrisni zërin këtu pak më shumë e dikush pak më pak, po ju tregoj që si në fund të atij raporti do të gjendeni edhe ju, edhe familjarët tuaj. Ka pasur këtu që janë publikuar emrat e familjarëve të deputetëve, ama ka edhe të të gjitha partive politike janë të punësuar në Telekomini e Kosovës, bash familjarët e të gjitha partive politike, por ka edhe deputetë të partive politike që ka pasur kontrata deri në 3 milionë e gjysmë euro me Telekomini e Kosovës.

Ndoshta Besa e kishte lëshuar Telekomini menjëherë po t'i jepej një kontratë 3-4 milionë. Pra, do t'i shikojmë deri në fund të gjitha. Ka dëshirë të drejtohet gishti kah një subjekt politik. Unë po ju tregoj që fillimi i MVNO-s apo operatorit virtual fillon me kryetarin e Bordit, zotin Ilir Salihu. Nëse doni, vazhdojmë tutje deri në fund. Krejt do t'i qesim, po të mos ju ngutim me raportin përfundimtar, që do të vijë këtu, do ta votoni ju, deputetë, se na e keni dhënë atë autorizim dhe do ta lexoni e votoni, e pastaj do ta çojmë në organet e ndjekjes. Nëse dëshironi ta dini të vërtetën, pa ia drejtuar gishtin njëri-tjetrit, do ta kuptojmë të vërtetën për Telekomini.

Po, ka kontrata të dëmshme. Fillon me operator virtual. Po doni ta ndihmoni, u kam thënë në komision, po ju them edhe këtu. Edhe një herë po jua propozoj një pjesë të rekomandimeve. Hajde i ndalojmë me Ligjin për komunikimet elektronike nr. 04/L-109 dhe i ndalojmë me ligj operatorët virtualë dhe nuk ka më kontratë me Z-Mobilin. Bie kontrata. Ne Ligjin për lojërat e fatit brenda ditës e shfuqizua. Nëse është interes nacional të mbrohet Telekomini, hajde me ligj po e ndalojmë funksionimin e operatorëve virtualë. Ka këtu që thonë se rekomandimet e BE-së thonë që duhet të ketë, po e shohim që ato rekomandime dikush i ka abuzuar. Mundet dikush ta drejtojë gishtin te një parti politike, por interferimet pothuajse të shumicës janë. Unë i kam thënë edhe Sindikatës, se zakonisht drejtimin ose shprehjen politika, politika, e unë them grupet e interesit. Grupet e interesit, të cilat edhe janë mbështetur kah partitë politike për t'i realizuar qëllimet e veta.

Humbja e arbitrazhit, kur ndodhi? Ndodhi në kohën e Isa Mustafës, ministrit Avdullah Hoti. Ne e kishim edhe një kërkesë të Telekomini, në fakt të Postës së Kosovës, në Qeverinë e Isa Mustafës, që të bëhet një marrëveshje t'i shpërndajmë pensionet. Posta t'i shpërndajë pensionet për shkak se Posta e Kosovës do të gjeneronte të hyra më shumë dhe do të mbijetonte. Ne e kishim edhe debatin këtu për pensionistët kontributdhënës dhe njëri prej rekomandimeve që e kam propozuar ka qenë që t'i jepet Postës shpërndarja e pensioneve, se do të kishte mundësi t'ia dërgonte një pensionisti pensionin në shtëpi, ose t'ia shpërndante në mënyrën që ata merren vesh. Dhe, e mbështetëm.

Kolegë, keni ikur nga seanca, nuk i keni votuar rekomandimet, nuk e keni ndihmuar Postën e Kosovës. Nuk mundemi herë të iket prej seancës e të mos ndihmohet Posta e pas një muaji këtu të vajtohet për Postën e Kosovës. Nuk mundet ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale i LDK-së të mos nënshkruajë marrëveshjen me drejtorin e Postës për t'i shpërndarë pensionet dhe të vijë tash e të vajtojë LDK-ja Postën e Kosovës. Të lutem, ta bëjmë bashkë. As Posta, as Telekom, as ndërmarrjet publike, as ky Kuvend nuk është i një partie politike. Këtu jemi përfaqësues të të gjithë qytetarëve dhe do ta mbrojmë atë interes, nëse duam vërtet t'i ndihmojmë Telekomit të Kosovës.

Tani, si të dilet prej situatës? Edhe një herë po ju kërkoj, të nderuar kolegë deputetë, këtë pjesën që e kemi si Komision Hetimor Parlamentar kursehuni pak, sepse ka argumente të bollshme që kontratat kanë qenë të dëmshme dhe ato do t'i sjellim para jush, pastaj do t'i shohim kush i ka nënshkruar, kush ka qenë anëtar Bordi, kush ka dhënë sugjerime, le ta marrë secili përgjegjësinë e vet për periudhën kohore që e ka bërë. Po, ka pasur një kohë që prej Telekomit janë marrë 400 milionë euro dividendë, ka ndodhur një periudhë kohore që ka qenë një kryeshef, pastaj ka vazhduar rënia, por të njëjtën kohë kur kanë qenë të hyrat më të mëdha, ka ndodhur edhe kontrata që konsiderohet e dëmshme me Z-Mobilin. Ne jemi duke u marrë me këtë çështje.

Sot po kërkohet mbështetje për Telekomin për të dalë prej situatës. Nëse Qeverisë i ka ardhur mirë kur i ka marrë 400 milionë euro si aksionare, atëherë edhe si aksionare ka obligim ta ndihmojë Telekomin të dalë prej situatës, sepse edhe në të mirë, edhe në të keq, është aksionar. Por, kemi të bëjmë kryesisht me menaxhimin. Domethënë, Telekom i ka ardhur në këtë situatë për shkak të keqmenaxhimit. Po e marr një shembull, në vitin 2011 Telekom i ka dhënë dividendë Qeverisë, por një kompani atje për menaxhimin e deponive, kompani e bërllokut, ka qenë përpara falimentimit. Sot ajo kompania e bërllokut që ka qenë buzë falimentimit i ka dhënë dividendë Qeverisë. Ajo u rimëkëmb. Po, kjo tash kërkon mbështetje, sepse është buzë falimentimit. Pra, kemi të bëjmë kryesisht me menaxhimin.

A e kanë kërkuar mbështetjen e politikës këta menaxherë apo u është ofruar politika atyre, do ta sjellim raport përpara, do të deklarohen secili prej tyre në komision. Ne nesër e kemi si Komision Hetimor Parlamentar një mbledhje në orën 9:00, mu për këtë çështje dhe jemi duke punuar që çdo kontratë të trajtohet pa paragjykime, me fakte. Nëse ne i kemi marrë kontratën e Z-Mobilit, i kemi parë disa parregullsi në atë kontratë, dy vula të ndryshme në marrëveshjen parimore, fillimisht që është nënshkruar në mes Z-Mobilit dhe Adnan Merovcit, e nënshkruar pastaj në mes Z-Mobilit dhe Shyqri Haxhës, dhe e humbur në arbitrazh vitin e kaluar, edhe tani do t'i shikojmë të gjitha këto arsye.

Komunikimin që ka pasur Telekom i Kosovës, Gjykata e Arbitrazhit dhe të gjitha këto janë pjesë e Komisionit Hetimor, prandaj na lejoni të punojmë me të gjitha ato kontratat, jo vetëm kontratat e qirasë që janë të antenave, por edhe kontratat e objekteve edhe të parapaguara deri në

vitin 2023, e shumë çështje të tjera që janë aty e që janë pjesë e këtij komisioni, por ato lërnani neve. Hajde të merremi vesh se si ta shpëtojmë Telekomin nga situata që është dhe të ecim tutje me temën tjetër, ta mbështesim edhe Postën e Kosovës, si dy kompani publike.

Në fund po them, nuk është kompania më e rëndësishme Telekom, për mua mbetet Trepça kompania më e rëndësishme në Kosovë, sepse pa zhvillimin e Trepçës nuk ka zhvillim të Kosovës. Faleminderit!

**KRYESUESJA:** Faleminderit, deputet. Për replikë fjalën e ka Besa Gaxherri. Urdhëroni!

**BESA GAXHERRI:** Faleminderit, zoti Haxhiu, që ma dhe mundësinë për të replikuar. Po i referohem shprehjes suaj “Besa, ndoshta e kishte lëshuar Telekomin, nëse e kishte marrë një kontratë 2-3 milionë euro”. Unë po them shumë sinqerisht, se jam shumë krenare, ma dhe mundësinë të flas tash për vete. Jam shumë krenare që kam punuar dy-trembëdhjetë vjet në PTK dhe asnjë gjë, asnjë hap, asnjë ditë, kam qenë menaxhere e një regjioni, unë nuk kam vepruar e nuk kam punuar duke e shkelur ligjin. Dhe që ta përmbyll këtë replikë, unë s’kam pasur as konflikt interesi.

Në atë moment që unë jam zgjedhur deputete, unë jam tërhequr nga PTK-ja. Prandaj po kërkoj, po duhet dhënë edhe shembull, sepse aty ka pasur mundësi të punohet mirë, ka njerëz që kanë punuar mirë, po ka njerëz që e kanë shkatërruar dhe ata njerëz duhet të dalin para drejtësisë. Nuk mund t’i mbyllim sytë e të themi “S’po dimë çka ka ndodhur dhe hajde po e shesim...” Ajo s’mund të ndodhë! Duhet ta presim raportin e auditimit, edhe të Komisionit Hetimor dhe ta shtyjme Prokurorinë që të merret me njerëz që e prunë në këtë gjendje këtë kompani. Ju thatë, “Trepça është më e rëndësishme...” Në Trepçë duhet investuar shumë, ndërsa kjo ka pasur vlerë të gatshme, e ne e kemi gërryer dhe sot e kemi prurë në buzë të falimentimit, s’ka kurrëgjë në të.

**KRYESUESJA:** Faleminderit! Kundër-replikë Bekim Haxhiu. Urdhëroni!

**BEKIM HAXHIU:** Jo kundër-replikë, më shumë të fokusohemi në atë për çka edhe e kemi ftuar këtë, është kërkuar kjo. Unë nuk përmenda, Besë, që ti i ke marrë, po thashë sigurisht që kemi deputetë këtu që ka pasur kontratë me Telekomin e Kosovës 3-4 milionë euro, edhe dikujt tjetër i është adresuar gishti, ta zëmë, po e marr shembull, prapë Besë, po të marr shembull ty për të mos pasur ndonjë replikë tjetër, se Besa e ka ndonjë familjar të punësuar atje, e u bë nami se e ka pasur dikë që punon ndershem atje, ose është inxhinier i zoti edhe tash e adresojmë edhe ta mbajmë ne Besën, e ai zotëria atje duke i marrë nga 3-4 milionë euro. E i njëjti ka pasur tash edhe lidhje me disa portale të tjera, e ka marrë para edhe përmes portaleve. 38 milionë euro janë shpenzuar prej Postës dhe Telekomit të Kosovës për marketing, reklama e gjëra koti, për portale edhe inekzistente, do t’i sjellim këtu, edhe raportin, do ta votojmë dhe do të shohim bashkë kush ka qenë.

KRYESUESJA: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Albin Kurti. Urdhëroni!

ALBIN KURTI: Deputetë të Kuvendit,

Qytetarë të Republikës,

Kontrata e Telekomit të Kosovës me Dardafon, si operator mobil virtuel, e më pastaj Dardafone.net, e më vonë e tash Z-Mobile, është krim i organizuar dhe është faktori kryesor i krizës në Telekomin e Kosovës. Natyrisht, ka edhe faktorë të tjerë, por le të mos shpërqendrohemi. Kontrata me Z-Mobile është aktuale dhe dëmet e kësaj kontrate joligjore vazhdojnë të thellohen sot e kësaj dite. Z-Mobile ia plaçkit mbi çerekun e të hyrave Telekomit të Kosovës. Z-Mobile kësaj është shndërruar në aksionarin kriminal, i cili e ka një pjesë të Telekomit deri në 30%, dhe dëshiron që ta marrë të tërën. Prapa Z-Mobile qëndron ish-kryeministri, tash president, dhe ish- shefi i shefave nga klani Pronto, i cili njërit prej vëllezërve Devolli i ankohej se i është tharë fyti! Z-Mobile është pra ‘Kali i Trojës’, të cilën ‘Gjarpri’ ia imponoi dhuratë Postës edhe Telekomit të Kosovës. Prandaj, sot nuk ka kuptim të flasësh për askënd, përveçse për Prokurorinë dhe policinë. Qytetarët e dinë, ne deputetët e dimë, edhe pushtetarët e dinë. Prokuroria dhe policia duhet të veprojnë.

Ka shumë metoda për ta zgjidhur lëmshin e korrupsionit në sektorin e telekomunikimit, mirëpo tri prej tyre janë më të thjeshtat. E para, është dështimi për të arkëtuar garancinë bankare prej 16,2 milionë eurosh, që është 20% e ofertës financiare të të ranguarit të parë asokohe në tenderin e dytë të telefonisë mobile, ‘Koscell’.

Një tjetër rrugë për ta kuptuar krimin në telekomunikacion është hetimi i kontratës me Z-Mobile, që është edhe tema e seancës së sotme, kontratë kjo që ishte goditja më mizore kundër Telekomit të Kosovës. Përkundër faktit se kjo kontratë ishte konsideruar si e dëmshme për PTK-në, qeveria insistonte që ajo të nënshkruhet dhe madje nënshkrimin e saj e vendosi si kusht për këdo që do të vijë drejtor në PTK. Kur një drejtor menaxhues emërohet në një kompani publike, aq më tepër në Telekomin e Kosovës, pa pasur ekspertizën e duhur, ai e di që është aty duke iu falënderuar partive në pushtet dhe, kur kjo ndodh, vendimet e tij do të jenë të orientuara më shumë drejt shpagimit të borxheve ndaj politikës, sesa drejt zhvillimit të kompanisë, përkatësisht Telekomit në rastin tonë.

Dhe, një mënyrë e tretë për ta kuptuar krimin që ndodhi në këtë sektor është thjesht shikimi i pasqyrave financiare dhe krahasimi i tyre me kompanitë private, në të cilat politika ishte e lidhur me interesat e saj partikulare. Ndërkohë që operatorët privatë po rriteshin, që nga viti 2010 Telekomit po binte me një shpejtësi të jashtëzakonshme. Kështu, më 2009, një vit pasi PDK erdhi në pushtet, Telekomit i Kosovës i dha buxhetit 200 milionë euro. Kurse në vitin 2014, kjo kompani kishte një dividendë prej vetëm 10 milionësh, e sot po e kërcënon falimentimi.



Ish-drejtori Mustafa, Agron Mustafa, e ka marrë kompaninë me 48 milionë euro dhe pas tre vjetëve e ka sjellë në 200 mijë euro pasuri dhe shumë borxhe të tjera, të cilat kanë ngelur edhe kur ai më nuk ishte drejtor. Pra, drejtorët janë ndërruar, njëri pas tjetrit, janë bërë ushtrues detyre, kemi dhe Bordin aktual, por që të gjithë këta para se të jenë njerëz pa integritet, janë njerëz jokompetentë.

Në kompanitë e Telekomit nëpër botë, njerëzit më inteligjentë, më të ditur, më gjenial të shoqërisë, bëhen kryeshefa. Në Kosovë është e kundërta. Prej ushtruesit të detyrës Zeqir Kiçina e deri te Bedri Istrefi e te Bordi aktual, edhe nëse këta kanë qenë njerëz të mirë, qytetarë të ndershëm, çlirimtarë të devotshëm, po i humbim si të tillë e po fitojmë menaxherë të këqij. Pra, edhe po u bëhet dëm atyre njerëzve, përveçse natyrisht po rrënohet me shpejtësi aktualiteti e potencialiteti i Telekomit të Kosovës.

Kryeministrit Haradinaj i pata thënë që ka dhjetëra drejtorë shqiptarë të Telekomit nëpër kompanitë e ndryshme botërore, në nivele të ndryshme në ato kompani. Mund të them që nja pesë a gjashtë i njoh personalisht. Ne kemi nevojë që një të tillë ta sjellim në Telekomin e Kosovës, sepse njëmend menaxhmenti i gabuar e i dështuar është problemi. Virtyt Koshi ka mbaruar studimet në Oksford, ka qenë zëvendës-president i Ericson-it për Britani të Madhe. Nysret Shala po ashtu në Britani të Madhe, Shkumbin Hamiti në Finlandë. Pse të mos e sjellim një të tillë ta drejtojë Telekomin e Kosovës, por të vazhdojmë kështu dështim pas dështimi me njerëz partiakë, të cilët edhe një herë po e them, para se të jenë pa integritet, janë jokompetentë. Nuk janë profesionistë në atë punë. Nuk mund të jetë një njeri për gjithçka. E, për drejtues të Telekomit, në çdo vend të botës, pak kush është.

Privatizimi është problem shumë i madh, edhe për një arsye shtesë që është përmendur rrallë: sepse e kemi shtetin përtokë. Është e vërtetë që një pjesë e aksioneve edhe të telekomeve nëpër vendet e zhvilluara perëndimore u takon privatëve. Mirëpo, ato janë shtete të fuqishme. Shteti i fuqishëm e ka luksin që një pjesë të konsiderueshme të ndërmarrjeve publike edhe t'ua japë privatëve. Mirëpo, një shtet përtokë si puna e Kosovës, nuk e ka këtë luks. Pa e forcuar ne shtetin me sundim të ligjit, me prokurori e gjyqësi, me integritet e kompetente, ne nuk guxojmë të privatizojmë. Me shtetin përtokë, privatizimi është fatal. Ne duhet ta forcojmë shtetin para çfarëdo privatizimi apo shitje të aksioneve të pjesshme nëpër ndërmarrjet publike.

Por, për zgjidhjen afatgjate, natyrisht që ne nuk e shohim sërish privatizimin zgjidhje. E kemi solucionin e qartë: Fondi Sovran, që ia merr ndërmarrjet shoqërore AKP-së edhe e mbyll AKP-në, ku s'ka nevojë të jetë sekretari i partisë drejtor dhe, ndërmarrjet publike ia merr qeverisë, i ristrukturon, e ndalon privatizimin, eventualisht shet aksione dhe, pse jo, ta bëjmë mërgatën tonë pronar dhe motor të zhvillimit tonë ekonomik, e jo vetëm faktor të mbijetesës sociale. Fondi Sovran është zgjidhja afatgjate. Dikush mund të mendojë që ne këtu nuk e kemi zgjidhjen urgjente? E kemi edhe zgjidhjen urgjente. Mund të mos e kenë deputetë të veçantë, por e ka

shteti ynë, sepse Kuvendi i Kosovës ka miratuar rezolutë me një duzinë pikash se si të shpëtohet edhe mbrohet Telekom i Kosovës më 12 korrik të vitit të kaluar. Ne zgjidhjen e kemi, ne nuk po e zbatojmë atë. Ne kemi një qeveri, e cila e bojkoton Kuvendin, se Kuvendi ka miratuar rezolutë. Qeveria nuk po e zbaton atë. Nuk është e vërtetë që nuk e kemi zgjidhjen. Unë e thashë, zgjidhjen afatgjate për të cilën beson subjekti ynë, nëpërmjet Fondit Sovran, ndërkaq, zgjidhja urgjente nuk është e subjektit tonë, është e këtij Kuvendi. Dikush mund të ketë votuar kundër, por ky Kuvend e ka dhënë zgjidhjen me ato 12 pika sesi mund të shpëtohet e mbrohet e zhvillohet Telekom i Kosovës dhe të dalë nga kriza aktuale.

Deputetë të Kuvendit të Kosovës, unë nuk besoj që ka deputet individualisht këtu, i cili thotë që kontrata me Z-Mobile është e mirë. Ju lutem, më thoni, a jeni ndonjëri prej jush i këtij qëndrimi, që kontrata me Z-Mobile është e mirë? Unë nuk besoj. Edhe duke ju njohur publikisht, e disa prej juve edhe privatisht, unë e di që asnjëri prej juve nuk mendoni që kontrata me Z-Mobile është e mirë. Rrjedhimisht, meqenëse nuk është e mirë, le ta bëjmë vendim të Kuvendit, vendim të shtetit tonë, të këtij Kuvendi si organi më i lartë në Republikën tonë parlamentare e demokratike, dhe kështu ne do t'i japim shumë fuqi shtetit tonë që më datën 1 gusht të këtij viti Z-Mobile t'i takojë së kaluarës. Faleminderit.

**KRYESUESJA:** Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Shkumbin Demaliaj.

**SHKUMBIN DEMALIAJ:** Faleminderit kryesuese!

Të nderuar kolegë deputetë,

Qytetarë të nderuar të Republikës së Kosovës,

Seanca e jashtëzakonshme e thirrur sot nuk e ka vlerën e një seance të jashtëzakonshme apo të një zgjidhjeje të një problemi me të cilin Kuvendi ka marrë obligimet. E dimë këtë mirëfilli, për shkak se është formuar një Komision Hetimor nga Kuvendi, pikërisht nga të gjithë këta deputetët, po edhe nga opozita që sot e ka thirrur këtë seancë të jashtëzakonshme.

Është e vërtetë që kemi pasur pak dokumentacion dhe njohuri derisa Komisioni Hetimor, në të cilin bëjë pjesë edhe unë dhe përfaqësoj Aleancën për Ardhmërinë e Kosovës, kemi krijuar qasje në dokumentacione zyrtare.

Gabimi më i madh i thirrjes nga opozita të kësaj seance të jashtëzakonshme është për shkak se iu dha mundësia për të pasur qasje në atë dokumentacion dhe është për t'i prishur hetimet. T'i prishë hetimet që është duke i bërë Komisioni Hetimor. Nëse e hetojmë Postën, Telekomin dhe Valën, kjo seancë nuk është dashur të thirret sot. Por, kjo është për të prishur hetimet. Le ta dinë krejt qytetarët e Republikës, po edhe punëtorët e Postës, edhe të Telekomit, edhe sindikalistët atje se zhvillimi i kësaj forme të kësaj seance është për t'i prishur ato hetime.

E kam thënë se nuk kam qejf të jem anëtar i një komisioni që nuk e kryen punën e vet. Edhe kjo po shihet sot me thirrjen e kësaj seance. Qeveria e ka kryer punën e vet, në bazë të asaj që e tha edhe kryeministri. Vendimet e jashtëligjshme edhe që nuk janë të rregulluar me ligj, nuk mund të ndërmerren askush për qejfin e askujt. Sepse kontratat e jashtëligjshme, aneks-kontratat e pavulosura dhe të gjitha ato veprime që janë marrë deri tash, se po shkoj sipërfaqësisht, sepse neve si deputetë kemi dhënë një deklaratë dhe kemi nënshkruar nën betim se nuk do të bëjmë publike asnjë nga marrëveshjet, kontratat e marketingut dhe të gjitha ato që sot Komisioni Hetimor i ka para vetes dhe do të dalë me rekomandimet dhe deklaratimet përfundimtare që do t'ju sjellë juve këtu.

Për secilën kontratë, edhe për humbjen në arbitrazh, do të deklarohet, këtu do të thuhet, edhe atëherë Prokuroria do të treguar. Se edhe arbitrazhi fillimisht Postën e Telekomit e ka fituar me pesë milionë, qysh u bë ajo shumë 30 milionë? Edhe këtë kemi për ta nxjerrë. Fillimisht 5 milionë janë humbur në arbitrazh. Marrëveshjet politike të njerëzve që kanë qenë brenda për brenda këtij mekanizmi e kanë sjellë punën të jetë deri te 30-milionëshi. Kjo është për të dyshuar.

Po flitet për privatizimin e Postë-Telekomit, flitet se asetet e saj kushtojnë 27 milionë, a ndërkaq borxhi nga arbitrazhi që është dëmtuar Postë-Telekomi është 30 milionë. Qysh do ta privatizosh? Humbjet i ke 30-milionëshe, privatizimi komplet 27, çfarë baraspeshe, çfarë barazie ka në këtë rast?

Po flitet, edhe duke u munduar t'u iket krejt këtyre deklaratimeve, krejt këtyre marrëveshjeve, të gjitha këtyre shkeljeve, po flitet për disa të punësuar në Postë. Për 42 politikanë të rangut të lartë, që janë edhe deputetë, po janë edhe përfaqësues të subjekteve politike, me emra e mbiemra, këtu i kam komplet, janë anëtarë të tyre nga katër e pesë të punësuar në Postë, bile edhe pozita menaxheriale. Këtë nuk do t'ia jap askujt. Nëse dikush do ta dijë, edhe e bëj publike, po do t'ia jap Komisionit Hetimor, për çka jam i thirrur si anëtar i komisionit. 42 politikanë, asnjëri s'janë të Aleancës këtu, asnjë s'janë të Aleancës, se të Aleancës janë publikë dhe ne kemi vepruar me transparencë para secilit akt dhe para secilës gjë që ka ndodhur sot në Kosovë.

Mua më vjen mirë që një deputet, deputet jo, por shefi i GP të LDK-së, z. Hoti, i ndjek deklaratat e mia televizive. Unë të atij s'i ndjek kurrë, se s'ka çka thotë. Po edhe deputetë të tjerë më kanë quajtur më herët cub, mua dhe kolegët e mi. Asnjë anëtar të familjes, dihet cila është veprimtaria e cubave në të kaluarën. Nuk ia njoh atij deputeti, as s'e di ku e ka pronën, as s'jam i pamoralshëm, as nuk jam hajn. Me deklaratat të tilla më keni çuar edhe drejt Prokurorisë, pse kam folur në televizor. Ndiqni deklaratat e mia. Nëse dikujt i duhem në burg, unë shkoj, po veç pse kam thënë a ka shtet, le të ndërmerren shteti, ose po veprojmë privatisht, unë kam mbajtur një muaj paraburgim, edhe sot ndoshta jam pranë një aktakuze. A këtu flitet për një miliard keqpërdorime, të gjithë ikin prej kësaj veprimtarie. Unë besoj në Komisionin Hetimor, u besoj të

gjithëve dhe kërkoj nga të gjithë deputetët që Postë-Telekomi i Kosovës dhe Vala asnjë ditë të mos mendohet të privatizohet pa u zbardhur të gjitha keqpërdorimet edhe kriminaliteti brenda saj. Kuvendi ta marrë këtë vendim.

U fol më herët që të nxirret një ligj, sikur i kemi larguar lojërat e fatit. Po edhe të vendoset që PTK dhe Vala të mos privatizohet, as mos të mendojë kush të privatizohet pa u hetuar dyshimet në të gjithë kriminalitetin që ka ndodhur brenda Postë-Telekomit të Kosovës.

Flitet për shifra që mbërrijnë asetet e saj. Ne kemi marrë një deklaratë, po e flas edhe nga këtu, nga Komisioni Hetimor. Vetëm kablo optike e shpërndarë në territorin e Republikës së Kosovës është një miliard e gjysmë me vlerë, e flitet për shifra hajgare në privatizimin e saj. Ta mbrojmë këtë gjigant ekonomik, edhe ta bëjmë aset kombëtar. Nëse ka nevojë të privatizohet diçka, Qeverinë, shtetin, Parlamentin i kemi këtu. Faleminderit shumë! Nëse ka nevojë qasemi edhe më tutje. Faleminderit!

**KRYESUESJA:** Faleminderit, deputet! Fjalën e ka deputeti Dukagjin Gorani.

**DUKAGJIN GORANI:** Të nderuar deputetë,

Sipas logjikës së sistemit ekonomik të Kosovës së pasluftës, është i pamundur falimentimi i një ndërmarrjeje publike. Kjo për faktin se ndërmarrjeje publike u lejohet edhe fitimi nga tregu, edhe subvencionimi nga shteti. Kur janë themeluar, ato ishin menduar të funksionojnë sipas një rregullimi kontrovers. Të jenë kapitaliste karshi tregut dhe figurativisht socialiste karshi pushtetit. Sipas kësaj logjike, ekzistimi i tyre ishte kombinim i privilegjeve të rralla ekonomike. Tregu i garantuar, fitimi i sigurt dhe financimi shtetëror. Dhe, përkundër pavarësisë formale, ndërmarrjet publike ishin dhe vazhdojnë të jenë të menaxhuara nga Qeveritë e ditës.

Në veçanti ky përshkrim merr kuptim nëse i përfytyrojmë, mes tjerash, dy ndërmarrje të tilla në Kosovë: Radiotelevizionin dhe Postë-Telekomin e Kosovës. Nuk u desh shumë pas themelimit të tyre, që këto anomali të privilegjeve të përjetohen nga çdo Qeveri si fushëlojë për t'i zbatuar dy qëllimet fundamentale, për të cilat fitohet edhe humbet pushteti në vend. Përfitim të parasë përmes përqindjes nga fitimi dhe punësim të militantëve për ta shtrënguar kontrollin partiak. Paratë janë fituar përmes kontratave dhe nënkontraktimeve, që do të thotë që për punët që duhej t'i kryente vetë një ndërmarrje publike, paguante kompani private. Lojaliteti ishte kushti i vetëm për të fituar kontratë, kurse jetëgjatësia e saj varej nga gatishmëria që paratë e fituara të ndahen me grupet e pushtetit, sipas përqindjes së paracaktuar.

Ndërkohë militantët partiakë punësoheshin për dy arsye, për një rrogë mujore dhe për dëgjueshmëri ditore. Puna e tyre në menaxhim nënkuptonte kryesisht përpjekje që të sigurohet fitimi për grupet e pushtetit.

Gjatë viteve, me përjashtime të papërfillshme, gati 100 për qind e parasë së fituar në ndërmarrje publike u shkonte këtyre grupeve të pushtetit, qoftë përmes kontratave në kompani private, qoftë përmes rrogave të militantëve. Edhe për ata që s'kuptojnë shumë nga ekonomia dhe financat, çfarë është edhe puna ime, ishte lehtë të kuptohet që një gjendje e tillë nuk mund të zgjatë përjetësisht. Ndërmarrjet publike që u themeluan mbi idenë e të mirës së përgjithshme, u përdorën si instrument për pasurimin e grupeve politike. Zhvillimi ekonomik dhe avancimi profesional nuk ishte qëllimi i tyre, andaj edhe humbjet dhe falimentimi ishin parashikime reale. Një parashikim i tillë na mblodhi sot këtu.

Telekomi i Kosovës është vetëm njëra ndër kompanitë publike që do të falimentojnë, por është ndër të vetmet që nga falimentimi i së cilës do të mund të fitohet para e madhe. Për grupet e pushtetit dhe për kompanitë e tyre private. Me sa po shihet, shpëtimi i tyre është i pamundshëm dhe shpëtimi i Telekomit në këtë rast është pak a shumë i pamundshëm. Për të nuk ekziston as vullnet, e as interes.

Andaj, arsye formale për të cilat jemi mbledhur ne sot këtu janë dy: e para është që ta emërojmë fajtorin për bankrotin e ndërmarrjes më të fuqishme në vend, meqë kjo duket të jetë me rëndësi për opinionin publik. E dyta është që këssoj t'i japim një legjitimitet politik traditës sonë që pasuria shtetërore të zhvatet nga pushteti shtetëror.

Ajo që pritet t'i ndodhë Telekomit të Kosovës nuk është e vështirë të kuptohet. Do të nisë procedura e falimentimit, e cila në fund do të reduktohet me ofertë të privatizimit. Kompanitë private që u zhvilluan duke i kryer punët për të cilat paguhej Telekomi, do ta themelojnë një konzorcium dhe një ofertë për ta privatizuar atë. Ndërkohë, një numër i përzgjedhur i militantëve të punësuar do të mbetet në menaxhim të Telekomit të privatizuar, me emër të ri dhe me qëllim të vjetër. Një pjesë tjetër do të sistemohet nëpër sektorin e stërngarkuar publik, e kusuri do të mbetet në rrugë.

Si edhe më herët, këto fate njerëzore do të përcaktohen nga grupet e pushtetit, sipas kriterëve të afërsisë, të lojalitetit dhe të përdorshmërisë. Ndërkohë, ne sot do të përfundojmë në dy taborë, njëri që do të kërkojë dorëheqje, përgjegjësi penale dhe ndërgjegje morale nga Qeveria. Qeveria, sidomos kjo e sotme, do të arsyetohet me bartje të fajësisë të qeveritë e mëparshme, kurse përfaqësuesit e qeverive të mëparshme do të përbehen se nuk ka pasur kurrë asnjë shkelje të procedurave ligjore gjatë procesit të njëres nga plaçkitjet më të mëdha të pasurisë publike në historinë e këtij shteti të ri. Dhe, kjo mbase mund të dalë edhe formalisht e vërtetë. Kështu u pohua nga të gjitha hetimet e deritashme, qoftë vendore apo ndërkombëtare. Se nuk ka pasur shkelje ligjore. Edhe kjo mund të jetë një e vërtetë, edhe është një e vërtetë shkatërruese.

Meqenëse për të kushedi satën herë një rast si ky i Telekomit të Kosovës e konfirmon një fakt të pikëllueshëm shoqëror, ekonomik e politik për shoqëri si kjo jona. Se jo çdo gjë e ligjshme, është

edhe e drejtë, edhe korrekte për shoqërinë. Një zbulësë e tillë është sa brengosëse, aq edhe e tmerrshme. Meqenëse çdo banor i këtij vendi vazhdon të besojë që drejtësia as nuk arrihet e as nuk sigurohet me zbatim të ligjit. Se ligji qenka vetëm interpretim i pushtetit dhe askush që nuk është pjesë e pushtetit, nuk është i mbrojtur prej tij.

Sot rasti i Telekomit të Kosovës do ta dëshmojë se zbatimi i ligjit s'është tjetër pos vegël e pasurimit. Nëse nuk ekziston përgjegjësi ndaj shoqërisë, ndërgjegje ndaj vetvetes dhe vetëdije mbi shtetin. Përmes procedurave ligjore, Telekomit të Kosovës është themeluar, është zaptuar edhe është plaçkitur, kurse tash ligjërisht pritet të falimentohet dhe të privatizohet.

Megjithatë, përtej dënimit financiar dhe ekonomik, rrëfimi për fatin e kësaj kompanie do ta përbëjë njërin ndër leksionet më të rrezikshme për shoqërinë tonë, e që në thelb e vret përkushtimin për shtetin, për atdheun dhe për të ardhmen. Ai është leksioni mbi dallimin mes drejtësisë edhe ligjit. Andaj, çfarëdo që të jetë përfundimi i këtij tregimi të ndytë, të pafytyrë dhe të padrejtë ekonomik dhe politik, ai do ta vendosë edhe një gur të madh në themelet e bindjes shoqërore që vazhdon të rritet dita-ditës. Se drejtësia për qytetarin dhe shoqërinë, duhet të kërkohet matanë ligjit. Ju faleminderit!

**KRYESUESJA:** Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Milaim Zeka. Urdhëroni!

**MILAIM ZEKA:** Faleminderit, kryesuese!

E para, po e filloj me fjalimin e shefit të Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje, kur në fillim të fjalës së tij paraqiti akuza të rënda dhe shumë me vend ndaj Partisë Demokratike të Kosovës, por e harroi qëllimisht dhe e injoroi qëllimisht kreun e Lidhjes Demokratike të Kosovës.

Të bëhet një gjë e tillë përpara qytetarëve të Kosovës, është sikur të thuhet që këto ditë s'e kemi parë arushën e Prizrenit, herë në qytet, e herë në mal, kur arushën e kanë parë të gjithë qytetarët.

Krejt krimin ekonomik, në çdo ndërmarrje publike në Kosovë, e ka bërë LDK-ja me PDK-në. Bën PDK-ja, flladit LDK-ja. Krimi fillestar në Postë-Telekom të Kosovës ka filluar me Lidhjen Demokratike të Kosovës, në krye me zotin Ilir Salihu.

Ai e ka filluar krejt këtë marre, pastaj kanë ardhur marre të tjera me Etrur Rustemin. Me Adnan Merovcin. Me Shyqri Haxhën. Me Ejup Qerimin. Dhe, varrimin përfundimtar, varrosjen e Postë-Telekomit të Kosovës e ka varrosur banditi, kriminelin Agron Mustafa, i cili është arrestuar në aeroport për vepra penale. E ka shkatërruar aeroportin, e i cili në prezencën e komandantit të Policisë së Prishtinës ka rrahur femra nëpër restorante dhe as në pyetje nuk është marrë ky kriminel.

A e dini ju pse, qytetarë të nderuar? Sepse krerët politikë së pari kanë vendosur në krimet serioze ekonomike njerëzit e vet. E kanë vendosur Emin Beqirin. E kanë vendosur Nazim Sahitin. E kanë vendosur Avni Namanin. Që kanë qenë krejt struktura të Partisë Demokratike të Kosovës. Pastaj, në mënyrë që të bëhen të gjithë këta kapës, e kanë marrë edhe e kanë vendosur kryeprokuror të Shtetit Aleksandër Lumezin.

Të nderuar deputetë dhe qytetarë të Republikës së Kosovës,  
Dua t'ua them një fakt që do duhej të ishte shokues për çdo qytetar të thjeshtë. A e dini more ju, se Postë-Telekomi i Kosovës në nëntorin e vitit 2005 i ka dhënë, Albulenë, kredi Ipkos. I ka dhënë para, kredi, që të zhvillohet konkurenti i vet. I ka dhënë kredi në nëntor të 2005-ës. Dhe a e di, Albulenë, se kush ka qenë atje? Cili hajn ka qenë atje? Akani, jarani më i ngushtë i Hashim Thaçit e i Kadri Veselit. Ai Akani, ai picimuli që është bërë pastaj ambasador në Amerikë. Domethënë, këta e kanë bërë strukturën e krimit të organizuar.

A e dini ju, qytetarë të nderuar, që këta gjoksamanët e LDK-së, që rrahin gjoks, kanë shkuar dhe kanë dalë në foto me këtë kryekriminel. Ja ku i kam fotografitë këtu, ku shihen si gjynah, ja si rri si gjynah Isa Mustafa. Shikojeni këtu, është me Avdullah Hotin.

Kanë shkuar dhe e kanë përgëzuar Agron Mustafën. Dhe, ja ku e kam këtu një dokument tjetër. Shikojeni konkursin këtu, të shpallur më 29.3.2016 nga Agron Mustafa, ku thotë Vala kërkon 100 punëtorë të rinj. E pse s'i ndalen këta punësimet vend e pavend?

E pse këta nuk e hetuam Postë-Telekomin e Kosovës? Për çka nuk e bënë një gjë të tillë? Se kam thënë, në hajni të tenderëve, të parasë publike dhe në kurvëri krejt janë bashkë. S'ka këtu kurrfarë dallimi.

Albin Kurti përmendi diçka shumë esenciale, tha të sjellim ekspertë, drejtorë nga jashtë, që jam shumë dakord. Albin, këta që e kanë shkatërruar postën, të gjithë doktorë kanë qenë.

Po, ai zoti Kiçina që ju e përmendet, është nga njerëzit më të ndershëm në Postë-Telekom të Kosovës. Kot e sjell ti, sjelle djalin e Bill Klintonit në Postë-Telekom të Kosovës, kur t'i rrinë këta me shosha përmbi, krerët politikë, e kur ta thërrasin në tre të natës e ta shantazhojnë, i thonë, ne ta bëjmë aktakuzën. Ne të qesim se ti je hajn. Ne të qesim se ti ke dalë lakuriq diku në një hotel me një femër. Ai do të rrijë pastaj si pulë, sepse këta ta kurdisin. Një milion skenarë t'i bëjnë. Këta e tejkualuar fantazinë e Hiçkokut në krim të organizuar dhe në poshtërsi. Nuk kanë kurrfarë limitesh as të bandave më kriminale në Sicili atje. Edhe mafia italiane i ka disa kode. Këta i kanë kaluar, krejt kodet i kanë shkatërruar.

Pse Qeveria e Kosovës mund ta anulojë kontratën me Z-Mobile? Sepse unë, të nderuar deputetë, e kam një fakt në dorën time, të cilin ma ka dorëzuar dikush nga suedezët, që e përmendi Glauku me shumë të drejtë deklaratën e Shyqri Haxhës, që e ka dhënë ai hetuesi suedez. Shumë e saktë.

Unë i kam vetëm në 2010-ën, 4860 telefona të Z-Mobile që kanë vjedhur Sim to Sim. Do të thotë, në çdo dhjetë numra telefonikë, nëntë kanë qenë të Z-Mobile. Ekziston në kontratë një klauzolë, ku thuhet se në qoftë se vërtetohet një hajni e tillë, mund të shkëputet kontrata.

Ore, dëgjoni çfarë po ju them; po të isha kryeministër i këtij vendi, në 700 arbitrazhe sikur të shkohej, nesër ia kisha prerë me gërshtë kontratën e Z-Mobile dhe shumë kontrata të tjera. Po këta e vazhdojnë në gjë të tillë sepse, shikojeni ku e kam unë në procesverbal, mbledhja e Bordit, ku ai Gjonbalaj ka qenë nëna e krimit të organizuar. Nëna e krimit të organizuar. Mos harroni se krejt drejtorët që i përmenda janë 100% të PDK-së. Mirëpo, bordet i kanë pasur së bashku me LDK-në. Të gjitha bordet i kanë pasur bashkë.

A e dini ju se kush e ka kundërshtuar kontratën me Z-Mobile, në mbledhjen e bordit? Serbja. Anëtarja serbe dhe zonja Pireva. Imagjinoni, të gjithë të tjerët... Emri nuk më kujtohet, më falni. Elmaze Pireva ka qenë kundër, po them, edhe serbja.

Unë thashë se, ai djali i Fatmir Sejdiut nuk është i PDK-së. Bardhyli është nëna e krimit. Nëna e krimit. Besë, unë asgjë nuk po të them ty, se unë kur flas, flas me emra edhe nuk e përfshij LDK-në, se LDK-ja ka njerëz të ndershëm. Absolutisht.

Pjesën që e përmenda s'janë hiç në LDK, as Isa dhe as Avdullahu. Këta janë pjesë e Bujar Bukoshit, mos u prekni ju. Këta s'janë fare në LDK. Këta janë kësi parashutistë që kanë ardhur në LDK me parashutë dhe pastaj Zoti e di se ku do t'u shpërthejë parashuta këtyre njerëzve.

Po e përfundoj me diçka, ndryshe kisha folur rrafsh 10 orë këtu, kur dihet se çfarë di unë sa i përket krimeve për Postën.

Po jua them vetëm një listë që e kam renditur se kush e ka shkatërruar Postë-Telekomin e Kosovës, në mënyrë që edhe ambasadori britanik të mos na shesë shumë moral. Shkatërrues të parë të postës, e që e kanë zhdukur edhe grupin hetimor brendapërbrenda postës, janë Dejvin Gjefri, anglez. Është pastaj një zviceran, Tomas Melkuar. Pastaj vijnë: Ilir Salihu, Etrur Rrustemi, Adnan Merovci që është miks LDK-PDK, Shyqri Haxha, PDK, Ejup Qerimi, 'meshavinë', s'dihet çka është. Domethënë njeri me parashutë e i paguar nga Ipko që ka ardhur të shkatërrojë aty, dhe në fund, thashë, njeriu që ia ka bërë gropën me miratimin e krerëve të PDK-së është Agron Mustafa.



E gjitha që po e flasim ne këtu, vetëm po grijmë ujë në havan, sepse ky vend nuk do të kthehet për së mbari pa ardhur një prokurori i shtetit, i cili i arreston këta njerëz. Dhe, le ta dijë ky prokuror dhe shumë liderë politikë dhe shumë prokurorë e gjykatës të tjerë që heshtin para një krimi të tillë, që do të vijë dita që fëmijët tanë në vend të luleve të varri do të na sjellin bajga.

KRYESUESJA: Faleminderit, deputet! Fjalën e ka deputeti Arbër Rexhaj, pas deputetit Rexhaj, zoti Blerim Kuçi.

ARBËR REXHAJ: Të nderuar qytetarë,

Për të gjitha keqpërdorimet, hajnitë e krimin institucional në Telekom, nuk ka vepruar Prokuroria, sepse kemi një kryeprokuror pa aktakuza që ne këtë prokuror e kemi quajtur, pra 'kryeprokuror lepur'.

Ky prokuror ka pasur një letër, me të cilën është paralajmëruar qysh në vitin 2016 nga një njëri i respektuar dhe kompetent, Ismet Hamiti, e të cilin unë po dua ta lexoj për aq sa mundem.

'I nderuar prokuror i Shtetit,

Ju shkruaj për të paraqitur një krim kundër pasurisë dhe interesit publik. Përmes kontratës së PDK-së me Z-Mobile është krijuar një mekanizëm legal për plaçkitjen e pasurisë publike me përmasa të mëdha.

Ideatorë të secilës janë individë në nivelet më të larta të pushtetit zbatues, e që janë veglat e tyre në PTK dhe në institucionet e shtetit.

Zbatimin e nisën Etrur Rrustemaj dhe Ilir Salihu, me anëtarë të tjerë të Bordit. E licençoi Anton Berisha. E miratoi me shumë zell, Rexhë Gjonbalaj, me anëtarë të tjerë të Bordit. E nënshkroi Shyqri Haxha. E mbrojti Ahmet Shala. Heshti për të Agim Çeku dhe nuk vepruan shumë zyrtarë të tjerë që kishin dijeni për të, përfshirë edhe individë në sistemin e ndjekjes dhe atë të drejtësisë.

Dëmi që i është shkaktuar interesit publik me këtë kontratë është baras me të gjitha të hyrat e Z-Mobile që nga ekzistenca e kësaj kontrate e deri më sot dhe rritet për çdo ditë që kalon. Po të mos ekzistonte kjo kontratë, të gjitha këto të hyra do të ishin të PTK-së.

Sikur e gjithë kjo të mos mjaftonte, Ejup Qerimi dhe Rexhë Gjonbalaj inskenuan humbjen, në thonjëza, të arbitrazhit, me të cilën synojnë të plaçkitin edhe 30 milionë të tjera të pasurisë publike.

E gjitha kjo paraqet shembull shkollor të krimit të organizuar që për nga përmasat e dëmit të shkaktuar dhe numrit të individëve të përfshirë, është ndër më të mëdhenjtë në gjithë kohën e pasluftës.

1. Nismëtarët e zbatimit të krimit ishin drejtori i PTK-së i asaj kohe, Etrur Rrustemaj dhe Bordi i PTK-së, i përbërë nga: Ilir Salihu, kryetar dhe anëtar Jasper Dick, Enver Xharra, Patrik Rubin Van Der Lin, Edmond Hajrizi dhe Isak Krasniqi.

Këta individë janë përgjegjës për shpalljen e publikuar më 30 mars 2007, të titulluar: Mundësi atraktive për operatorët mobilë virtualë, me të cilën shprehej interesi i PTK-së për ndërmarrje të përbashkët me operatorët e mundshëm të rrjetave mobile vizuale.

Me këtë shpallje ata kërkonin operator virtual, i cili duke shfrytëzuar infrastrukturën e PTK-së për ndërmarrje të përbashkët me operator virtual, në njëfarë forme, me një fjalë, këta individë shpallën tender për t'i krijuar konkurrencë kompanisë që e drejtonin ata vetë dhe atë me pasurinë e vetë kompanisë. Rast ky i pashembullt në universin biznesor në botë.

Mund të dëshmohet lehtë se ky veprim ishte në dëm të PTK-së dhe të interesit publik. Prandaj, përbën një krim të rëndë. E nëse kësaj i shtohet fakti se me këtë veprim ata e kanë kryer pra me porosi dhe për interes të individëve të paracaktuar, i bën edhe ata pjesëtarë të një grupi më të gjerë kriminal.

2. Anton Berisha, kryetar i atëhershëm i Autoritetit Rregullator të Telekomunikacionit, është po ashtu pjesë e krimit, sepse jo vetëm që nuk i pengoi veprimet skajshmërisht të dëmshme për interesin publik, e që e kishte detyrë themelore, por shkeli çdo gjë që mund të shkelej dhe licenoi operatorin virtual të zgjedhur nga Bordi dhe menaxhmenti i PTK-së në bazë të shpalljes së datës 30 mars 2007.

Prandaj, si nënshkrues i licencës, ai është përgjegjës për plaçkitjen e pasurisë publike nëpërmjet Z-Mobile, e që vazhdon edhe kësaj dite.

3. Rexhë Gjonbalaj me anëtarët e tjerë të Bordit të përmendur më sipër, janë përgjegjës për miratimin e kontratës, kurse Shyqri Haxha ish-drejtor i PTK-së, janë përgjegjës për miratimin në bord dhe nënshkrimin e kontratës me Z-Mobile.

Dëmi që i është shkaktuar interesit publik me këtë kontratë është baras me të gjitha të hyrat e Z-Mobile, që nga ekzistenca e kësaj kontrate e deri më sot, që mund të dihet lehtë dhe rritet për çdo ditë që kalon.

Po të mos ekzistonte kjo kontratë, të gjitha këto të hyra do të ishin të PTK-së. Prandaj, këta individë, me miratimin dhe nënshkrimin e kësaj kontrate, kanë kryer krim të rëndë kundër pasurisë dhe interesit publik.

4. Ky krim kishte mbrojtës të zellshëm në pozita të larta zyrtare. Në mbledhjen e Parlamentit, pra të Kuvendit të Kosovës të datës 26 shkurt 2009, duke iu përgjigjur pyetjeve të përsëritura të disa deputetëve, ministri i atëhershëm i Ekonomisë dhe Financave Ahmet Shala, jo vetëm që e mashtroi Kuvendin që është në vetvete një veprim i dënueshëm, por ai edhe mbrojti me këmbëngulje kontratën me Dardafonin, më vonë të transmetuar pra në Z-Mobile, duke e kualifikuar atë marrëveshje si legjitime dhe të dobishme afariste.

Ky individ duhet që patjetër të shpjegojë sepse e bëri këtë në kohën kur nuk kishte njeri në këtë vend që nuk e kuptonte se kontrata e PTK-së me Dardafonin ishte kurdisur për individë të caktuar dhe skajshmërisht e dëmshme për interesin publik.

Ky zyrtar jo vetëm që nuk e pengoi, gjë që e kishte për detyrë, por ai edhe arsyetoi krimin në autoritetin më të lartë të vendit, në Kuvend. Prandaj, Ahmet Shala ka kryer krim për mospengimin dhe arsyetimin e këtij krimi dhe për këtë duhet të nxirret para drejtësisë.

5. Për përgatitjen e këtij krimi ishin të njoftuar me letrën time të datës 27 maj 2007, edhe OKB në Nju-Jork, zyrtarë kryesorë të UNMIK-ut në Prishtinë dhe kryeministri i atëhershëm i Kosovës, Agim Çeku.

Nuk jam në dijeni për asnjë formë të veprimit nga ana e tyre për ta penguar këtë krim. Do të ishte më se normale që Prokuroria të interesohej se pse Agim Çeku nuk e bëri për të cilën ishte paguar. Pse nuk e pengoi krimin, për të cilin ishte edhe kishte dijeni? Dhe, pse kishte mbrojtur krimin duke heshtur për të?

Me mosveprimin e tij, ai ka ndihmuar kryerjen e këtij krimi dhe duhet të konsiderohet pjesë e këtij grupi kriminal dhe të japë llogari para drejtësisë.

6. Edhe humbja në arbitrazh është skemë e ideuar në nivele më të larta të pushtetit, ndërsa zbatuesit janë Ejup Qerimi dhe Rexhë Gjonbalaj.

Në të vërtetë, kjo skemë nuk është aspak origjinale, sepse zbatohet për plaçkitjen e pronës publike gjithandej në vendet ku synon krimi e korrupsioni. Në këtë rast me këtë skemë synohet të plaçkiten edhe mbi 30 milionë euro të pasurisë publike, dhe ata individë që e kurdisën krejt këtë janë pjesë e të njëjtit grup kriminal.

7. Nuk ka asnjë dyshim se të gjithë këta individë dhe të tjerët që do t'i zbulojnë hetimet, sidomos ndër ata që ishin në bordet e PTK-së që nga viti 2007, e që nuk përmenden këtu, me veprimet e mosveprimet e veta kanë bërë krim.

Por, po ashtu nuk ka asnjë dyshim se të gjithë këta janë vegla të individëve në nivelet më të larta të pushtetit, e që janë kupola e këtij grupi kriminal. Prandaj ju drejtohem me respekt që të ndërmerrni krejt çka është e nevojshme që të ndërpritet plaçkitja e pasurisë publike e përmasave të mëdha që grupi kriminal që ideoi dhe zbatoi kontratën me Z-Mobile të silltet para drejtësisë”.

Unë qëllimisht këtë letër e kam zgjedhur për të treguar që në këtë vend nuk ka as prokurori, nuk ka as kryeprokuror, i cili është kryeprokuror pa aktakuza dhe ky vend është vend i kapur në aspektin e drejtësisë.

**KRYESUESJA:** Faleminderit, deputet! Fjalën e deputeti Belerim Kuçi, urdhëro!

**BLERIM KUÇI:** Faleminderit, kryesuese!

Po më vjen mirë që nuk jam menjëherë pas Milaim Zekës të flas, se nuk kisha ditur çka të flas, sepse tha gjithçka që ne nuk po e kem guximin ta themi. Unë të falënderoj, Milaim, shumë.

Po emëruesi i përbashkët po del për çdo deputet që gjendja aktuale në Postë është shumë e rëndë. Kush është përgjegjës? A janë ata që kanë nënshkruar kontratat e dëmshme, a janë menaxherët, a është keqmenaxhimi, a janë të dyja bashkë.

Dikush duhet të jetë përgjegjës dhe dikush duhet dhënë llogari.

Po ne i takojmë Kuvendit edhe unë jam deputet, sikur edhe ju, të nderuar kolegë. Ne si Kuvend e kemi bërë me një farë mënyre maksimumin tonë, sepse me propozimin e opozitës, po them jorastësisht, të opozitës është miratuar një rezolutë. Po ashtu ky Kuvend ka krijuar edhe Komisionin Hetues sa i përket Telekomit. Pra, ky është maksimumi institucional që mund të bëjë një Kuvend.

Për mua është ose nuk kam shpjegime të mjaftueshme ose është e pakuptimtë pse tash edhe një rezolutë tjetër, rezolutë mbi rezolutë.

Kryeministri i Republikës së Kosovës, për herë të parë dikush i përmendi 150 rezoluta ky Kuvend i ka miratuar, u mundua të japë sqarime pikë për pikë të zbatimit të një rezolute, përveç atyre që janë e pamundshme për shkak të përgjegjësisë ligjore, për ato të cilat ligji nuk na lë t’i zbatojmë. Unë nuk e di a është ashtu, po a falënderojmë kryeministrin që në përpikëri u mundua të 12 pikat t’i elaborojë e të thotë këtë e kemi bërë, këtë jemi në proces ose këtë do ta bëjmë. Domethënë për herë të parë e patëm një kryeministër, i cili vjen këtu para nesh dhe jep përgjegjësi ose bashkëharmonizon qëndrimet me ne.

Ne kemi krijuar një rezolutë, edhe Komision Hetues, tash po duam rezolutë mbi rezolutë. Atëherë po krijojmë edhe një Komision Hetues, i cili heton Komisionin Hetimor që ne e kemi

krijuar, jemi mësuar t' i duplifikojmë gjërat. Atëherë unë po propozoj të krijojmë edhe një Komision Hetues, i cili heton Komisionin Hetues që ky Kuvend ia ka dhënë miratimin për punën e vet.

Ajo që nuk e thanë ose ministri po, kryeministri pati krejtësisht një qasje të re, edhe për mua të re, në raport me Telekomin, nuk e pamë një plan, nuk e lyp askush një plan se çfarë do të jetë plani për të ardhmen e Postës.

Ministri, edhe pse kam respekt për ministrin, po sot foli “do të” , ajo “do të”, ministër, është fontanë dëshirash, një lloj iluzioni, është një thënie “Të gjithë kanë dëshirë të shkojnë në parajsë, po askush nuk ka dëshirë të vdesë”. Ti duhet marrë edhe përgjegjësinë, me ata aktorë që e kanë sjellë në këtë gjendje për të mundur të çelet rruga për të dalë prej kësaj gjendje.

Unë e kuptoj që as ti, as kryeministri, as menaxhmenti ekzistues nuk e ka lehtë mbi gjendjen ekzistuese të japë një perspektivë, po mundësia ekziston, në qoftë se vullneti është juaj.

Tash e tutje përgjegjësia është e kryeministrit dhe tash e tutje përgjegjësia është juaja, ministër, edhe e menaxhmentit ekzistues. Po e kaluara jo, ajo çka është me rëndësi e kaluara jo. Po assesi nuk do të mbajmë përgjegjës për gjendjen në Postë, jo të thuhet çdo herë e kanë prishur, po hajde ndreqe ti, jepe propozimin dhe ndreqe. Po nuk mund të ndreqet pa u marrë në përgjegjësi ata që e kanë sjellë në këtë gjendje. Faleminderit!

**KRYESUESJA:** Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Dardan Sejdiu. Urdhëroni!

**DARDAN SEJDIU:** Faleminderit, kryesuese!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

I nderuar ministër,

Në fakt, më 30 gusht të vitit 2012, para shtatë vjetësh kam shkruar një opinion në lidhje me Telekomin e Kosovës dhe e kam titulluar “Zhvlerësim deri në shitblerje”. Fatkeqësisht sot në maj të fitit 2019, shtatë vjet më vonë ky qëllim po duket që është realizuar.

Pra, Telekom i Kosovës është zhvlerësuar deri në masën ku fatkeqësisht privatizimi po dokumentohet, po argumentohet se është qëllim në vetvete dhe mjeti i përdorur është zhvlerësimi i ndërmarrjes Postë-Telekom i Kosovës, Telekom i Kosovës në këtë rast.

Ekonomia e Kosovës, i nderuar ministër dhe kryeministër në mungesë këtu, ka 19 vjet që është duke u rrënuar nga një model ekonomik, i cili sillet rreth dy të pavërtetave tepër të mëdha.

E pavërteta e parë për 19 vjet është që infrastruktura është e barabartë me asfalt.

E pavërteta e dytë e madhe për këto 20 vjet është që privatizimi i pronës publike sjell deri te zhvillimi ekonomik.

Pra, të dyja janë të pavërteta që, as më shumë e as më pak retorikë për qeveritë e deritashme, domethënë kjo ka qenë e vetmja retorikë deri më tash.

Dhe sot, ministër, fatkeqësisht ju na treguat tre hapat e domosdoshëm për privatizim dhe, në fakt, kjo nuk është asgjë e re.

Pra, në mungesë të një plani zhvillimor për sektorin e telekomit, ne prezantuam një plan të qartë për zhvlerësim për organizimin e shitblerjes të asaj që është vlerësuar. Rrallëherë mund të gjendet ndonjë proces ekonomik, i cili mund të gjykohet pa ndonjë provë empirike ose hulumtim të mirëfilltë.

Por, ja që procesi i privatizimit në Kosovë është i tillë, është i tillë, sepse nuk na duhet asnjë provë empirike, ministër, e asnjë hulumtim për të konkluduar që ky proces është gjithçka, përveç se i suksesshëm, në Republikën e Kosovës tash e 20 vite ne privatizojmë.

Pra, pronën publike e shndërrojmë në pronën private dhe me supozimin që kjo sjell investim, punësim, e mirëqenie e, në fakt, dy dekada më vonë ky proces nuk e ka sjellë asnjërin.

Nëse i shihni, e besoj që ju i shihni numrat në raportet e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës se kush janë investitorët më të mëdhenj në Republikën e Kosovës deri në vitin 2018, do të shohim se ata janë mërgimtarë tanë që blejnë banesa në Prishtinë apo në qytete të tjera. Pra, nuk ka të bëjë me investim në zhvillim.

Nuk po them këtu që privatizimi nuk mund të jetë i dobishëm, këtë nuk po e them. Por, ai është i dobishëm vetëm në raste kur ai shihet në kuadër të një strategjie të mirëfilltë zhvillimore, e këtu fatkeqësisht nuk po flasim për strategji zhvillimore, po flasim për privatizimin si qëllim në vetvete.

Pra, një organizatë financiare ndërkombëtare me plot respekt, BERZH, vjen e vlerëson, tregon cilët janë hapat për ta rikthyer pacientin në jetë, në këtë rast Telekomini dhe menjëherë të shitet, të hiqet qafe dhe jo të shfrytëzohet për ndonjë lloj ecje përpara.

Normalisht më duhet këtu patjetër të potencoj edhe mësimet që janë përdorur për privatizimin e ndërmarrjeve publike në Kosovë. Po më duket që mësimet i kemi nga ajo metoda e njoftuar që i kemi mësuar nëpër shkolla, nuk po flas në këtë rast për juve, ministër, po për qeveritë e 19 vjetëve të fundit, si duket aq me vëmendje e kanë lexuar këtë farë mënyre, sa që kanë bërë çdo send që ta zhvlerësojnë Telekomini deri në pikën që ajo mund të blihet me shumë pak para, edhe

kush më mirë se të bëjë zhvlerësime se ata që e menaxhojnë, në këtë rast Postën dhe Telekomin e Kosovës e kanë menaxhuar qeveritë me bordet e tyre partiake, e bordet e tyre partiake, me të emëruarit e tyre partiake, të cilët normalisht, nëse kjo informatë të cilën e dha sot një koleg deputet është e vërtetë, është shfrytëzuar edhe për manipulim të masave. Pra, diku rreth 2 milionë euro në vit, tha, janë shfrytëzuar vetëm për marketing. Këtë normalisht ju duheni vërtetuar, sepse keni qasje në informacion të plotë.

Pra, metodë e ngjashme në çdo aspekt, edhe financiar, edhe ligjor, sikurse ajo që njihet në botën e korporatave me blerjen nga menaxhmenti dhe kështu e shndërrojmë menaxherin në pronar, e kush është menaxheri, Qeveritë që kanë menaxhuar me Telekomin deri më tash.

Edhe një herë po e përsëris, 20 vjetët e fundit kanë qenë të tilla. Por, hajde ta analizojmë pak çka ka ndodhur në PTK saktësisht prej vitit 2008. Qeveria prej këtij viti me borde, me drejtor, me punësime partiake e parapartiake, me ndalimin e investimeve në PTK ka tentuar dhe në masë të madhe ka arritur ta zhvlerësojë Telekomin e Kosovës. Në një periudhë kohore i sillte deri në 60 milionë euro në vit, këtë e thanë edhe disa deputetë. Ndërsa tash jemi duke folur për larjen e një borxhi fiktiv apo, ashtu siç po e paraqitni ju, si mënyra e vetme për të mbijetuar Telekomi.

Po të ishte qëllimi të zhvillohej tregu i telekomunikacionit, do të kishte edhe liberalizim të tregut, sepse plot gojën liberalizim e kanë pasur në të kaluarën, por kemi përfunduar vetëm me një aktor tjetër në tregun e Telekomit.

Nejse edhe këtë të tretin në veri apo si, po vetëm një aktor është në treg të Telekomin tjetër, edhe ai është në pronë të një shteti tjetër. Po nuk kemi pasur liberalizim, po kemi privatizim pa liberalizim, apo diskutim për privatizim pa liberalizim dhe këtë e kemi parë edhe në KEDS, një monopol natyror e kemi përkthyer në një monopol natyror publik, e kemi kthye në një monopol natyror privat dhe, po e shohim se si ai monopol natyror po shndërrohet në një instrument për rritje të fitimit në kurriz të faturave të qytetarëve.

Fatkeqësisht ndërmarrje që duhet të jenë në funksion të pasurimit buxhetit, zhvillimit ekonomik e punësimit për qytetarë të kësaj Republike janë shndërruar në mjet për pasurimin e pushtetarëve në qeveri të ndryshme dhe këshilltarëve që paguhen pa fund deri sa të ndodhë shpronësimi i publikut. Normalisht, evidente, tash e 20 vjet me këto metoda nuk sigurojmë asgjë, përveç se pronësi private në asete publike, nacionalizim të humbjes e privatizim të fitimit.

Mua më duhet, ministër, t'ju përkujtoj që ndonëse prona publike në këtë vend shihet si një armik i madh, në shumë vende jo vetëm të Evropës, po edhe gjetiu, pronësia publike mbi ndërmarrje është përdorur për të ndërtuar vlerë e për të ecur përpara në zhvillim të teknologjisë.

Unë e kam të paqartë se si dikush që i ka 65% të tregut në Telekom, siç është rasti i Telekomit në Telefoni mobile, mund të gjenerojë të hyra më pak se dikush që i ka 30% të tregut, në këtë rast operatori IPKO, i cili është gjithashtu në pronësi të shtetit, siç e thashë.

Gjithashtu për mua është e paqartë pse nuk është lejuar investimi në kanale të tjera, apo në produkte e shërbime të tjera për Telekomin e Kosovës, pse vetëm një MVNO e kemi në Kosovë, pse nuk i kemi dy, funksionale së paku.

Dhe, normalisht, besoj që është tepër me rëndësi, ministër, që mos paragjykoni analizën e BERZH-it dhe konsulentëve, meqë i thoni konsulentit unë dua të të privatizoj, e vetmja terapi që do ta sjellë ajo është privatizimi, po nëse i thoni konsulentit ma trego rrugën se si mund ta forcoj Telekomin e Kosovës, si mund ta ristrukturoj, si mund ta kthej në gjendje ku i sjell buxhetit 60 milionë euro, besoj që këto kompani ndërkombëtare, për të cilat folët me aq lavd, do të sjellin edhe atë rrugë.

Pra, nëse ju i thoni që terapia që duhet të imponoj në Telekom është privatizimi, normalisht që atë terapi do ta sjellin, por nëse i thua që privatizimi nuk është qëllimi, por revitalizimi i ndërmarrjes është qëllimi, atëherë kushdo nga këto katër kompani me renome që i përmendët ju, përfshirë edhe BERZH-in si institucion financiar ndërkombëtar, do të bëjë atë, do të sjellë terapi, e cila Telekomin e revitalizon, e shndërron në aset të rëndësishëm të publikut dhe, normalisht që zhvillimi i sektorit të Telekomit, telekomunikacionit, do të jetë edhe më i mundshëm edhe më në dobi e në fitim të publikut.

Në këtë drejtim, ministër, besoj që ajo çka duhet të bëni është që t'i thoni, më tregoni si ristrukturohet për të qenë e suksesshme, e jo e privatizuar.

**KRYESUESJA:** Faleminderit, deputet! Fjalën e ka deputetja Arbërie Nagavci. Urdhëroni!

**ARBËRIE NAGAVCI:** Faleminderit, zonja nënkryetare!

Të nderuar qytetarë,

Deputetë, ju kaq sa jeni,

Prej dhjetorit të vitit të kaluar Z-Mobile ka filluar emetimin e pakove pa limit, të cilat po vazhdojnë ta shkatërrojnë edhe financiarisht, edhe në aspektin operacional Valën.

Është e njohur e njohur një thënie popullore, e cila thotë “Blej me pare, e shit pa pare”. Tani Z-Mobile po bën të kundërtën e kësaj, ka blerë pa para dhe po shtet me para. Pra, thënë shkurt e shqip, çdo e hyrë në Z-Mobile është humbje për Telekomin.



Pra, Telekomit po jep pa para të gjitha këtë që ka investuar, ndërkaq Z-Mobile po vazhdon të fitojë para duke shitur produkte me çmime sipas qejfit të vet dhe pa asnjë obligim e pa përfshirë koston e Valës në çmim.

U tha këtu se duhet pritur mendimi i ekspertëve, përpara se të vazhdohej tutje apo të merret ndonjë vendim në lidhje se si të vazhdohet tutje me Telekomin. Por është mirë të na thuhet se kush janë ata ekspertë, cilët janë emrat e tyre, sepse në secilin komision të ekspertëve të formuar deri më tani vendimi ka qenë gjithmonë në favor të Dardanet.net dhe në dëm të Telekomit.

E kur jemi te ekspertët, unë do të lexoj tani një letër të një eksperti, në fakt, ekspertit më me përvojë në telekomunikacion, ish-zyrtarit të Agjencisë së OKB-së për komunikimet elektronike, profesorit Ismet Hamiti.

Deputeti Arbër Rexhaj e lexoi letrën e parë pa zarf, të profesor Hamitit, i cili ka adresuar shumë herët shqetësimet e tij në lidhje me atë se çfarë po ndodhte në Telekom dhe unë do ta lexoj letrën e dytë, pa zarf, të adresuar kryeprokurorit të shtetit më 20. 12. 2017, në të cilën, për fat të keq, prapë nuk ka pasur reagim.

Kërkesë për veprime urgjente për të mbrojtur interesin publik.

Zoti kryeprokuror,

Prokuroria, në krye të së cilës jeni ju, nuk është e interesuar të hetojë krimin, të cilin e denoncova një vit më parë në letrën time të hapur drejtuar juve dhe të publikuar me titullin ‘Letër pa zarf’.

Në këtë u binda pas dëshmisë para prokurorit të Gjykatës Speciale javën e kaluar, gjatë së cilës kuptova se kjo Prokurori ka zgjedhur të merret jo me krimin në tërësinë e tij, por vetëm me një hallkë të krimi.

Kështu kanë vepruar të gjithë paraardhësit tuaj, të cilët janë marrë vetëm me një hallkë të këtij krimi, me synimin që edhe për atë hallkë keqbërësit të përfshirë të nxirren të pafajshëm, ashtu siç edhe u nxorën.

Gjatë dëshmisë u binda se është duke u zbatuar e njëjta recetë, tashmë e provuar nga paraardhësit tuaj për të nxjerrë të pafajshëm një grup tjetër keqbërësish, e për të lënë të qetë të gjithë të tjerët.

Për më tepër, gjatë dëshmisë së javës së kaluar konstatova se Prokuroria ka shkuar edhe më larg se paraardhësit tuaj. Ajo jo vetëm që synoi të amnistojë një grup keqbërësish të një hallke tjetër, por ajo synon amnistinë e të gjithë keqbërësve e hallkave të mëhershme të këtij krimi, me arsyetimin se na paska një vendim të plotfuqishëm në gjykatë për këtë rast.

Dhe se disa hallka të hershme të këtij krimi na qenkan të parashkruara, për shkak të kohës së gjatë që ka kaluar.

Zoti kryeprokuror,

Po bëhen gati 11 vjet që nga shfaqja e tij publike më 30 mars 2007, që në vazhdimësi jam duke paraqitur këtë krim zyrtarisht te organit komentet dhe publikisht kurdo që më është dhënë rasti. Askush nuk ka bërë asgjë, edhe pse ka qenë fare e lehtë për ta parandaluar.

Juve jua kam paraqitur para një viti, por vetëm tani pas një viti Prokuroria e gjeti të udhës të më ftoj të them diçka për këtë krim. Por, siç e thashë, jo për krimin në tërësi, por për një hallkë të vogël të tij.

Nga kallëzimi im i para një viti më parë tek ju, e i publikuar në shkrimin tim 'Letër pa zarf' i keni të gjitha hollësitë e këtij krimi, i keni individët, të cilët e kanë nisur dhe e kanë miratuar në bordet e njëpasnjëshme të PTK-së. E dini personin me emër dhe me mbiemër që e ka nënshkruar licencën në kundërshtim me ligjin, e dini personin që e ka nënshkruar kontratën, i keni zyrtarët e lartë që e kanë mbështetur këtë krim, qoftë duke mos bërë asgjë për ta penguar, qoftë duke arsyetuar atë në Kuvend. I keni të gjitha, në kallëzimin tim nuk janë vetëm emrat e individëve që qëndrojnë prapa këtij krimi, por ata i dini ju dhe i di i gjithë publiku ynë. Nëse nuk i dini, unë mund t'ju jap një ide se kush mund të jenë. Janë ata që me paratë e këtij krimi e lagin fytyrën kurdo që u thahet, blejnë vota kur kanë nevojë, blejnë deputetë në shitje, blejnë individë që u duhen për të kontrolluar çdo gjë në këtë vend, e tjera e tjera. E, paratë që kanë në dispozicion, janë shumë, janë më se 30% të të hyrave të Valës. Përkundër kësaj, përkundër faktit se ky është një shembull shkollor i një krimi të organizuar nga më të lehtit për t'u dëshmuar, përkundër faktit se ky krim vazhdon para syve tanë edhe në momentin që po i shkruaj këta rreshta, Prokuroria, në krye të së cilës jeni ju, gjen pretekst për të mos e hetuar krimin si të tillë, por merret me fragmente të tij për t'i amnistuar të gjithë individët e përfshirë në këtë krim, a në bllok arsyetimi se na paska një vendim të plotfuqishëm në gjykatë për këtë rast dhe se ky krim na qenka parashkruar, nuk e bind askënd.

Si mund të parashkruhet një krim, pasojat e të cilit janë në vazhdim. E dëmi që është duke iu shkaktuar interesit publik për shkak të këtij krimi është kolosal, prandaj ju drejtohem me respekt që: nën një, të suspendoni menjëherë dhe urgjentisht kontratën e PTK-së, përmes së cilës i plaçkitën fondet publike në përmasa të mëdha dhe të ndërmerrni krejt çka është e nevojshme për të hetuar krimin në tërësinë e tij që do të provonte se kjo kontratë është produkt i krimin të organizuar, ashtu siç është. Nuk është sekret, se pak kush beson se Prokuroria në krye të së cilës jeni ju, ka vullnet për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar. Ndërmarrja e veprimeve që jua sugjerova do të kthente sadopak besimin e humbur në Prokurorinë dhe në juve personalisht si kryeprokurorë”.

Ismet Hamiti, më 20.12.2017

Çdo fjalë e kësaj letre qëndron akoma edhe sot, jo vetëm se nuk është hetuar asgjë në këtë drejtim, por po vazhdon me të njëjtin avaz, andaj thirrja e profesor Hamitit drejtuar Kryeprokurorit të Shtetit vlen edhe si thirrje për të gjithë deputetët këtu që të jenë të kujdesshëm, të mos bëhen pjesë e këtij krimi dhe të mbështesin rezolutën e propozuar. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit, deputete! Fjalën e ka deputeti Rexhep Selimi, nuk është prezent. Deputeti Shemsi Sylja! Urdhëroni!

SHEMSI SYLA: Faleminderit, zonja kryesuese!

Të nderuar deputetë,

I nderuar ministër,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Në vorbullën e keqqueverisjes ka kohë që kanë hyrë edhe ndërmarrjet publike, ku përmes mashtrimeve, qeveria në bashkëveprim me oligarkët ka si synim falimentimin e tyre për t'ua shitur pastaj atyre që janë bërë palë me qeverinë.

Ndërkohë, oligarkët, përkatësisht kompanitë e tyre ua lagin fytyrën pushtetarëve sa herë i kanë ata të thara, dëshmia më e mirë për këtë është rasti i Telekomit, ku pas një vendimi të një arbitrazhi të jashtëm, Telekomit duhet t'ia paguajë qiramarrësit, të cilit ia lëshoi një pjesë të shtëpisë për pesë lekë, kompanisë Z-Mobile jo më pak se 32 milionë euro. Në vazhden e mashtrimeve të mëdha që bëhen në vendit nga qeveria, në bashkëpunim me oligarkët, e fundit pa dyshim se është afëra me Telekomin. Nga e gjithë kjo megaaferë buxheti i shtetit pritet të humbë 25 milionë e 900 mijë euro. Kush e di se si të përllogaritura ndaj kompanisë Z-Mobile të Blerim Devollit. Kurse, afati i pagesës rëndon si revolja e Z-Mobile mbi kokën e Telekomit, e gjyqësia e kapur në Kosovë ia siguroi legalitetin e vendimit të marrë në arbitrazhin e jashtëm. Afatin e pagesës Z-Mobile e vendos dhe e lëviz prapë si fajdexhiu vadën, çdoherë duke përfituar edhe diçka, e borxhi mbetet i njëjtë, edhe tek fajdeja e radhës. Ministria e linjës, në vend se të kishte shkëputur me kohë këtë kontratë, siç kërkon rezoluta e 12 korrikut 2018, inskenon takime në mes të Telekomit e Z-Mobile në stilin e Mogerinit. Në takimin e fundit afati i pagesës së pretenduar të Z-Mobile nga Telekomit u shty për 15 qershor, fiks 45 ditë para se kontrata e Telekomit me Z-Mobile të mbarojë. Skenari i denjë për filma me fajdexhinj, kjo ministri, e kjo qeveri kanë plane afatshkurtra e plot opsione për privatizim të Telekomit e ngopjen e orekseve oligarkike, e kur vjen puna te sanimi i gjendjes në këtë kompani publike, planet i kanë tremujore deri në 3-vjeçare.

Shkrimtari i njohur francez Honore de Balzak thoshte se 'prapa çdo pasurie të madhe fshihet një krim i madh'. Kështu ka ndodhur edhe në Kosovë, Devollët janë shndërruar në oligarkë të Kosovës, kanë krijuar monopol në shumë fusha dhe janë pasuruar shumë, por sa më e madhe që bëhet pasuria e tyre, aq më i madh po bëhet edhe krimi shtetëror. Fatkeqësisht, Qeveria dhe Telekomit kanë pak kohë për të gjetur një alternativë për ta dorëzuar pagesën, afati për milionat përfundon pak ditë para kryerjes së kontratës, e kjo po shihet si shantazh për vazhdim të saj. E

gjithë kjo telenovelë është e fabrikuar brenda zyrave të Qeverisë, që pastaj të ndajnë përfitimin së bashku. Me qëllim nuk janë përmbushur kushtet në kontratë që kishte Telekomit me Z-Mobile që të hidhet në gjyq dhe pastaj të ndajë përfitimet së bashku. Nga e gjithë kjo humbës del vetëm qytetari i ndershëm i vendit, i cili nga xhepi i tij i varfër duhet të paguajë për marrëveshjet e fshehura të Qeverisë me oligarkët. Kjo është vetëm njëra ndër dështimet e shumta të shtetit karshi mosrespektimit të kontratave, e të cilat i kanë sjellë buxhetit humbje të mëdha.

Të nderuar deputetë,

Po të mos ishte rasti kur Qeveria ia dhuroi 53 milionë euro Bechtel&Enkës, se a i takon Telekomit Qeverinë aktuale nuk do të mund ta bënim fajtor për situatën e krijuar në Telekom, por rasti me Bechtel&Enkën është një rast krejt tjetër që nuk mund dot ta bënim fajtorë, meqenëse në atë rast ishte përfunduar një kontratë tjetër.

Të nderuar deputetë,

Telekomit nga një aset me vlerë 2 miliardë euro, tani ndodhet në prag të shkatërrimit si pasojë e mosmbrojtjes nga shteti, i cili i ka lënë në dorë të oligarkëve të saj asetet më të mëdha të vendit dhe tash një aset publik që kishte një vlerë prej 2 miliardë euro, nëse sot fillon procedura e shitjes apo privatizimit, nuk mund të arrijë vlerë më të madhe se 100 milionë euro, edhe atë duke përfshirë 32 apo 26 milionë që po i kërkohen Z-Mobile. Faleminderit!

**KRYESUESJA:** Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Sami Kurteshi, urdhëroni!

**SAMI KURTESHI:** Faleminderit, zonja kryesuese për fjalën e dhënë!

Të nderuara kolege dhe kolegë deputetë, këta që keni mbetur këtu,

Ne dëgjuam sot gati tërë storien dhe, si duket ende nuk është zbuluar në tërësi historia e tragjedisë së ndërmarrjes publike Posta, tash e ndarë në Vala, Telekomit, sido që të jetë.

Kolegët dhe koleget prekën shumë gjëra, disa u mohuan, disa u pohuan, mirëpo asnjë person këtu, përfshirë edhe vetë ministrin, po edhe kryeministrin, nuk e mohoi se gjendja e krijuar në Telekom është jashtëzakonisht e rëndë. Nuk është e rastësishme, këtu u dëgjuan shumë argumente, shumë fakte nga ana e politikës, domethënë është krim i organizuar, ka krim të organizuar, është fakt.

Një, vërehet që nga viti 2008, 2009 kur siç duket ka filluar kjo kapja e Telekomit nga politika përmes një kompanie të quajtur Dardafone, “Dardafone. net, Z-Mobile, ka shënuar një vijë rënëse lineare, do të thotë, prej lart-poshtë, kurrë pa ndonjë këndellje. Mirëpo, krejt këto në të vërtetë janë pjesë e aspektit ekonomik që i përmendën, i përmendën edhe më mirë se unë, unë do të ndalem te aspekti i drejtësisë për të dëshmuar se krejt kjo klasë politike, jo që një vit, dy vjet, jo vetëm në këtë qeveri, por të gjitha qeveritë që kanë qenë të involvuara ose kanë qenë në pushtet prej asaj kohe, në të vërtetë e kanë luajtur të njëjtin rol dhe roli ka qenë i vjedhjes së

hapur të Telekomit përmes formave më të ndryshme. Po, unë do të ndalem te kapja e drejtësisë në Kosovë, ngufatja e drejtësisë në Kosovë nga të gjitha këto pushtete. Ne e kemi një lidhje të një kontrate të Telekomit me Z-Mobile, me Dardafonin dhe Dardafone. net. Dy kompani të ndryshme, mua po më dalin këtu që janë biznese të ndryshme me numra të ndryshëm të biznesit. Kjo ka qenë një arsye për shkëputjen menjëherë të kontratës. Arsyeja tjetër ka qenë keqpërdorimi që është vërtetuar edhe nga Monaco, me këtë lojën Sim to Sim që sigurisht profesionistët e njohin shumë më mirë.

Po ajo që është më e dhimbshme dëshmon domethënë se jo që s'kemi prokurorë, vërtet ky prokuror, po edhe kryeprokurorët e kaluar kanë qenë lepuj, disa me bisht e disa pa bisht, disa të shkurtuar nga politika, e disa të hequr edhe nga pushtetet e mëparshme e të lëmuar nga kjo politika tash, sepse i kanë shantazhuar më lehtë. Po unë po habitem, e s'duhet habitur në të vërtetë, me gjyqësorin tonë. Unë po e përmend një absurd që ngjan vetëm në të ashtuquajturën Republikë e Kosovës, ku politika i ka duart, ani ministër, ik, se mirë është, se s'dihet çka do të ngjajë pas disa vjetëve me gjykatën, ku politika i ka futur duart në gjyqësor. Po jua përmend vetëm një rast sa për krahasim. Këtu unë e kam vendimin e Gjykatës Themelore dhe të Apelit në lidhje me aktvendimin për plotfuqishmërinë e Vendimit të Gjykatës së Arbitrazhit. Dëgjoni tash çka ka ngjarë: më 16 korrik 2018, Dardafon.net ka paraqitur propozim për ekzekutim, edhe më 11.02. domethënë veç më pak se shtatë muaj, Gjykata e Kosovës nxjerr aktvendim. Është e ditur se në Republikën e Kosovës mesatarja e vendimeve gjyqësore është 8.5 vjet, këtu vetëm shtatë muaj. Kjo tregon se sa politike dhe sa e kapur është kjo gjykatë, mandej thonë, mos përmend emra se është përzjerje në drejtësi, jo nuk është. Ky zotëria që e ka një emër dhe një mbiemër ky, ky zoti gjykatësi, e ka nxjerrë një vendim me një peshë kaq të madhe që është diku rreth 30 milionë euro, në kohë rekorde, për shtatë muaj.

Për t'ju treguar se a është ky paradoks i madh, unë po e përmend një rast tjetër të ngjashëm që ka të bëjë me kompensimin e rreth 1 mijë punëtorëve, me vendime të plotfuqishme të gjykatave të Republikës së Kosovës, edhe ajo është rasti i Fabrikës së Tubave në Ferizaj. Gjykata Komunale e Ferizajt ka marrë vendim për ekzekutimin e Vendimit në vitin 2005, tani është viti 2019, rreth 15 vjet edhe pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese në vitin 2010 këta punëtorë nuk kompensohen. Nga këto gjykata që janë jo të kapura, janë të ngufatura, janë kriminale, se për Prokurorinë folën mjaft. I kemi rreth 1 mijë punëtorë, të cilëve gjykatat me radhë, prej shkallës më të ulët deri në shkallën më të lartë u kanë dhënë të drejtë, kanë nxjerrë vendime për ekzekutim, nuk ekzekutohet, e një gjykatës i Gjykatës Themelore në Prishtinë me një mbiemër Paçarada, e nxjerr një vendim në kohë rekorde për shtatë muaj, Z-Mobile t'i kompensohet gjoja një dëm që është nxjerrë me vendime kriminale, me manipulime kriminale të qarqeve të ndryshme pushtetore për ta dëmtuar ndërmarrjen publike Telekomit. Ky është absurdi jo vetëm politik, po absurdi i drejtësisë në Republikën e Kosovës, prandaj qytetarët e Republikës së Kosovës nuk besojnë në këtë drejtësi, sepse kjo është një drejtësi e hapur, tani na erdhi edhe kryeministri.

Në vitin 2018, me gjasë kryeministri ka dërguar një letër Gjykatës Kushtetuese për të parë çështjen e punëtorëve të Fabrikës së Tubave në Ferizaj, edhe çështjen e kompensimit. Me gjasë asnjëherë nuk është bërë transparente çka ka ngjarë në këtë mes. Zoti kryeministër, a bën të na tregosh pasi erdhe këtu, se unë s'e dita që vjen, çka po ngjet dhe çka ka ngjarë me vendimet e plotfuqishme të Gjykatës Komunale dhe të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës për kompensimin e punëtorëve të Fabrikës së Tubave në Ferizaj, vendimi është i ekzekutueshëm, pse kjo ngutje në rastin e Z-Mobile brenda shtatë muajve që të paguhet një dënim që ia paska dhënë Gjykata e Arbitrazhit dhe pse nuk po vlen e njëjta masë dhe e njëjta shpejtësi për rreth 1 mijë punëtorë, 912 punëtorë të Fabrikës së Tubave në Ferizaj. Faleminderit!

**KRYESUESJA:** Faleminderit! I kemi edhe tre deputetë që kanë kërkuar fjalën: Rexhep Selimi, Safete Hadërgjonaj dhe Fitore Pacolli Dalipi. Urdhëroni, Rexhep Selimi!

**REXHEP SELIMI:** Faleminderit, e nderuar nënkryetare!

Unë në fakt nga kjo foltore tash jam i detyruar t'ju drejtohem kolegëve të mi të Lëvizjes Vetëvendosje dhe qytetarëve, në mungesë të shumicës së mazhorancës dhe dy deputetëve të mazhorancës në Kuvend.

Nuk duhet të defokusohe mi nga qëllimi i kësaj seance, sepse po u defokusuam nga qëllimi i kësaj seance, ne bëjmë atë çfarë do të donte mazhoranca. Pra, seanca e sotshme është thirrur për një kontratë të veçantë dhe për gjithë aferën rreth kësaj kontrate që ka të bëjë me kontratën e Telekomit me Z-Mobile. Dhe tendenca për t'u shpërqendruar nga fokusi i kësaj seance është një tendencë për ta mbuluar skandalin apo krimin që ka ndodhur përmes këtij skandali në relacionin e Telekomit me Z-Mobile.

Pse sot ne po mbajmë seancë? Ne po mbajmë seancë në mungesë të dy veprimeve. Pra, po mbajmë sot seancë në mungesë të veprimeve që do të duhej t'i bënin qeveritë në vazhdimësi, duke mos e përjashtuar edhe Qeverinë aktuale dhe, po ashtu, në mungesë të transparencës, sepse po të ishte transparente kjo kontratë, atëherë ne shumë më pak do të kishim hapësirë për të diskutuar për këtë.

Por, qëllimi ynë është që ta bëjmë Qeverinë të veprojë menjëherë dhe po ashtu, t'ua bëjmë me dije qytetarëve se çfarë në të vërtetë ka ndodhur me këtë kontratë tashmë e cilësuar si një kontratë kriminele. Kontrata e Telekomit me Z-Mobilin është pra një kontratë, e cila ka bashkuar ndërmarrës në një vepër të caktuar kriminele, që e bën këtë të ketë dimensionet e një krimi të organizuar. Por, efektet e kësaj kontrate janë në tri dimensione, por jo të kufizuar vetëm në to, që kanë të bëjnë, pra kanë efekt të drejtpërdrejtë buxhetor apo financiar. Efekti i dytë është efekt që dëmton qytetarin dhe e treta, është që dëmton shtetin. Në këtë të tretën nuk mund ta përjashtojmë as efektin që kjo në sigurinë kombëtare, sepse rrjeti i Telekomit është sistem nervor i një shteti, në këtë rast, pra Telekomit është i tillë.

Në aspektin e sigurisë Telekomit është infrastrukturë strategjike. Ne kemi edhe ligje të veçanta për infrastrukturën strategjike. Në rastin konkret, atëherë del se kjo kontratë e tillë e dëmshme, efektin e dëmit e ka edhe në infrastrukturën strategjike kombëtare, saktësisht në sigurinë e shtetit të Kosovës. Kur rrezikohet Telekomit, atëherë rrezikohet edhe infrastruktura, pra e tij, që është infrastrukturë strategjike, e rrezikohet edhe siguria e vendit, sepse siç dihet, shumë institucione vitale, e sidomos ato të sigurisë në Kosovë, këtë rrjet e kanë pjesë të veprimtarisë së vet. Pra, të mos harrojmë institucione të sigurisë në Kosovë kanë si mjet të veprimit edhe rrjetin e Telekomit, duke përfshirë gjithë atë çfarë ofron Telekomit në këtë rast dhe eventualisht rënia e këtij rrjeti, rënia e këtij sistemi është edhe rënie e punës së këtyre institucioneve, sidomos ato të sigurisë dhe të inteligjencës.

Por, Telekomit në raste të këtilla do të duhej ta kishte mbrojtjen e Qeverisë, pra mbrojtjen nga shteti, edhe në aspektin financiar, sidomos kur bëhet fjalë për mirëmbajtje. Vala është operatori i vetëm në botë që nuk ka as përkrahjen e prodhuesit të sistemeve me të cilat vepron. Për ata që e dinë çfarë është kjo, mendoj se tingëllon shumë më qartë. Për ne që nuk jemi të kësaj fushe, normalisht se është dashur t'i mësojmë e mësimi nganjëherë është edhe në forma të tilla. Pra, Vala vazhdon të jetë operator i Monakos, pra monakez, ku Monako në këtë rast përfiton nga Kosova, nga qytetarët e Kosovës, nga xhepat e këtyre qytetarëve rreth 6 milionë euro në vit.

Unë nuk jam profesionist i fushës së Telekomit, rrjedhimisht nuk mund të flas me kompetencë në aspektin profesional, por situata në të cilën jemi sot, nuk do shumë mend që t'i kuptojmë përmasat e krimit të kësaj kontrate.

Pati diskutime sot, ndoshta edhe të pritshme, sepse siç thashë edhe në fillim, mazhoranca në këtë rast, për fat të keq, nuk e di pse, por u mundua të na shpërqendrojë nga fokusi kryesor, madje u përmendën shpeshherë edhe të punësuarit në këtë institucion. Thua se vetë sindikalistët nuk janë të punësuar në këtë institucion. Po a bën t'i dëgjoni njëherë këta të punësuar, ose përfaqësuesit e këtyre të punësuarve, të cilëve sot nuk u mundësua të jenë pjesë e këtij auditi. Kështu që, nëse përmendni të punësuarit, atëherë mua po më duket njëfarë kërcënimi i drejtpërdrejtë i atyre që janë të punësuar që ta mbyllin gojën, ose në këtë rast edhe Sindikatës, por ne prapëseprapë insistojmë që ne duam të nxjerrim para përgjegjësisë ata të cilët e kanë nënshkruar këtë kontratë të dëmshme. Cilido i punësuar në cilindo nivel që të ketë një përgjegjësi të tillë, atëherë ne nuk do të duhej ta kursenim.

Kështu që, nuk e kuptoj ndoshta edhe mosprezencën e pjesës më të madhe të mazhorancës në këtë seancë. Por, sido që të jetë, qytetarët duhet ta dinë se ne, as si deputetë, pra si parlamentarë, e as si Lëvizje Vetëvendosje, kurrë, ama kurrë, nuk do të heshtim para cilitdo krim, e sidomos krimeve me përmasa të këtilla. Sot, për ata që do të donin ta mbyllnim këtë temë, le ta dinë se veç sa është hapur kjo temë. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit! Fjalën e ka deputetja Safete Hadërgjonaj. Urdhëroni!

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, nënkryetare!

I nderuar kryeministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Sot, ne sikur kemi bërë edhe disa herë të tjera debate të natyrave të tilla krejt kot.

Sot, po them që po bëhet një seancë krejt koti, vetëm sa për të përfituar te punonjësit me ndonjë votë, te punonjësit e këtij institucioni dhe kjo është gjëja më e keqe që mund të bëhet sot për Telekomin dhe në përgjithësi për Postën e Kosovës. Kjo seancë po bëhet sa për të shpifur, për të futur frikë e për të abuzuar me emra njerëzish e për të futur frikë edhe për të punësuarit aty, se çka po ndodh në këtë institucion.

Në Kuvend është formuar një Komision Hetimor, pse nuk po ia mundësojmë këtij komisioni që ta kryejë punën e vet, pa interferime politike, por ta kryejë punën ashtu siç duhet dhe t'i nxjerrë të vërtetat në sipërfaqe dhe pastaj, pas të gjeturave që do të vijnë nga ky Komision Hetimor, ne të bëjmë një debat. Por, të debatojmë në drejtim të gjetjes së zgjidhjes për këtë institucion të rëndësishëm në vendin tonë, për të krijuar mundësi pune aty dhe stabilitet për institucionin dhe të punësuarit në këtë institucion. Të analizojmë me kujdes të gjitha rekomandimet që janë dhënë edhe nga ekspertët vendorë dhe ndërkombëtarë, në mënyrë që të vihet deri te mbrojtja e këtij institucioni, që është me interes publik.

As Telekomit, as të punësuarit, nuk kanë nevojë për debate koti, por kanë nevojë për të gjetur zgjidhje. Zhvatësit e Telekomit, për fat të keq, janë në të gjitha subjektet politike, dikush më shumë e dikush më pak. Kjo është për të ardhur keq që ka ndodhur një gjë e tillë, por unë vërtet dua të bëhen hulumtime të mirëfillta aty dhe kushdo që ka abuzuar, ta marrë dënimin që e meriton. Për mua ishte shumë i befasishtë diskutimi i zonjës Gaxherri. Akuza te të tjerët, pa e kthyer kokën kah vetvetja, nuk i bëjnë interes shoqërisë sonë. Ajo ka punuar aty dhe ka qenë pjesë e abuzimit personal dhe politik në Postë-Telekomit e Kosovës, kur ka qenë atëherë.

Ajo ka qenë menaxhere aty dhe ka menaxhuar me 1/3-ën e Postë-Telekomit të Kosovës, ka përfshirë një sipërfaqe 1/3-ën e menaxhimit në këtë institucion. Ka mbajtur për vite të tëra punën në Postë-Telekomit e Kosovës, duke qenë njëkohësisht edhe deputete në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Ka shfrytëzuar pozitën e të qenit deputete për të politizuar me Postë-Telekomit e Kosovës, atëherë për interesa të Lidhjes Demokratike të Kosovës, por edhe ka shfrytëzuar pajisjet e këtij institucioni për interesa personale. Tash, sigurisht e ka ruajtur vendin e punës aty, që një ditë të kthehet dhe të shkojë e të punojë bashkë me ata punëtorë, të cilët i streson sot me gjithë atë diskutim vulgar në lidhje me atë se çfarë po ndodh aty, dhe gjithë kjo bëhet me qëllim që t'u dalë në mbrojtje abuzimeve që i ka bërë Lidhja Demokratike e Kosovës në këtë institucion dhe i hedh akuzat te të tjerët, pa kurrfarë baze dhe pa kurrfarë dëshmie konkrete.



Sot, Telekomit dhe të punësuarit aty kanë nevojë për qasje pozitive tonën në drejtim të zgjidhjes së problemeve të shumta, me të cilat po përballet ky institucion. Ne mund ta bëjmë këtë bashkë me shumë ekspertë vendorë dhe ndërkombëtarë për të gjetur zgjidhje në interesin publik dhe në interes të institucionit dhe të të punësuarve. Faleminderit!

**KRYESUESJA:** Faleminderit! Fjalën e ka deputetja Fitore Pacolli Dalipi. Urdhëroni!

**FITORE PACOLLI DALIPI:** Të nderuar qytetarë të Kosovës,

Unë sot po flas në emër të punëtorëve të Telekomit të Kosovës, pasi që kryetari i Kuvendit nuk ka lejuar që përfaqësuesi i Federatës Sindikale të Punëtorëve të Postë- Telekomit të Kosovës të vijë në këtë Kuvend dhe të tregojë se çfarë në të vërtetë ka ndodhur dhe po ndodh në Telekomin e Kosovës.

Pra, ndër faktorët kryesorë që kanë renditur përfaqësuesit e punëtorëve të Telekomit, të cilët kanë sjellë Telekomin në këtë gjendje janë:

#### 1. Kontrata korruptive me Z-Mobile.

Në kohën e lulëzimit të të hyrave financiare, në periudhën 1999 - 2007 Telekomit të Kosovës iu krijua operatori virtual i njohur me emrin komercial Z-Mobile. Që nga janari i vitit 2009, kur filloi së operuari Z-Mobile, filloi zhvatja e buxhetit në kanale tjera. Zhvatja nga Z-Mobile vazhdon edhe sot e tutje, si me vendimin e arbitrazhit, por edhe me marrëveshjen interne ndërmjet Telekomit të Kosovës dhe Z-Mobile të datës 24 maj 2017, të nënshkruar nga ish-drejtori Agron Mustafa, pa aprovim të Bordit.

Pasojat e drejtpërdrejta financiare të zbatimit të kësaj marrëveshjeje interne të 24 majit të vitit 2017 për Telekomin e Kosovës do të jenë: humbja e 100 mijë klientëve shtesë, që i bie 300 mijë klientë në total, përkatësisht rreth 30% e klientëve të Telekomit në total. Sikur këta 300 mijë klientë të shpenzonin vetëm nga 2 euro në muaj, për gjashtë vjet kjo shumë arrin 43,2 milionë euro fitim për Telekomin e Kosovës. Pra, mbi 11,2 milionë euro më shumë se sa shuma e përcaktuar nga arbitrazhi, e që gjoja i është falur Telekomit të Kosovës.

Megjithatë, kalkulimi që mbështetet në vlera reale, pra jo të supozuara, është ky: numri i klientëve prej 300 mijë paraqet rreth 30% të klientëve që ka aktualisht Vala. Të dhënat e fundit financiare tregojnë se të hyrat e Valës janë rreth 70 milionë euro në vit. 30% të 70 milionëve janë 21 milionë euro, e që për gjashtë vjet bëjnë 126 milionë euro humbje për Telekomin e Kosovës. Kjo i bie se Telekomit i Kosovës ka humbur rreth 126 milionë më shumë se sa shuma e përcaktuar nga arbitrazhi.

Kjo marrëveshje nuk ishte bërë për ta shpëtuar Telekomin e Kosovës, siç po paraqitet në publik, por për ta rrënuar përfundimisht. Procesi në Gjykatën Themelore për ekzekutimin e 30 milionë

eurove shfaq prapavijat e marrëveshjes kriminele të grupeve që po zhvatin Telekomit e Kosovës. Përfundimisht, humbjet e përlogaritura nga ekspertë të pavarur prej fillimit të vitit 2009 e deri më tani nga kontrata me Z-Mobile janë rreth 110 milionë euro. Pra, nga viti 2009 e deri më sot Telekomit të Kosovës i janë shkaktuar humbje rreth 110 milionë euro. Prandaj, kërkojmë të merren masa ndaj personave përgjegjës për nënshkrimin e dëmshëm të kësaj marrëveshjeje. Shfuqizimin e kontratës me Z-Mobile për 300 mijë numra dhe kthimin e këtyre klientëve të Telekomit të Kosovës. Të kërkojen dëshmitë në Arkivin e Telekomit të Kosovës dhe të thirren në përgjegjësi personat aktualë që ende vazhdojnë në emër të këtyre marrëveshjeve ta dëmtojnë Telekomit me shuma marramendëse.

## 2. Dukuria SIM to SIM.

Zhvatja e të hyrave të Telekomit nga dukuria SIM to SIM, vetëm sipas raportit të Policisë, kalojnë vlerën mbi 1 milion euro, kurse dëmi i shkaktuar për kryerjen e këtyre veprave penale llogaritet të jetë 450 mijë euro në muaj, që do të thotë për katër vjet 21,6 milionë euro dhe kjo dukuri është kryer edhe nga njerëz të afërm me pushtetin dhe menaxhmentin e Telekomit të Kosovës.

Sipas informatave të Policisë së Kosovës, në mesin e të arrestuarve për zhvatjen e buxhetit nga aferat kriminele SIM to SIM janë edhe familjarë të menaxhmentin të kaluar dhe të tashëm të Telekomit të Kosovës.

## 3. Projektet kapitale të bllokuara nga Qeveria në emër të privatizimit.

Projektet kapitale që janë bllokuar nga Qeveria në vitin 2009 me arsyetimin se është shpallur tenderi për privatizim, që nga ajo ditë ende nuk është kthyer volumi i punëve, siç ishte paraparë në biznes-planin e kompanisë.

## 4. Mospërkrahja nga ARKEP-i.

ARKEP-i dhe prokurimi publik gjithmonë kanë qenë dhe janë në disfavor të kompanisë sonë, duke i favorizuar operatorët privatë. ARKEP-i ka treguar neglizhencë ndaj Telekomit të Kosovës në zhvillimin e tij, ku gjatë kësaj periudhe zoti Ekrem Hoxha, njeriu i cili ka qenë drejtor në Devolli Group, ka bërë kërkesë për licencë në ARKEP për MVNO dhe për bashkëpunim me Telekomit dhe po i njëjti person pas një muaji është bërë drejtor i ARKEP-it dhe i njëjti ka aprovuar kërkesën që vetë ka aplikuar për MVNO.

## 5. Rrjeti i njerëzve të njëjtë të instaluar në të gjitha nivelet më të larta udhëheqëse të Telekomit.

Gjatë kësaj periudhe kohore vazhdimisht njerëzit e njëjtë, si në Bord të Telekomit, ashtu edhe të menaxhmentin, kanë vazhduar të jenë në pozita të njëjta, duke kontribuar kështu në dëmtimin e kompanisë. Për shembull, zoti Rexhë Gjonbalaj për dhjetë vjet mbetet kryetar i Bordit të Telekomit të Kosovës.

#### 6. Prokurimi i Telekomit.

Është tepër e rëndësishme për ju të jeni të informuar se prokurimi i Telekomit në bashkëpunim me rrjetin e brendshëm dhe të jashtëm u janë dhënë dhe vazhdojnë t'u japin tenderë kompanive të jashtme edhe për punë elementare, që duhet dhe mund t'i kryejnë vetë punëtorët e Telekomit.

#### 7. Auditimi i brendshëm.

Drejtori i auditimit të brendshëm është zgjedhur në vitin 2009 dhe për dhjetë vjet asnjëherë nuk ka raportuar dëmet, por i ka fshehur ato. I njëjti është vëllai i deputetit të Kuvendit të Kosovës nga Partia Demokratike e Kosovës.

#### 8. Punësimet e militantëve.

Punësimet të militantëve pa përvojë dhe kualifikime përkatëse në pozita të larta, vetëm e vetëm për t'i mbrojtur interesat personale dhe të grupeve zvatëse të përmendura më lart, duke mos i vënë në plan të parë asnjëherë interesat e kompanisë. Si pasojë, janë punësuar mbi 1500 militantë të partive politike nga viti 2009 – 2019, e që po vazhdojnë edhe tani.

#### 9. Mosmarrëveshja e shërbimeve të Telekomit nga institucionet publike dhe ato ndërkombëtare.

Ministritë dhe komunat shumica nuk i shfrytëzojnë shërbimet e Telekomit, edhe pse Qeveria është aksionare 100%, kur dihet si Ligji i prokurimit publik e lejon që shërbimet e ndërmarrjeve shtetërore të japin edhe pa tenderë. Kjo i ka favorizuar operatorët e telefonisë mobile private, mungesa e menaxhimit profesional për nevojat dhe kërkesat e stafit ndërkombëtar për shërbimet nga Vala ka bërë që edhe KFOR-i dhe EULEX-i të mos i shfrytëzojnë shërbimet tona.

Të dashur qytetarë,

Të gjitha këto dëme kanë ardhur nga një rrjet i krimit të organizuar, ku përfshijnë njerëz në pozita të larta udhëheqëse në politikë. Prandaj, ne punëtorët e Telekomit të Kosovës nuk do të tolerojmë më që kontratat e dëmshme të vazhdojnë më tutje.

Ne kërkojmë që kontratat e dëmshme të shkëputen menjëherë, sepse Telekomit mund të rimëkëmbet dhe të kthehet fuqishëm në treg, nëse ndalohen aferat korruptive. Faleminderit!

**KRYESUESJA: Diskutuesi i fundit, Sala Berisha-Shala. Urdhëro!**

**SALA BERISHA-SHALA: Faleminderit, e nderuar nënkryetare e Kuvendit!**

I nderuar kryeministër,

Të nderuar kolegë dhe kolege deputetë,

Nuk e pata në plan ta marr fjalën, mirëpo meqenëse kjo është bërë si një shprehi e keqe që në Kuvendin e Kosovës të thërriten seanca, sidomos nga opozita, për ta kontaminuar më tepër ambientin në Kosovë, në vend se ne të punojmë bashkë për qytetarët e Kosovës dhe jemi dëshmitarë të asaj se presin me dhjetëra pika të rendit të ditës që nuk votohen, e të cilat kanë të

bëjnë me zhvillimin ekonomik të Kosovës dhe kanë të bëjnë me mirëqenien e qytetarëve tanë dhe thërrasin seanca të tilla, me qëllim të manipulimit të opinionit publik. Këtu po dua ta demantoj parafolësen, kur tha se kryetari i Kuvendit, zoti Veseli, nuk e ka lejuar kryetarin e Sindikatës të vijë e të raportojë në Kuvend.

Qytetarë të nderuar të Republikës së Kosovës,

E kanë përsëritur edhe më parë kolegët e mi në seancën e paradites, por dëshiroj që ata që janë kyçur tani ta dinë se kush duhet t'i drejtohet, ose kush ka të drejtë të flasë në seancat e Kuvendit të Kosovës janë të përcaktuara me Rregullore të punës së Kuvendit dhe me ligje të caktuara. Andaj, kryetari i Sindikatës dhe ndonjë sindikate tjetër nuk ka të drejtë t'u drejtohet qytetarëve përmes seancave të Kuvendit të Kosovës. Atë mund ta thërrasë secili grup parlamentar dhe secili komision parlamentar të raportojë në trupa të punës së Kuvendit te komisionet, por jo edhe në seanca të Kuvendit.

Nuk është se nuk e dinë edhe kolegët deputetë se kjo çështje është e rregulluar me Rregullore të punës së Kuvendit dhe me ligj, por dëshirojnë që ta manipulojnë një pjesë të qytetarëve të Kosovës. Po ju them këtu, se e kanë të kotë, sepse tashmë qytetarët tanë janë të vetëdijshëm dhe nuk mashtrohen nga fjalët megalomane, po i shohin punët e përditshme dhe sa i përket çështjes së Postës, me qëllim nuk kanë pritur derisa Komisioni hetimor i miratuar në Kuvend ta kryejë punën e vet dhe të flasim me fakte këtu, e jo t'i manipulojmë me dezinformata të ndryshme qytetarët tanë. Faleminderit!

**KRYESUESJA:** Faleminderit! Pasi ia ka përmendur emrin, znj. Safete Hadërgjonaj për replikë ka të drejtë znj. Besa Gaxherri.

**BESA GAXHERRI:** Faleminderit, zonja kryesuese!

Më vjen shumë keq që znj. Hadërgjonaj e lëshoi nivelin apo debatin në personale. Po kjo nuk është personale dhe s'mund të ndodhë të jetë personale. Unë po i drejtohem znj. Hadërgjonaj dhe po i them që edhe kjo vetë e di që në diskutimin e saj gënjeu.

Unë kam punuar në PTK dhe, po, ligji ma ka lejuar të punoj. Në atë moment kur s'ma ka lejuar, unë jam tërhequr. Po, më ruhet vendi i punës, sepse ligji e ruan, por unë kisha pasur dëshirë nëse ka një punëtor brenda asaj kompanie, apo një zyrtar kompetent të gjejë një shkelje më të vogël, një abuzim që Besa Gaxherri e ka bërë në kohën kur ka punuar në PTK.

Më vjen shumë keq që unë kam qenë aty, edhe kam shumë argumente çka ka ndodhur aty, po nuk lejoj askush të bëjë krahasime ose të barazojë shkeljet çfarë kanë ndodhur në kompani me emrin tim, Besa Gaxherri. Kur jam punësuar unë në PTK, ka qenë viti 2003. Atëherë e ka menaxhuar UNMIK-u. Nuk kanë mundur krejt këta t'i kenë në kthetra, prandaj kam hyrë unë aty, se nuk kisha mbërri kurrë. Unë jam shumë krenare për kohën sa kam punuar aty, edhe kam

shërbyer me nder dhe kam kontribuar me gjithë qenien time. Dhe jam shembull sesi duhet punuar për vendin. Ju kisha lutur, zonjë, kur të akuzosh drejtpërdrejt, duhet të kesh fakte dhe t'i çosh në Prokurori. Ky është një shembull konkret, hajde të shkojmë.

**KRYESUESJA:** Faleminderit! Për kundër-replikë, znj. Safete Hadërgjonaj.

**SAFETE HADËRGJONAJ:** Faleminderit, nënkryetare!

Më vjen keq që më duhet t'i them Besës që në diskutimin tim asgjë s'ka pasur të bëjë me gënjeshtërën. Dua t'i them znj. Gaxherri që kur jam bërë në deputete në vitin 2004, kam qenë drejtoreshë në një institucion, në Ministrinë e Tregtisë dhe në momentin kur emri im ka figuruar në listën kandiduese, unë kam dhënë dorëheqje nga posti të cilin e kam mbajtur. Ligji as Kushtetuta nuk thotë t'i mbani dy pozita, edhe postin e deputetit, edhe të qenit menaxher në institucion publik. Nuk mund të jesh deputet dhe të menaxhosh një institucion publik. Zonja e nderuar e di që i ka mbajtur për vite të tëra të dy postet dhe nuk ka këtu kurrfarë çështje për t'u hezituuar ose për t'u debatuar. Është një fakt që ka ndodhur.

**KRYESUESJA:** Faleminderit!

Fjalën e ka kryeministri i Republikës së Kosovës, z. Ramush Haradinaj.

**KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ:** Të nderuar deputetë!

E nderuar kryesuese Mufera Shinik,

Është me rëndësi që pas një dite pune deputetëve të juaj, ndoshta edhe pak të reflektojnë në atë se çka u tha dhe ku ndodhemi. Unë jam përgjegjës për gjendjen në PTK, në Telekom nga dita e marrjes së përgjegjësive. Nuk i ik përgjegjësive. Jam edhe për KEK, jam edhe për Trepçë, jam për kudo. Janë disa mënyra të mbajtjes së përgjegjësive, e po që nuk janë aq shumë direkte. Në raste të caktuara pra ne e vendosim bord e drejtor e ku di unë.

Ju siguroj që nga takimi i parë që kam bërë në atë kohë edhe me ish-drejtorin Mustafa, po edhe Sindikata, takimin e parë nuk e kam bërë ndaras, po i kam ftuar të dy palët me një bisedë që ta dimë se në çka ndodhemi. Edhe kam qenë i vetëdijshëm, edhe jam i vetëdijshëm që e kemi një gjendje të vështirë, problematike, po jo të pashpresë. Nga ajo kohë, ju lutem, d.m.th. përgjithësimi është i lejuar në politikë, fjalori kështu frontal është i lejuar, por atribuomëni cilat faje i kam? Nëse i ka kjo Qeveri.

E ke fajin e nepotizmit se është punësuar një familjar ose do aktivistë të partisë. E vërtetë që kanë hyrë do njerëz në punë, po besoni që s'i kemi çuar me intervenime partiake. Nuk e di qysh e kanë gjetur mënyrën të hyjnë, po nuk ka qenë ai projekt imi, se nuk mburrem me atë që ka ndodhur. Edhe e pranoj si faj a si përgjegjësi, a qysh të doni po i themi.

Po prej që e kam marrë detyrën, këta që i kam thirrur, ju kam thënë, ju lutem, do të jepni llogari për krejt parametrat e kompanisë prej kësaj dite. Një drejtor ka dhënë dorëheqje që ka qenë i afërt me mua, se s'mundi ta përballojë gjendjen. Një drejtor tjetër është në punë. Nuk është i afërt me mua, as nuk ka qenë ndonjëherë, hera e parë që e kam takuar, tash e kam takuar. Një bord është i emëruar, dy prej tyre kanë dhënë dorëheqje. Ky bord është i ri, nuk e ka nënshkruar atë kontratën e famshme që po themi ne. Edhe ju siguroj që në komunikim me këta njerëz, u kam thënë do të jepni llogari. I kam lutur, për hatër të tyre, e të fëmijëve të tyre, të mos gabojnë në veprime.

Shikoni. Unë e shpjegova më herët çështjen e rezolutës së Parlamentit. E vërtetë është se disa veprime për secilën pikë të rezolutës janë ndërmarrë. Nuk e kam këtë veç të mbrohem para jush, sa e kam respekt.

Pastaj jua shpjegova çështjen e kontratës me Z-Mobile. Ata janë tërhequr prej një kontrate. E kanë provuar ta implementojnë një, që të kryejnë do farë borxhesh, po janë tërhequr krejt prej saj. Janë tërhequr se s'kanë gjetur mirëkuptim te këta që e udhëheqin sot.

Njëkohësisht, dëgjoni, për t'iu shmangur një arbitrazhi të dytë, mos e neglizhoni këtë! Se e pyeti z. Kurteshi, e do të kthehem te ajo që pyeti ai. Po, për t'iu shmangur një arbitrazhi të dytë me Z-Mobile, që kishte mundur të shkaktonte pikërisht atë që po dëgjoj disa që po thonë bankrotimin ose dorëzimin e kompanisë diku tjetër, nuk është guxuar të ndërmerret ndonjë vendim arbitrar. Pra, s'kemi guxuar. Unë jam konsultuar edhe me Bord, edhe me menaxhment. Si kishim mundur të veprojmë ne në rast se duam t'i ndajmë rrugët me operatorin? Se ata kanë thënë se kontrata është e zorshme, nuk po lejon të zhvillohet, kemi edhe probleme të tjera. Nuk ka qenë i vetmi problem kontrata me Z-Mobile. Po nuk ka dalë dikush që e ka konfirmuar që një vendim arbitrar është i mundur menjëherë. Të gjithë kanë thënë ruajuni, se hyni në gabime të reja. Sepse, shikoni, kontrata është e lidhur me licencë, që e ka afatin deri në korrik. Edhe në korrik nuk është fort e qartë krejt çfarë marrëdhëniesh mund t'i ndajmë rrugët. Pra, dijeni, merreni kontratën kush jeni juristë e shihni ju vetë. Pse është shkruar ashtu ajo kontratë? Ju këtu e thatë më herët, unë s'mund të... Ekziston pra një mundësi që në rinisje, këta që e kanë përgjegjësi sot, të mos gabojnë. Pra, i kanë do mundësi këta që janë në bord, menaxhmenti, drejtorët. Unë mendoj që është mirë t'i bëjnë ata, pra ato që i fola më herët do të mbajnë përgjegjësi ligjore për veprimet e tyre. Shikoni, për të dalë prej gjendjes ku janë, janë një seri rekomandimesh, p.sh. sigurimi i një financimi në vlerë prej 7.9 milionë euro, që do të ishin investime të domosdoshme për stabilizim të gjendjes teknike, edhe që ishte dashur Qeveria të japë garanci. Pastaj sigurimi i një kredie në vlerë 25 milionë euro, që ishte dashur po ashtu të jenë investime për projekte të domosdoshme, zgjerim i infrastrukturës së rrjetit e ku di unë, plot tema të tjera.

Inkasimi i borxheve ndaj Telekomit. Pra, ka plot borxhe të painkasuara, sipas Telekomit. Disa edhe i kontestojnë, palët e tjera. Është shqyrtimi i kontratës dhe i borxhit me Dardafon. Pra, kjo është një temë që e cekët këtu.

Është ulja e shpenzimeve operative, pastaj është implementimi sa më i shpejtë i një ristrukturimi për gjendjen në total. Pra, gjendja financiare dhe operative e Telekomit të Kosovës vazhdon të mos jetë stabile. Këtë për shkak të humbjeve dhe rënies së të hyrave. Pa dyshim se shkaktarë janë marrëveshjet e mëhershme paraprake, marrja e dividendës në raste të caktuara. Ajo dividendë ka mund edhe të riinvestohet në atë që sot po kërkohet, po është marrë. Shkëputja e disa obligimeve që kanë shkaktuar dëme milionëshe po ashtu për Telekomin.

Të nderuar deputetë,

Nëse dëshira ime është ta nxjerr këtë kompani nga gjendja e sotme në një gjendje të suksesshme, profitabile. Më kujtohet kur e kam marrë detyrën, krahas kësaj vizite, kam shkuar edhe në KEK. Atëherë nuk prodhohej qymyr. E kemi rifilluar prodhimin. Unë i kam intervistuar personalisht plot njerëz të Telekomit, për të parë vërtet a ka mundësi kjo kompani edhe një herë të kthehet në këmbë të veta, profitabile. I kam dëgjuar plot, kam harxhuar kohë për këtë, e shkoni pyetni krejt ata që janë edhe të sindikatës, edhe këta të tjerët, ju tregojnë se çfarë qasje kemi ndaj kësaj kompanie.

Ju kisha lutur edhe një gjë. Po e zëmë, çka bëni privati, ose biznesmeni privat, ose operatori privat, s'jam avokat i askujt, e ka deklaruar ai që është për profit. Pra, nëse ia zini për të madhe një sipërmarrësi privat se bën kontrata ku fiton para, nuk besoj që i ka fajet privati në këto raste. Nuk duhet t'i ketë, fajet i ka përfaqësuesi i publikut, i popullit, kushdo qoftë që ka mbrojtur më mirë interesin e asaj që i është besuar. Edhe mos e harroni një gjë që ky që po e anatemojmë nganjëherë, Devolli, njëri a tjetri, ja po ju jep një shembull për Shkëlqimin, Shkëlqim Devolli. Është veprimtari prodhuese, kolegë. Mulliri i Xërxës, qysh e dini, është mulliri më i madh në Kosovë, është veprimtari e Shkëlqim Devollit. Punojnë rahovecianë, ata janë njerëz si këta të Postës, marrin rroga, të Rahovecit e të asaj ane. I marrin rrogat me kohë. Pastaj nëse shkojmë te dyshekët, prodhohet në Gjakovë, prodhohet në Pejë. Unë kam shkuar i kam parë këta punëtorë, janë qindra, janë njerëz të këtij vendi, marrin rroga. Kafja, e tjetra e tjetra. Ju lutem, të bëjmë kujdes. Pse po e them këtë? Unë nuk e kam, ju siguroj, unë nuk kam ndonjë inferioritet, unë e kam një koleg në biznes, Behxhetin, Behxhet Pacollin, ose ndonjë tjetër, që ka qenë ose është. Ne i kemi përgjegjësitë e caktuara, ne dimë çka mbrojmë.

Unë jam që marrëdhënia në mes të kompanisë që është e popullit, e Kosovës, kush e mbron atë të drejtë, le ta mbrojë, kushdo qoftë ai, nëse edhe s'po di kush është në anën tjetër. Por, nganjëherë e kam përshtypjen që po e marrim gjerë kosën pa e ditur çka po duam. Nëse është qëllimi ta ndalim një marrëveshje që është duke e dëmtuar një kompani të publikut, është më mirë ta lokalizojmë. Është më mirë ta fokusojmë. Të themi ne kemi problem, edhe unë kam problem,

edhe ju siguroj që kam problem që dy mijë e sa punëtorë, prej të cilëve s'po di sa, diku dhjetë a njëzet a tridhjetë të fundit janë edhe të Aleancës, po krejt janë të këtij vendit, të cilësdo parti, se ata njerëz të këtij vendi janë, me i qitë në rrugë dikush me ndonjë kontratë të gabuar. Është problem për mua, qysh është problem për secilin, besoj, në këtë vend.

Nëse është qëllimi për ta riparuar këtë gjendje, Qeverinë nuk e keni armik. Nëse është qëllimi për të krijuar argumente të shumta e shtesë, e për t'i zgjidhur të gjitha problemet përnjëherë, nuk di sa mund t'ju ndihmoj në të gjitha përnjëherë. Po sa i përket kësaj teme, unë jam i interesuar që Telekom i Kosovës të mos e dëmtojë veten, t'i mbrojë të drejtat e veta, ata që janë të zgjedhur, pra, ta mbrojnë Telekomin në bazë të ligjit. Faleminderit!

**KRYESUESJA:** Faleminderit, Kryeministër! Propozuesi, Glauk Konjufca.

**GLAUK KONJUFCA:** Megjithatë, unë mendoj, Kryeministër, që po i ikni përgjegjësisë. Pse? Sepse këtu po bëhen dy vjet, edhe pak, nga qeverisja juaj dhe mendoj që i keni pasur të gjitha argumentet në dorë për të shfaqur një vullnet politik nga është drejtimi që duhet ta marrë Qeveria juaj në raport me Z-Mobile? Dhe, këtu po dëgjoj shumë avokati për Grupin Devolli, po nuk e shprehët asnjë mendim qysh kjo kontratë është kriminale. Kjo për mendimin tim më jep sinjale të qarta cili është vullneti i Qeverisë tuaj në raport me Z-Mobile.

Unë nuk kam asgjë pse Devollët prodhojnë dhe pse kanë punësuar punëtorë, ama, Kryeministër, kontrata me Z-Mobile, prapa së cilës është Devolli Grup, është kontratë kriminale. Këtë duhet ta thoni ju.

Në rregull, punësimi. Le të prodhojnë jogurt, qumësht po ashtu, por kontrata me Z-Mobile është kriminale. Kaq. Dhe, ju po thoni; jogurtët mirë, qumështi mirë, e kur po vinë te kjo pjesë, po thoni, po shikoni ata kontribuojnë shumë për Kosovën, janë burra shumë të mirë. I njoh personalisht. Hamë e pimë me ta.

Kryeministër, dallojini këto gjëra. Kemi të bëjmë me një kontratë kriminale dhe s'po e di pse po e pengon Qeverinë të dalë dhe ta identifikojë kriminalitetin e kësaj kontrate.

Ja, unë po ua jap disa shembuj, Kryeministër. Në ditë e parë kur e ke marrë Qeverinë, të pasnesërmen do të duhej të uleshin ekspertët dhe ata të të tregojnë që e ke një letër nga Monako, nga Telekom i Monakos... A mundesh, Albulenë, vetëm pak, se e paskam harruar...

Ja Kryeministër, ja ku e ke letrën prej Telekom Monako, e cila identifikon vjedhje Sim to Sim që quhet, dhe ia ka dërguar institucioneve të Kosovës zyrtarisht këtë letër Telekom i Monakos, sepse ende nuk ka shkëputje përfundimtare të Vala-s prej Monakos.



U ka dërguar letër institucioneve të Kosovës, PTK-së, bordit që ndodh vjedhja Sim to Sim prej Z-Mobile. Kjo vjedhje ndodh veç prej numrave të Z-Mobile. Kryeministër, kur e ka nënshkruar Dardafoni me Z-Mobile kontratën, në njërin prej pikave shkruan: Nëse identifikohet çfarëdo vjedhjeje, çfarëdo mashtrimi, PTK-ja, ju si Qeveri, e keni çdo të drejtë që ta shkëpusni kontratën menjëherë. Pa kurrfarë shpjegimi.

Edhe nëse ju qesin në gjyq në çfarëdo arbitrazhi, ti kryeministër e kupton arbitrazhin, se Z-Mobile ka bërë vjedhje. Andaj, ju mos i frikësoni, ju e fiton arbitrazhin, ngase e ke në nen të kontratës dhe mbuloheni me atë nen.

Të gjitha të drejtat janë në ende tënde. Që dy vjet je në qeverisje, gati po bëhen, t'ia mundësoni Z-Mobile fitimin e milionave. E të pritet 31 korriku i këtij viti, e prapë tash na bëre më pesimistë, se po thua edhe më 31 korrik nuk është bash situata e qartë se, pyetni ekspertët tuaj, se ku i dihet se kush ka të drejtë.

Kryeministër, këtu dihet se kush ka të drejtë. Këtu dihet se kush ka fituar hazër prej milionave të taksapaguesve të Kosovës. Është kompania Z-Mobile, e cila ka fituar hazër.

Dëmi që ia ka shkaktuar prej Prokurorisë, a i besoni ju Prokurorisë së Shtetit. Prokuroria e shtetit tonë, kur ka vendosur rast kundër Z-Mobile pretendon që buxheti, xhepat e qytetarëve të Kosovës, të Qeverisë, janë dëmtuar rreth 200 milionë euro.

Pa asnjë kosto Z-Mobile ka marrë përfitime 73%, seç pse Vala ia ka falë një pjesë të infrastrukturës që ta kryejnë shërbime dhe ata ta bëjnë profitin e tyre në këtë mënyrë. Pra, më 31 korrik ne e kemi të qartë që jo më 31 korrik, po ju prej janarit, sepse shkruan në marrëveshje, 6 muaj para skadimit të kontratës, e kontrata i skadon Telekomit më 31 korrik.

Pra, 6 muaj para skadimit të kontratës ju do të duhej të uleshit dhe ta bisedonit këtë punë dhe më 1 janar ta shkëputnit kontratën me Z-Mobile. Ti do duhej që ta shkëputnit kontratën.

Jo ju personalisht ta vëni nënshkrimin aty, se po e di unë që Bordi i Telekomit merr vendime, ama ju Kryeministër jeni aksionari. Ju jeni 100%. Ju jeni aksionari. Ma tregoni, Kryeministër, një kompani në botë, ku aksionari thotë diçka, e Bordi vepron ndryshe, kundër aksionarit.

Po aksionari merr vendime. Jo vendime. Ta vëni ju nënshkrimin aty, po vullnetin politik. Të dilni dhe të thoni: unë nuk jam pajtuar me qeverisjet e kaluara. Kjo u ka sjellë qytetarëve dëm dhe kjo Qeveri do ta ndryshojë drejtimin me këtë kompani.

E ju po dilni dhe po thoni që unë e inkurajoj bordin që të mos marrë asnjë vendim i cili e dëmton. Po Kryeministër, nuk po shoh vullnet të qartë te ju që ta ndalni këtë kontratë.

Mos u frikësoni. Të gjitha po t'i numëroj. Të drejtat i ke në anën tënde. Z-Mobile mund t'ia numërojmë me dhjetëra e dhjetëra shkelje, për të cilat ju keni të drejtë edhe jeni i mbuluar me ligj që keni të drejtë që të mos e vazhdoni kontratën me të.

Kryeministër, a e dini që 600 mijë euro janë shfrytëzuar për këtë punën e mbrojtjes në arbitrazh nga Telekom i Kosovës, e kanë shkuar atje njerëz që nuk dinë as anglisht.

Atje jo vetëm që duhet ta kesh një nivel të lartë profesional që ta mbrosh Telekomin e Kosovës, po ju nuk e dini se as ku kanë shkuar ato para. 600 mijë euro, Kryeministër, janë shumë.

Nuk po dihet, ajo Studio Ligji që i ka marrë. Ajo është anonime. Janë njerëz joprofesionalë të familjarëve të udhëheqësve të Telekomit, edhe nuk ka llogari për këtë punë. Telekom ka dështuar, nuk është mbrojtur. Tash, pak që kanë fituar miliona hazër, por Kosovës t'ia marrin edhe 30 milionë euro të reja tani.

Me të vërtetë nuk po shoh që po i adresoni këto shqetësime. Edhe për sa i përket falimentimit edhe bankrotimit, në të cilin ju po keni dyshim, mos harroni që e keni shtyrë atë deri më 15 qershor, përmbarimin. Po nëse Dardafoni, Z-Mobile, në këtë rast, ankohet te Gjykata e Arbitrazhit dhe thotë që Qeveria nuk po m'i paguan paratë, aty mund t'i marrë arbitrazhi menjëherë edhe prej parave të jashtme të Kosovës.

Kështu që, krejt çka na duhet prej juve është shkëputje e kontratës me Z-Mobile, sepse mos harroni, a din çfarë kanë thënë ata nënshkruesit e sindikatave që i keni atje në fund ulur. Ata janë betuar që nëse ju nuk e keni vullnetin politik që ta shkëpusni atë kontratë, edhe do të vazhdoni me Z-Mobile, këta nuk do zbatojnë asnjë përgjegjësi, as një urdhër, i cili buron drejtpërdrejt prej asaj vazhdimësie të kontratës me Z-Mobile.

Do të thotë se veçse do ta thelloni krizën në Telekom, sepse ata njerëz që e kanë nënshkruar, e unë dëgjova që 80% të punëtorëve të Telekomit e paskan nënshkruar petitionin, ata kanë thënë se nëse Qeveria e vazhdon kontratën me Z-Mobile, ne nuk i përgjigjemi më kurrfarë veprimi, i cili rrjedh prej obligimeve që dalin prej kontratës së Telekomit me Z-Mobile. Pra, thellohet kriza edhe më shumë.

Prandaj, dy pika janë shumë të rëndësishme; vullneti juaj që nuk do të ketë më nënshkrim dhe vazhdim të kontratës me Z-Mobile, edhe një vullnet juaji që jeni për t'i gjetur shkeljet që kanë ndodhur deri më tash edhe prej Z-Mobile. Në këtë vend, mua më çudit qysh ajo që po përndiqet, po persekutohet është Telekom, ndërkaq janë të gjitha argumentet që të persekutohet hajnia e Z-Mobile.

**KRYESUESJA: Faleminderit! Po, Kryeministër. Replikë, urdhëroni!**

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: E para, shqetësimin e mirëpres. Vërtet e mirëpres shqetësimin e çdo grupi parlamentar, edhe të deputetëve, për gjendjen në Telekom.

Nuk ka dilemë që në këtë shqetësim, ndoshta që të gjithë e kemi serioz, nuk e kemi fals shqetësimin.

Nëse dua që të jem i sinqertë, ju folët për arbitrazhin dhe për vendimin. Ju e dini që s'ka ndodhur në kohën e Qeverisë sime humbja në arbitrazh, besoj. Apo ka ndodhur në kohën time, nuk ke di se në cilën kohë ka ndodhur humbja edhe kur e kemi gjetur ne obligimin prej arbitrazhit.

Mirëpo, vetë e thatë që mund t'i marrë paratë pastaj Gjykata e Arbitrazhit. A po e shihni që jemi në do farë ingranazhesh të ligjit ndërkombëtar dhe të ligjit vendor. Ju e pranuat në një moment realisht faktin.

Pastaj po thoni që është tip akuze kjo që unë s'paskam vullnet. Shihni, trendi si ka shkuar çdo marrëdhënie e kompanisë Telekom me këdo tjetër prej ardhjes së kësaj Qeverie. Çfarë ka ndodhur. Kur ka ndodhur dhe si ka ndodhur.

Pse po ua them këtë? A e gjetët datën se kur ka ndodhur arbitrazhi? Më falni, kur ka ndodhur arbitrazhi, meqë ra fjala. Ju Albulenë, jeni juriste, a prisni që unë ta kontrolloj se çfarë vendos një gjykatë e vendit ose e jashtme.

Fatkeqësisht, vendimet e gjykatës vendore, ju e dini, se janë më të vogla se disa gjykata të tjera. Po, si do që të jetë. Kolegë, sa i përket Sindikatës se çfarë duan të bëjnë këta, mos harro Glauk, unë edhe ti jemi të këtij vendi, të gjithë kanë ngrënë bashkë deri tash.

Me sindikata, me menaxhmente e të gjithë. I kanë ndarë disa privilegje. Kanë bashkëjetuar deri sot bashkë, e tani kur po e shohin që mund të mbesin pa asgjë të gjithë, të gjithë po alarmohen. Kjo është e varetë, ju siguroj.

Që 20 vjet kanë bashkëjetuar, kanë mbijetuar. Ia kanë fshehur njeri-tjetrit. Ia kanë bërë ndonjë nder njëri-tjetrit. Të gjithë me një vend jemi. Tash që ka ardhur problemi, po tani të gjithë po alarmohen.

Unë edhe njëherë po ta them, unë kam respekt për njerëzit që prodhojnë në vendin tim. Ata që e kanë emrin Devoll, e dikush tjetër edhe ndryshe. Po s'jam duke e bërë lidhjen me fshehjen e përgjegjësive të mia, sa i përket kontratës me Telekomin.

Ta quaj unë kriminale, duhet një gjykatë ta quajë, jo një Monako Telekom, ngase ajo Monako Telekom i ka fituar goxha do para prej nesh, po ashtu. Ju e dini, me prefiksa, me leje. Operator është, kompani biznesi, si ajo si Ipko, si tjetër kush.

KRYESUESJA: Faleminderit, kryeministër! Regjia, fjalën kryeministrit.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: I mbajmë përgjegjësitë për çdo vendim që ndodh, po ju lutem, edhe një herë, është më se e sigurtë kjo që po e them, mundeni nganjëherë duke dashur ta përgjithësoni t'i lëni pa u kryer disa punë të mira në vend. Mos e bëni atë.

Nëse ju interesojnë punëtorët e Telekomit, të gjithë duhet të kthjelleni pak, bash të gjithë. Nuk është gjendje e krijuar sot, është gjendje e krijuar që 20 vjet. Mund të dalim nga kjo gjendje.

Kur thashë unë 31 korrik. Shikoni, nuk thashë që shkëputet dhe as nuk shkëputet kontrata. Që 6 muaj ne ia kemi filluar negocimit me terma e me ku ta di unë. Nuk e di sesi do të jetë epilogu, nuk po e paragjykoj. Ata që vendosin, le të vendosin. Mirëpo, punëtorët dhe të gjithë, unë i apeloj që të mos bëjnë më kompromise në interes të drejtës së vet. Edhe sindikatën, edhe të gjithë.

Mendoj, se nëse duan ta mbrojnë të drejtën e vet, le ta mbrojnë dhe të mos bëjnë kompromise në momente të fundit. Ndryshe, e kam përshtypjen që shpesh në momente të fundit të gjithë po e lëshojnë pozicionin.

KRYESUESJA: Faleminderit, Kryeministër! Kundër-replikë, Glauk Konjufca. Urdhëroni!

GLAUK KONJUFCA: Së pari, kryesuese mendoj që nuk jeni duke e udhëhequr mirë seancën. Jo, sepse ekspozesa e fundit në një seancë të jashtëzakonshme shkon edhe ne prezantojmë ato që mendojmë që paraqesin konkluzione të debatit.

Unë e shpjegova edhe në fillim që së bashku me grupet parlamentare do t'i formulojmë disa pika, të cilat do të votohen, por me sa po e shoh numrin e deputetëve këtu, nuk është e mundshme që të votohen.

Por, sa i përket Kryeministrit, po them që nuk ka nevojë të pritet gjykata që ta kuptojë dëmin e kontratës së Dardafonit me Z-Mobile. Nuk ka nevojë që ne ta presim gjykatën. Kjo është një kontratë, e cila e dëmton interesin publik.

Nëse e kemi kryeministrin si të parin e vendit që ta mbrojë interesin publik, kjo nuk ka ndodhur.

KRYESUESJA: Faleminderit! Glauk, merre dhe lexoje Rregulloren. Për votim nuk kemi të drejtë, sepse nuk kemi kuorum.

Me këtë i mbyll punimet e kësaj seance të jashtëzakonshme. Mirupafshim nesër në seancën e radhës. Faleminderit!

*E përgatiti:  
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*